

URDHËR
Nr.127, datë 21.12.2016

**PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE NË STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË
RAPORTIMIT FINANCIAR, TË PËRKTHYERA NË GJUHËN SHQIPE**

Në mbështetje të nenit 4, pikës 3 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, të vendimit nr.5, datë 23.11.2016 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, “Për miratimin e përkthimit dhe rishikimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve të ndodhura për SNRF-të gjatë vitit 2015”, të cilat hyjnë në zbatim nga data 1 janar 2019.

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) si më poshtë:

Titulli	Data efektive
EN_GVT_IFRS 16 Leases_Jan 2016 Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 16 Qiratë	1 janar 2019

2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 16

Qiratë

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 16

Qiratë

Objektivi

- 1 Ky Standard paraqet kërkesat për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për *qiratë*. Objektivi është që të sigurohet se qiramarrësit dhe qiradhënësit japin informacionin përkatës, në mënyrë që këto transaksione të paraqiten në mënyrë besnike. Ky informacion u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare që të vlerësojnë efektin që qiratë kanë në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të një njësie ekonomike.
- 2 Qjatë zbatimit të këtij Standardi, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë kushtet e *kontratës* dhe të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse. Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë Standard në mënyrë të qëndrueshme (uniforme) për kontrata me karakteristika të ngjashme dhe në rrethana të ngjashme.

Objekti

- 3 Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë Standard për të gjitha qiratë, përfshirë qiratë për *aktivet me të drejtë përdorimi* në një *nën-qira*, me përjashtim të:
 - (a) qirave për kërkimin ose shfrytëzimin e mineraleve, naftës, gazit natyror dhe burimeve të tjera të ngjashme të pa rigjenerueshme;
 - (b) qirave të aktiveve biologjike të mbajtura nga një qiramarrës, të cilat janë brenda objektit të SNK 41 *Bujqësia*;
 - (c) marrëveshjeve koncesionare të shërbimit, të cilat janë brenda objektit të KIRFN 12 *Marrëveshje Koncesionare të Shërbimit*;
 - (d) licencat e pronësisë intelektuale të dhëna nga një qiradhënës brenda objektit të SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*; dhe
 - (e) të drejtat e mbajtura nga një qiramarrës sipas marrëveshjeve të licensimit brenda objektit të SNK 38 *Aktive jo-materiale* të tilla si filmat, regjistrimet video, pjesët filmike, dorëshkrimet, patentat dhe të drejtat e autorit.
- 4 Qiramarrësi mund ta zbatojë këtë Standard për qiratë e aktiveve jo-materiale të ndryshme nga ato të pënhkruara në paragrafin 3(e) edhe pse nuk i kërkohet.

Përjashtime të njohjes (paragrafët B3–B8)

- 5 Qiramarrësi mund të zgjedhë të mos i zbatojë kërkesat në paragrafët 22–49 për:
 - (a) *qiratë afatshkurtra*; dhe
 - (b) qiratë për të cilat *aktivi bazë* ka vlerë të ulët (siç përshkruhet në paragrafët B3–B8).
- 6 Nëse qiramarrësi zgjedh të mos zbatojë kërkesat në paragrafët 22–49 për qiratë afatshkurtra ose për qiratë për të cilat aktivi bazë ka vlerë të ulët, qiramarrësi do t'i njohë *pagosat e qirasë* të lidhura me këto qira si shpenzim mbi baza lineare përgjatë *afatit të qirasë* ose mbi një bazë tjetër sistematike. Qiramarrësi do të zbatojë një bazë tjetër sistematike nëse kjo e fundit e përfaqëson më mirë modelin e përfitimeve për qiramarrësin.
- 7 Nëse një qiramarrës trajton qiratë afatshkurtra sipas paragrafit 6, qiramarrësi duhet ta konsiderojë qiranë si një qira të re për qëllimet e këtij Standardi nëse:
 - (a) ndodh një *modifikim i qirasë*; ose
 - (b) ndodh ndonjë ndryshim në afatet e qirasë (për shembull, qiramarrësi ushtron një opsion të pa përfshirë më parë në përcaktimin e afateve të qirasë).
- 8 Zgjedhja për qiratë afatshkurtra do të bëhet sipas klasave të aktiveve bazë me të cilat lidhet e drejta e përdorimit. Një Klasë e aktiveve bazë është një grupim i aktiveve bazë me natyrë dhe përdorim të ngjashëm

në operacionet e një njësie ekonomike. Zgjedhja për qiratë për të cilat aktivi bazë ka vlerë të ulët mund të bëhet mbi baza individuale për secilën qira.

Identifikimi i një qiraje (paragrafët B9–B33)

- 9 Në fazën fillestare të lidhjes një kontrate, njësia ekonomike do të vlerësojë nëse kontrata është, ose përmban, një qira. Kontrata është, ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Paragrafët B9–B31 shërbejnë si udhëzues për vlerësimin se kur kontrata, është ose përmban një qira.
- 10 Periudha e kohës mund të përkthuhet në termat e madhësisë së përdorimit të një aktivi të identifikueshëm (për shembull numri i njërive të prodhimit që zakonisht pritet të prodhojë një zë i makinerive).
- 11 Njësia ekonomike duhet të rivlerësojë nëse një kontratë është ose përmban një qira vetëm nëse afatet dhe kushtet e kontratës janë ndryshuar.

Ndarja e përbërësve të një kontrate

- 12 Për një kontratë që është, ose përmban një qira, njësia ekonomike duhet ta trajtojë çdo përbërës të qirasë brenda kontratës si një qira të ndarë nga përbërësit jo-qira të kontratës, me përjashtim të rastit kur njësia ekonomike zbaton lehtësinë praktike të paragrafit 15. Paragrafët B32–B33 udhëzojnë mbi ndarjen e përbërësve të një kontrate.

Qiramarrësi

- 13 Për një kontratë që përmban një përbërës qira dhe një ose më shumë përbërës shtesë qira ose jo qira, qiramarrësi duhet ta shpërndajë shumën në kontratë tek secili përbërës qira mbi bazën e çmimit specifik përkatës të përbërësit qira dhe çmimit specifik total të përbërësve jo-qira.
- 14 Çmimi specifik përkatës i përbërësve qira dhe jo-qira duhet të përcaktohet mbi bazën e çmimit që qiradhënësi ose një furnitor i ngjashëm do t'i kërkonte një njësie ekonomike veçmas për atë përbërës ose për një përbërës të ngjashëm. Nëse nuk është lehtësisht i mundur të përcaktohet një çmim specifik i vërtetueshëm, qiramarrësi duhet ta vlerësojë çmimin specifik duke maksimizuar përdorimin e informacionit të vërtetueshëm.
- 15 Për lehtësi praktike, një qiramarrës mund të zgjedhë, sipas klasës së aktivitetit bazë, të mos i veçojë përbërësit jo-qira nga përbërësit qira dhe ta trajtojë secilin përbërës qira dhe ndonjë përbërës jo-qira të lidhur me të si një përbërës të vetëm qiraje. Qiramarrësi nuk duhet ta zbatojë këtë lehtësi praktike për derivativë të përfshirë, të cilët plotësojnë kriterin në paragrafin 4.3.3 të SNRF 9 *Instrumente financiare*.
- 16 Me përjashtim të rastit kur zbatohet lehtësia praktike në paragrafin 15, qiramarrësi duhet t'i trajtojë përbërësit jo-qira duke përdorur Standardet e tjera të zbatueshme.

Qiradhënësi

- 17 Në një kontratë që përmban një përbërës qira dhe një ose më shumë përbërës shtesë qira ose jo qira, qiradhënësi duhet ta shpërndajë shumën në kontratë duke zbatuar paragrafët 73–90 të SNRF 15.

Afati i qirasë (paragrafët B34–B41)

- 18 Njësia ekonomike do ta përcaktojë afatin e qirasë si periudha e paanullueshme e një qiraje, së bashku me:
- (a) periudhat e mbuluara nga një opsion për të zgjidhur qiranë nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion; dhe
 - (b) periudhat e mbuluara nga një opsion për të përfunduar qiranë nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për të mos e ushtruar atë opsion.
- 19 Kur vlerëson nëse një qiramarrës ka siguri të arsyeshme për të ushtruar opsionin për ta zgjidhur një qira, ose për të mos ushtruar opsionin për të përfunduar një qira, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë të gjithë faktet dhe rrethanat që krijojnë nxitës ekonomikë për qiramarrësin që të ushtrojë opsionin për zgjidhjen e qirasë, ose për të mos ushtruar opsionin për përfundimin e qirasë, siç përkthuhet në paragrafët B37–B40.

- 20 Qiramarrësi duhet të rivlerësojë nëse ka siguri të arsyeshme për të ushtruar një opion shtyrjeje, ose për të mos ushtruar një opion përfundimi, kur ndodh një ngjarje e rëndësishme ose një ndryshim i rëndësishëm në rrethanat:
- (a) të cilat janë brenda kontrollit të qiramarrësit; dhe
 - (b) që ndikojnë nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme se do të ushtrojë një opion të papërfshirë më parë në përcaktimin e afatit të qirasë, ose të mos ushtrojë një opion të parashikuar më parë në përcaktimin e afatit të qirasë (siç përshkruhet në paragrafin B41).
- 21 Njësia ekonomike do të rishikojë afatin e qirasë nëse ka një ndryshim në periudhën e paanullueshme të qirasë. Për shembull, periudha e paanullueshme e qirasë do të ndryshojë nëse:
- (a) qiramarrësi ushtron një opion të papërfshirë më parë nga njësia ekonomike në përcaktimin e afatit të qirasë;
 - (b) qiramarrësi nuk ushtron një opion të përfshirë më parë nga njësia ekonomike në përcaktimin e afatit të qirasë;
 - (c) ndodh një ngjarje e cila sipas kontratës detyron qiramarrësin të ushtrojë një opion të papërfshirë më parë nga njësia ekonomike në përcaktimin e afatit të qirasë; ose
 - (d) ndodh një ngjarje e cila sipas kontratës ndalon qiramarrësin të ushtrojë një opion të përfshirë më parë nga njësia ekonomike në përcaktimin e afatit të qirasë.

Qiramarrësi

Njohja

- 22 Në datën e fillimit, një qiramarrës duhet të njohë një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim të qirasë.

Matja

Matja fillestare

Matja fillestare e aktivit me të drejtë përdorimi

- 23 Në datën e fillimit, qiramarrësi do të masë aktivin me të drejtë përdorimi me kosto.
- 24 Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi do të përfshijë:
- (a) shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë siç përshkruhet në paragrafin 26;
 - (b) çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, minus çdo *stimul qiraje* të marrë;
 - (c) çdo *kosto fillestare të drejtëpërdrejtë* të kryer nga qiramarrësi; dhe
 - (d) një vlerësim të kostove që do të ndodhin nga qiramarrësi për çmontimi dhe lëvizjen e aktivit bazë, restaurimi i vendit në të cilin ishte vendosur ai ose restaurimi i aktivit bazë në kushtet e kërkuara nga termit dhe kushtet e qirasë me përjashtim të kostove të ndodhura për prodhimin e inventarëve. Qiramarrësi krijon një detyrim për ato kosto ose në datën e fillimit ose si pasojë e përdorimit të aktivit bazë gjatë një periudhe të caktuar.
- 25 Qiramarrësi duhet t'i njohë kostot e përshkuara në paragrafin 24(d) si pjesë e kostos së aktivit me të drejtë përdorimi kur atij i lind një detyrim për këto kosto. Qiramarrësi zbaton SNK 2 *Inventarët* për kostot që ka ndeshur gjatë një periudhe të caktuar si pasojë e përdorimit të aktivit me të drejtë përdorimi për të prodhuar inventarët gjatë asaj periudhe. Detyrimet për këto kosto të trajtuara në përputhje me këtë Standard ose SNK 2 njihen dhe maten duke zbatuar SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara*.

Matja fillestare e detyrimit të qirasë

- 26 Në datën e fillimit, qiramarrësi duhet ta masë detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë, të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat e qirasë duhet të skontoen duke përdorur *normën e interesit të përcaktuar të qirasë*, nëse kjo normë mund të përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi duhet të përdorë *normën rritëse të huamarrjes të qiramarrësit*.

- 27 Në datën e fillimit, pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë pagesat për të drejtën e përdorimit të aktivitet bazë gjatë afatit të qirasë, të paguara në datën e fillimit si më poshtë:
- (a) *pagesat fikse* (përfshirë pagesat fikse në-thelb të përshkruara në paragrafin B42), minus çdo stimul qiraje të marrë;
 - (b) *pagesat variabël të qirasë* të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit (siç përshkruhet në paragrafin 28);
 - (c) shumat e pritshme për t'u paguar nga qiramarrësi sipas *vlerës së mbetur të garancive*;
 - (d) çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse qiramarrësi është siguri të arsyeshme për ta ushtruar atë opsion (i vlerësuar duke marrë në konsideratë faktorët e përshkruar në paragrafët B37–B40); dhe
 - (e) pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron qiramarrësin që ushtron një opsion për përfundimin e qirasë.
- 28 Pagesat variabël të qirasë që varen nga një indeks ose normë e përshkruar në paragrafin 27(b) përfshijnë, për shembull, pagesat e lidhura me indeksin e çmimeve të konsumit, pagesat e lidhura me një normë interesi si standardi më i mirë (të tillë si LIBOR) ose pagesat që ndryshojnë në varësi të normave të tregut për qiratë.

Matja e mëpasshme

Matja e mëpasshme e aktivitet me të drejtë përdorimi

- 29 Pas datës së fillimit, qiramarrësi duhet të masë aktivin me të drejtë përdorimi duke përdorur modelin e koston, me përjashtim të rastit kur zbatohen modelet e matjes të përshkruar në paragrafët 34 dhe 35.

Modeli i koston

- 30 Për të zbatuar modelin e koston, qiramarrësi duhet të masë aktivin me drejtë përdorimi me kosto:
- (a) minus ndonjë amortizim të akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi; dhe
 - (b) të rregulluar për ndonjë ri matje të detyrimit të qirasë të specifikuar në paragrafin 36(c).
- 31 Qiramarrësi duhet të zbatojë kërkesat për amortizim të SNK 16 *Toka, ndërtesa, makineri e pajtje* kur amortizon aktivin me drejtë përdorimi, subjekt i kërkesave të paragrafit 32.
- 32 Nëse qiraja transferon zotërimin e aktivitet bazë tek qiramarrësi në fund të afatit të qirasë ose nëse kosto e aktivitet me drejtë përdorimi reflekton se qiramarrësi do të ushtrojë një opsion blerjeje, qiramarrësi duhet të amortizojë aktivin me drejtë përdorimi nga data e fillimit deri në fund të *jetës së dobishme* të aktivitet bazë. Nga ana tjetër, qiramarrësi duhet të amortizojë aktivin me drejtë përdorimi nga data e fillimit deri në datën më të hershme të fundit të *jetës së dobishme* të aktivitet me drejtë përdorimi ose fundit të afatit të qirasë.
- 33 Qiramarrësi duhet të zbatojë SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve* për të përcaktuar nëse aktivi me drejtë përdorimi është zhvlerësuar dhe të njohë humbjen e identifikuar nga zhvlerësimi.

Modele të tjera të matjes

- 34 Nëse një qiramarrës zbaton modelin e vlerës së drejtë të SNK 40 *Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara* për një aktiv afatgjatë material të investuar, qiramarrësi duhet të zbatojë modelin e vlerës së drejtë edhe për aktivitet me drejtë përdorimi, të cilat plotësojnë përkufizimin e aktivitet afatgjatë material të investuar në SNK 40.
- 35 Nëse aktivet me drejtë përdorimi lidhen me një kategori të aktiveve afatgjata materiale, për të cilat qiramarrësi zbaton modelin e rivlerësimit të SNK 16, qiramarrësi mund të zgjedhë të zbatojë atë model rivlerësimi për të gjitha aktivet me drejtë përdorimi, që lidhen me atë kategori të aktiveve afatgjata materiale.

Matja e mëpasshme e detyrimit të qirasë

- 36 Në datën e fillimit, një qiramarrës duhet të masë detyrimin e qirasë:
- (a) **duke rritur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar interesin në detyrimin e qirasë;**

- (b) **duke pakësuar vlerën kontabël (neto) për të reflektuar pagesat e bëra të qirasë; dhe**
 - (c) **duke ri matur vlerën kontabël (neto) për të reflektuar çdo rivlerësim ose modifikim të qirasë të specifikuar në paragrafët 39–46, ose për të reflektuar pagesat e rishikuara në thellësi të qirasë (shih paragrafin B42).**
- 37 Interesi në detyrimin e qirasë në çdo periudhë gjatë afatit të qirasë do të jetë shuma që sjell një normë interesi konstante periodike në tepriçën e mbetur të detyrimit të qirasë. Norma periodike e interesit është norma e skontimit e përshkruar në paragrafin 26 ose, nëse është e zbatueshme norma e skontimit e rishikuar e përshkruar në paragrafin 41, paragrafin 43 ose paragrafin 45(c).
- 38 Pas datës së fillimit, qiramarrësi do të njohë në fitim ose humbje përveç kostove që janë përfshirë në vlerën kontabël (neto) të një aktivi tjetër duke zbatuar Standardet e tjera të zbatueshme, që të dyja:
- (a) interesin në detyrimin e qirasë; dhe
 - (b) pagesat variabël të qirasë që nuk janë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose kushti që sjell këto pagesa.

Rivlerësimi i detyrimit të qirasë

- 39 Pas datës së fillimit, qiramarrësi duhet të zbatojë paragrafët 40–43 për të ri matur detyrimin e qirasë për të reflektuar ndryshimet në pagesat e qirasë. Qiramarrësi duhet të njohë shumën nga rimatja e detyrimit të qirasë si një rregullim të aktivitetit me të drejtë përdorimi. Megjithatë, nëse vlera kontabël (neto) e aktivitetit me të drejtë përdorimi pakësohet në zero dhe ka një pakësim të mëtejshëm në matjen e detyrimit të qirasë, një qiramarrës do të njohë në fitim ose humbje çdo shumë të mbetur nga rimatja.
- 40 Qiramarrësi duhet të rimasë detyrimin e qirasë duke skontuar pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë skontimi të rishikuar, nëse:
- (a) ka një ndryshim në afatin e qirasë siç përshkruhet në paragrafët 20–21. Qiramarrësi do të përcaktojë pagesat e rishikuara të qirasë bazuar në afatin e rishikuar të qirasë; ose
 - (b) ka një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për blerje të aktivitetit bazë, të vlerësuar duke marrë në konsideratë ngjarjet dhe rrethanat e përshkruara në paragrafët 20–21 në kontekstin e një opsioni blerjeje. Qiramarrësi duhet të përcaktojë pagesat e rishikuara të qirasë për të reflektuar ndryshimet në shumën e pagueshme sipas opsionit të blerjes.
- 41 Kur zbatohet paragrafi 40, qiramarrësi do të përcaktojë normën e rishikuar të skontimit si norma e interesit e përcaktuar e qirasë për afatin e mbetur të qirasë, nëse kjo normë mund të përcaktohet lehtësisht, ose si norma rritëse e huamarrjes së qiramarrësit në datën e rivlerësimit, nëse norma e interesit e përcaktuar e qirasë nuk mund të përcaktohet lehtë.
- 42 Qiramarrësi duhet të rimasë detyrimin e qirasë duke skontuar pagesat e rishikuara të qirasë nëse:
- (a) ka një ndryshim në shumën e pritshme për t'u paguar sipas një garancie të vlerës së mbetur. Qiramarrësi duhet të përcaktojë pagesat e rishikuara të qirasë për të reflektuar ndryshimet në shumën e pritshme për t'u paguar sipas garancisë së vlerës së mbetur.
 - (b) ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që vijnë nga një ndryshim në një indeks ose në një normë të përdorur për të përcaktuar ato pagesa, përfshirë, për shembull, një ndryshim për të reflektuar ndryshimet në normat e qirasë në treg në vijim të një rishikimi të tregut të qirave. Qiramarrësi duhet të rimasë detyrimin e qirasë për të reflektuar këto ndryshime të pagesave të rishikuara të qirasë vetëm kur ka një ndryshim në flukset e mjeteve monetare (d.m.th kur hyn në fuqi rregullimi për pagesat e qirasë). Qiramarrësi duhet të përcaktojë pagesat e rishikuara të qirasë për afatin e mbetur të qirasë bazuar në pagesat kontraktuale të rishikuara.
- 43 Kur zbatohet paragrafi 42, qiramarrësi duhet të përdorë një normë skontimi të pandryshuar, me përjashtim të rastit kur ndryshimi në pagesat e qirasë vjen nga një ndryshim në normat e luhatshme të interesit. Në këtë rast, qiramarrësi do të përdorë një normë të rishikuar skontimi, e cila reflekton ndryshimet në normat e interesit.

Ndryshimet e qirasë

- 44 Qiramarrësi do të trajtojë një ndryshim të qirasë si një qira të veçantë nëse njëkohësisht:
- (a) ndryshimi rrit objektin e qirasë duke shtuar të drejtën për përdorim të një ose më shumë aktiveve bazë; dhe
 - (b) shuma e qirasë rritet me një shumë të krahasueshme me çmimin specifik për rritjen në objekt dhe ndonjë rregullim përkatës të këtij çmimi specifik për të reflektuar rrethanat e kontratës përkatëse.

- 45 Për një ndryshim të qirasë që nuk është trajtuar si një qira e veçantë, në *datën e hyrjes në fuqi të ndryshimit të qirasë* qiramarrësi do të:
- (a) shpërndajë shumën në kontratën e ndryshuar duke zbatuar paragrafët 13–16;
 - (b) përcaktojë afatin e qirasë në kontratën e ndryshuar duke zbatuar paragrafët 18–19; dhe
 - (c) rimasë detyrimin e qirasë duke skontuar pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar skontimi. Norma e rishikuar e skontimit përcaktohet si norma e interesit e përcaktuar e qirasë për afatin e mbetur të qirasë, nëse kjo normë mund të përcaktohet lehtësisht, ose si norma rritëse e huamarrjes së qiramarrësit në datën e hyrjes në fuqi të ndryshimit, nëse norma e interesit e përcaktuar e qirasë nuk mund të përcaktohet lehtë.
- 46 Për një ndryshim të qirasë që nuk është trajtuar si një qira e veçantë, qiramarrësi duhet të trajtojë rimatjen e detyrimit të qirasë duke:
- (a) zvogëluar vlerën kontabël (neto) të aktivit me të drejtë përdorimi për të reflektuar përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë për ndryshimin e qirasë që zvogëlon objektin e qirasë. Qiramarrësi do të njohë në rezultat çdo fitim ose humbje që lidhet me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë.
 - (b) bërë një rregullim korrespondues të aktivit me të drejtë përdorimi për të gjitha ndryshimet e tjera të qirasë.

Paraqitja

- 47 Qiramarrësi do të paraqesë në pasqyrën e pozicionit financiar ose të japë informacion shpjegues në shënimet për:
- (a) aktivet me të drejtë përdorimi veçmas nga aktivet e tjera. Nëse një qiramarrës nuk paraqet aktivet me të drejtë përdorimi veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar, ai do të:
 - (i) përfshijë aktivet me të drejtë përdorimi në të njëjtin nënzër në të cilin do të paraqiteshin aktivet bazë korresponduese, nëse ato do të zotëroheshin; dhe
 - (ii) japë informacion shpjegues për nënzërin e pasqyrës së pozicionit financiar, ku përfshihen këto aktive me të drejtë përdorimi.
 - (b) detyrimet e qirasë veçmas nga detyrimet e tjera. Nëse qiramarrësi nuk paraqet detyrimet e qirasë veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar, qiramarrësi do të japë informacion shpjegues për zërin e pasqyrës së pozicionit financiar ku përfshihen ato detyrime.
- 48 Kërkesat në paragrafin 47(a) nuk zbatohen për aktivet me të drejtë përdorimi, të cilat plotësojnë përkufizimin e aktivit afatgjatë material të investuar, i cili do të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar si aktive të investuar.
- 49 Në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe pasqyrën e të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, qiramarrësi do të paraqesë shpenzimin e interesit mbi detyrimin e qirasë veçmas nga shpenzimi i amortizimit të aktivit me të drejtë përdorimi. Shpenzimi i interesit të detyrimit të qirasë është një përbërës i kostove të financimit, të cilat sipas paragrafit 82(b) të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* duhet të paraqiten veçmas në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.
- 50 Në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, qiramarrësi do të klasifikojë:
- (a) pagesat në mjete monetare për pjesën kryesore të detyrimit të qirasë brenda aktiviteteve financiare;
 - (b) pagesat në mjete monetare për pjesën e interesit të detyrimit të qirasë duke zbatuar për interesin e paguar kërkesat në SNK 7 *Pasqyra e Fluxeve të Mjeteve Monetare*; dhe
 - (c) pagesat e qirasë afatshkurtër, pagesat për qiratë e aktiveve me vlerë të ulët dhe pagesat variabël të qirasë të papërfshira në matjen e detyrimit të qirasë brenda aktivitetit të shfrytëzimit.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 51 Objektivi i dhënies së informacioneve shpjeguese është që qiramarrësi të japë informacion shpjegues, i cili së bashku me informacionin e dhënë në pasqyrën e pozicionit financiar, në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, jep një bazë për përdoruesit e pasqyrave financiare që të vlerësojnë efektin që qiratë kanë në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të qiramarrësit. Paragrafët 52–60 specifikojnë kërkesat se si të plotësohet ky objektivi.

- 52 Qiramarrësi do të japë informacion shpjegues rreth qirave të tij për të cilat ai është qiramarrës, në një shënim të vetëm ose në një seksion të veçantë në pasqyrat e tij financiare. Megjithatë, qiramarrësi nuk ka nevojë të dublikojë informacionin që është tashmë i paraqitur në pjesët e tjera të pasqyrave financiare, me kushtin që ky informacion të përfshihet nëpërmjet një reference të kryqëzuar në një shënim të vetëm ose në një seksion të veçantë mbi qiratë.
- 53 Qiradhenësi do të japë informacione shpjeguese për periudhën e raportimit, për shumat në vijim:
- (a) shpenzimin e amortizimit për aktivet me të drejtë përdorimi sipas klasave të aktivitetit bazë;
 - (b) shpenzimin e interesit për detyrimet e qirasë;
 - (c) shpenzimin lidhur me qiratë afatshkurtra të trajtuara sipas paragrafit 6, ky shpenzim nuk nevojitet të përfshihet në shpenzimet e lidhura me qiratë për afate të qirasë një muaj ose më pak;
 - (d) shpenzimin lidhur me qiratë e aktiveve me vlerë të ulët të trajtuara sipas paragrafit 6. Ky shpenzim nuk duhet të përfshihet në shpenzimin e lidhur me qiratë me afat të shkurtër të aktiveve me vlerë të ulët të përfshira në paragrafin 53(c);
 - (e) shpenzimin lidhur me pagesat variabël të qirasë të papërfshira në matjen e detyrimeve të qirasë;
 - (f) të ardhurën nga nën-qiraja e aktiveve me të drejtë përdorimi;
 - (g) daljet gjithsej të mjeteve monetare për qiratë;
 - (h) shtesat e aktiveve me të drejtë përdorimi;
 - (i) fitimet ose humbjet që vijnë nga transaksionet e shitjes dhe marrjes me qira; dhe
 - (j) vlerën kontabël (neto) të aktiveve me të drejtë përdorimi në fund të periudhës së raportimit sipas klasës së aktivitetit bazë.
- 54 Qiramarrësi duhet të japë informacionin shpjegues të specifikuar në paragrafin 53 në format tabelë, me përjashtim të rastit kur një format tjetër është më i përshtatshëm. Shumat e paraqitura në shënimet shpjeguese do të përfshijnë kostot që një qiramarrës ka përfshirë në vlerën kontabël (neto) të një aktivi tjetër gjatë periudhës së raportimit.
- 55 Qiramarrësi duhet të japë informacion shpjegues për shumën e angazhimeve të tij të qirasë për qiratë afatshkurtra të trajtuara sipas paragrafit 6 nëse portofoli i qirave afatshkurtra për të cilat ai angazhohet në fund të periudhës raportuese është i ndryshëm nga portofoli i qirave afatshkurtra, të cilave u përket shpenzimi i qirasë afatshkurter i paraqitur sipas kërkesave të paragrafit 53(c).
- 56 Nëse aktivet me të drejtë përdorimi plotësojnë përkufizimin e aktivitetit afatgjatë material të investuar, qiramarrësi do të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNK 40. Në këtë rast, qiramarrësi nuk ka nevojë të japë informacionet shpjeguese të paragrafit 53(a), (f), (h) ose (j) për këto aktive me të drejtë përdorimi.
- 57 Nëse një qiramarrës mat aktivet me të drejtë përdorimi me shumat e rivlerësuar duke zbatuar SNK 16, qiramarrësi duhet të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 77 i SNK 16 për këto aktive me të drejtë përdorimi.
- 58 Qiramarrësi duhet të japë informacion shpjegues mbi analizën e maturimit të detyrimeve të qirasë duke zbatuar paragrafët 39 dhe B11 të SNRF 7 *Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese* veçmas nga analizat e maturimit të detyrimeve të tjera financiare.
- 59 Përveç dhënies së informacioneve shpjeguese të kërkuara në paragrafët 53–58, qiramarrësi duhet të japë informacione shpjeguese shtesë cilësore dhe sasiore rreth aktiviteteve të tij të dhënies me qira, të nevojshme për të plotësuar objektivin për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafit 51 (siç përkrahëhet në paragrafin B48). Ky informacion shtesë mund të përfshijë, por nuk kufizohet me informacion që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare për të vlerësuar:
- (a) natyrën e aktiviteteve të dhënies me qira të qiramarrësit;
 - (b) daljet e ardhshme të mjeteve monetare për të cilat qiramarrësi është potencialisht i ekapozuar të cilat nuk janë reflektuar në matjen e detyrimeve të qirasë. Kjo përfshin ekapozimin që vjen nga:
 - (i) pagesat variabël të qirasë (siç përkrahëhet në paragrafin B49);
 - (ii) opsionet e zgjatjes dhe opsionet e përfundimit (siç përkrahëhet në paragrafin B50);
 - (iii) garancitë me vlerë të mbetur (siç përkrahëhet në paragrafin B51); dhe
 - (iv) qiratë ku është i angazhuar qiramarrësi, të cilat nuk kanë nisur akoma
 - (c) kufizimet ose marrëveshjet e imponuara nga qiratë; dhe
 - (d) transaksionet e shitjes dhe marrjes me qira (siç përkrahëhet në paragrafin B52).

- 60 Qiramarrësi që trajton qiratë afatshkurtra ose qiratë për aktive me vlerë të ulët sipas paragrafit 6 do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Qiradhënësi

Klasifikimi i qirave (paragrafët B53–B58)

- 61 Një qiradhënësi duhet të klasifikojë çdo qira të tij si *qira të zakonshme* ose si *qira financiare*.
- 62 Një qira klasifikohet si qira financiare nëse ajo transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin bazë. Një qira do të klasifikohet si qira e zakonshme në qoftë se nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin bazë.
- 63 Nëse një qira do të klasifikohet si qira financiare ose si qira e zakonshme, kjo varet më tepër nga përmbajtja e transaksionit se sa nga forma ligjore e kontratës. Shembuj të situatave që individualisht apo të kombinuara, normalisht do të çonin në klasifikimin e një qiraje si qira financiare janë:
- (a) qiraja transferon pronësinë e aktivit bazë tek qiramarrësi në fund të afatit të qirasë;
 - (b) qiramarrësi ka opsionin për ta blerë aktivin bazë me një çmim që pritet të jenë njëjtë me i ulët se *vlera e drejtë* në datën kur ky opsion bëhet i ushtrueshëm dhe ka siguri të arsyeshme, qysh në fillimin e qirasë, se opsioni do të ushtrohet;
 - (c) afati i qirasë përfshin pjesën më të madhe të *jetës ekonomike* të aktivit bazë edhe nëse titulli i pronësisë ende nuk është transferuar;
 - (d) në fillim të marrëveshjes së qirasë vlera aktuale e pagesave të qirasë përbën në mënyrë të konsiderueshme të paktën të gjithë vlerën e drejtë të aktivit bazë; dhe
 - (e) aktivi bazë ka një natyrë kaq të veçantë sa që atë mund t'a përdorë pa i bërë modifikime të mëdha vetëm qiramarrësi.
- 64 Tregues të situatave që individualisht ose të kombinuara mundet gjithashtu të çojnë në klasifikimin e qirasë si qira financiare janë:
- (a) nëse qiramarrësi mund të anultojë marrëveshjen e qirasë, humbjet e qiradhënësit lidhur me anulimin e marrëveshjes përballohen nga qiramarrësi;
 - (b) fitimet ose humbjet nga luhatjet në vlerën e drejtë të vlerës së mbetur i llogariten qiramarrësit (për shembull, në formën e zbritjeve tregtare mbi qiranë të cilat janë të barabarta me pothuaj të gjithë të ardhurat nga shërbimi në fund të qirasë); dhe
 - (c) qiramarrësi ka mundësi të vazhdojë marrëveshjen e qirasë për një periudhë të dytë me një pagesë qiraje e cila në mënyrë të konsiderueshme është më e ulët se qiraja në treg.
- 65 Shembujt dhe treguesit e paraqitur në paragrafët 63–64 nuk janë gjithmonë përfundimtarë. Nëse është e qartë edhe nga karakteristika të tjera se qiraja nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit bazë, qiraja klasifikohet si qira e zakonshme. Për shembull, ky mund të jetë rasti kur pronësia mbi aktivin bazë transferohet në fund të afatit të qirasë për një pagesë të ndryshueshme të barabartë me vlerën e drejtë të aktivit në atë moment, ose nëse ka pagesa qiraje të ndryshueshme, si rezultat i së cilës qiradhënësi nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e mundshme.
- 66 Klasifikimi i qirasë bëhet në datën e krijimit dhe rivlerësohet vetëm nëse ndodh një ndryshim (modifikim) i qirasë. Ndryshimi i parashikimeve (p.sh. ndryshimi në parashikimin jetës ekonomike, ose ndryshimi në vlerën e mbetur të aktivit bazë), apo ndryshime të rrethanave (për shembull mos kryerja e pagesave nga qiramarrësi), nuk çojnë nevojën e një klasifikimi të ri të qirasë për qëllime kontabël.

Qiratë financiare

Njohja dhe matja

- 67 Në datën e fillimit, qiradhënësi do të njohë aktivet e mbajtura sipas një kontrate qiraje financiare në pasqyrën e pozicionit financiar dhe do t'i paraqesë ato si një llogari e arkëtueshme me një shumë të barabartë me *investimin neto në qira*.

Matja fillestare

- 68 Për të matur investimin neto në qira qiradhënësi do të përdorë normën e interesit të përcaktuar të qirasë Në rastin e një nën-qiraje (dhënie të mëpasshme me qira), kur norma e interesit e përcaktuar në nën-qira nuk mund të përcaktohet lehtë, një qiradhënës i ndërmjetëm për të matur investimin neto në nën-qira, mund të zbatojë normën e skontimit të përdorur për qiranë kryesore (të rregulluar për çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të lidhur me nën-qiranë).
- 69 Përveç kostove direkte, që janë të ndryshme nga ato të prodhuesit apo qiradhënësit tregtarë të autorizuar, kostot fillestare të drejtpërdrejta përfshihen në matjen fillestare të investimit neto në qira dhe zvogëlojnë shumën e të ardhurave të njohura përgjatë afatit të qirasë. Norma e interesit të përcaktuar të qirasë përcaktohet në mënyrë të tillë që kostot fillestare të drejtpërdrejta të përfshihen automatikisht në investimin neto në qira; nuk ka nevojë që ato të shtohen veç e veç.

Matja fillestare e pagesave të qirasë të përfshira në investimin neto në qira

- 70 Në datën e fillimit, pagesat e qirasë të përfshira në matjen e investimit neto në qira përfshijnë pagesat në vijim për të drejtën e përdorimit të aktivit bazë gjatë afatit të qirasë të cilat nuk janë marrë në datën e fillimit:
- (a) pagesat fikse (përfshirë pagesat fikse në-thelb të përshkruara në paragrafin B42), minus çdo stimul qiraje të pagueshëm;
 - (b) pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit;
 - (c) çdo garanci me vlerë të mbetur dhënë qiradhënësit nga qiramarrësi, një palë e lidhur me qiramarrësin ose një palë e tretë e palidhur me qiradhënësin e cila është e aftë financiarisht për të shlyer detyrimet sipas garancisë;
 - (d) çmimi i ushtrimit të një opsiioni blerje nëse qiramarrësi është një aftësi për ta ushtruar këtë opsiion (i vlerësuar duke marrë në konsideratë faktorët e përshkruar në paragrafin B37); dhe
 - (e) pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë reflekton ushtrimin nga qiramarrësin të një opsiioni për përfundimin e qirasë.

Qiradhënësit prodhues ose tregtarë

- 71 Në datën e fillimit, një qiradhënës prodhues ose tregtar do të njohë për secilën prej qirave financiare të tij si në vijim:
- (a) të ardhurën e cila është vlera e drejtë e aktivit bazë, ose nëse është më e ulët, vlerën aktuale të pagesave rritëse të qirasë për qiradhënësin, të skontuara duke përdorur një normë interesi tregu;
 - (b) koston e shitjes, e cila është kosto, ose nëse është e ndryshme, vlera kontabël neto e aktivit bazë, të pakësuar me vlerën aktuale të *vlerës së mbetur të pa garantuar*; dhe
 - (c) fitimin ose humbjen nga shitja (si diferencë midis të ardhurës dhe koston së shitjes) në përputhje me politikën e tij për shitjen e drejtpërdrejtë për të cilën zbatohet SNRF 15. Një qiradhënës prodhues ose tregtar duhet të njohë fitimin ose humbjen nga shitja në një qira financiare në datën e fillimit, pavarësisht nëse qiradhënësi transferon aktivin bazë siç përshkruhet në SNRF 15.
- 72 Prodhuesit apo tregtarët shpesh ofrojnë për konsumatorët zgjedhjen mes blerjes ose marrjes me qira të një aktivi. Një qira financiare e një aktivi nga një qiradhënës prodhues ose tregtar sjell fitim ose humbje ekuivalente me fitimin apo humbjen që vjen nga një shitje e drejtpërdrejtë e aktivit bazë, me çmimet normale të shitjes, duke pasqyruar zbritje e mundshme për vëllim apo tregtare.
- 73 Qiradhënësi prodhues ose tregtar ndonjëherë publikojnë norma interesi artificiale më të ulëta, me qëllim që të tërheqin klientët. Përdorimi i një norme të tillë interesi do të sillte që qiradhënësi të njohë një pjesë më të madhe në totalin e të ardhurave nga ky transaksion në momentin e fillimit. Nëse publikohen norma interesi artificiale të ulëta, një qiradhënës prodhues apo tregtar duhet të kufizojë fitimin nga shitja deri në atë masë sikur të ishin aplikuar normat e interesit të tregut.
- 74 Një qiradhënës prodhues ose tregtar do të njohë si shpenzim, kostot e ndodhura për marrjen e një qiraje financiare në datën e fillimit, sepse ato lidhen kryesisht me fitimin nga shitja të prodhuesit apo tregtarit. Kostot e ndodhura nga qiradhënësi prodhues ose tregtar në lidhje me marrjen e një qiraje financiare përjashtohen nga përkufizimi i kostove fillestare të drejtpërdrejta dhe përjashtohen nga investimi neto në qira.

Matja e mëpasshme

- 75 **Një qiradhënës do të njohë të ardhurën financiare përgjatë afatit të qirasë, bazuar në një model që reflekton një përqindje konstante periodike të kthimit të investimit neto, për qiradhënësin, në qira.**
- 76 Qiradhënësi synon të shpërndajë të ardhurën financiare përgjatë afatit të qirasë në mënyrë sistematike dhe racionale. Qiradhënësi do të zbatojë pagesat e qirasë për një periudhë të caktuar, kundrejt *investimit bruto në qira* për të zvogëluar si principalin, ashtu edhe të ardhurën e përcaktuar financiare.
- 77 Qiradhënësi duhet të zbatojë kërkesat për mosnjohje (regjistrim) dhe çvlerësim të SNRF 9 për investimin neto në qira. Një qiradhënës duhet të rishikojë në mënyrë të rregullt vlerësimet për vlerat e mbetura të pa garantuara të përdorura gjatë llogaritjes së investimit bruto në qira. Nëse ka pasur rënie në vlerësimet për vlerat e mbetura të pa garantuara, atëherë qiradhënësi duhet të rishikojë shpërndarjen e të ardhurës përgjatë afatit të qirasë dhe do të njohë menjëherë çdo zvogëlim të shumave të përlogaritura më parë.
- 78 Një qiradhënës që klasifikon një aktiv sipas një qiraje financiare si i mbajtur për shitje (ose e përfshin atë në grupin e aktiveve të dala jashtë përdorimit të klasifikuar si i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 *Aktive Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Vepërmatirë e Ndërprera*, duhet ta trajtojë aktivin në përputhje me atë Standard.

Ndryshimet e qirasë

- 79 Qirararësi do ta trajtojë një ndryshim të qirasë financiare si një qira të veçantë nëse njëkohësisht:
- (a) ndryshimi me objektin e qirasë duke shtuar të drejtën për përdorim të një ose më shumë aktiveve bazë; dhe
 - (b) shumën e qirasë rritet me një shumë të krahasueshme me çmimin specifik për rritjen në objekt dhe ndonjë rregullim përkatës të këtij çmimi specifik për të reflektuar rrethanat e kontratës përkatëse.
- 80 Për një ndryshim në një qira financiare e cila nuk është trajtuar si qira e veçantë, një qiradhënës do të trajtojë ndryshimin si vijon:
- (a) nëse qiraja do të ishte klasifikuar si një qira e zakonshme për shkak të hyrjes në fuqi të ndryshimit në datën e fillimit, qiradhënësi do të:
 - (i) trajtojë ndryshimin në qira si një qira të re që nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimit; dhe
 - (ii) masë vlerën kontabël (neto) të aktivit bazë si investimi neto në qira, menjëherë para datës së hyrjes në fuqi të ndryshimit të qirasë.
 - (b) përndryshe, qiradhënësi do të zbatojë kërkesat e SNRF 9.

Qiratë e zakonshme

Njohja dhe matja

- 81 **Një qiradhënës duhet të njohë pagesat e qirasë nga qiratë e zakonshme si të ardhura mbi baza lineare ose mbi ndonjë bazë tjetër sistematike. Qiradhënësi do të zbatojë një bazë tjetër sistematike nëse ajo bazë është më përfaqësuese për mënyrën sesi pakësohet përfitimi nga përdorimi i aktivit bazë.**
- 82 Qiradhënësi do të njohë në shpenzime kostot përfshirë amortizimin, të kryera për të fituar të ardhura nga qiraja.
- 83 Qiradhënësi do të përfshijë kostot fillestare të drejtpërdrejta, të kryera për sigurimin e një qiraje të zakonshme në vlerën kontabël (neto) të aktivit bazë dhe do të njohë këto kosto si shpenzim përgjatë afatit të qirasë mbi të njëjtën bazë si dhe njohja e të ardhurës nga qiraja.
- 84 Politika e amortizimit për aktivet bazë të amortizueshme subjekt i qirasë së zakonshme do të jetë në përputhje me politikën e zakonshme që qiradhënësi përdor për amortizimin e aktiveve të ngjashme. Qiradhënësi do të llogarisë amortizimin në përputhje me SNK 16 dhe SNK 38.
- 85 Një qiradhënës do të zbatojë SNK 36 për të përcaktuar nëse aktivi bazë subjekt i një qiraje të zakonshme çvlerësohet dhe për të kontabilizuar humbjen e identifikuar nga zhvlerësimi.
- 86 Një qiradhënës prodhues apo tregtar nuk njeh ndonjë fitim nga shitja si pasojë e lidhjes së një kontrate qiraje të zakonshme, sepse ajo nuk është ekuivalente me një shitje.

Ndryshimet e qirasë

- 87 Qiradhënësi do të trajtojë një ndryshim në një qira të zakonshme si një qira të re që nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimit, duke marrë në konsideratë çdo pampagim ose pagesë ritëse lidhur me qiranë fillestare si pjesë të pagesave të qirasë për qiranë e re.

Paraqitja

- 88 Qiradhënësi do të paraqesë aktivet bazë që janë subjekt i qirasë së zakonshme në pasqyrën e tij të pozicionit financiar në përputhje me natyrën e aktivitetit bazë.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 89 **Objekti i dhënies së informacioneve shpjeguese është që qiradhënësi të japë informacione shpjeguese në shënime, të cilat së bashku me informacionet e dhëna në pasqyrën e pozicionit financiar, në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje) dhe në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, japin një bazë për përdoruesit e pasqyrave financiare për të vlerësuar efektin që qiratë kanë në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare të qiradhënësit. Paragrafët 90–97 specifikojnë kërkesat se si duhet plotësuar ky objekt.**

- 90 Për periudhën e raportimit, qiradhënësi do të japë informacione shpjeguese për shumat në vijim:

- (a) për qiratë financiare:
 - (i) fitimin ose humbjen nga shitja;
 - (ii) të ardhurën financiare nga investimi neto në qira; dhe
 - (iii) të ardhurën lidhur me pagesat variabël të qirasë të papërfshira në matjen e investimit neto në qira;
- (b) për qiratë e zakonshme, të ardhurën nga qiraja, duke dhënë informacione shpjeguese veçmas për të ardhurën lidhur me pagesat variabël të qirasë, të cilat nuk varen nga një indeks ose normë.

- 91 Qiradhënësi do të japë informacione shpjeguese të cilësuar në paragrafin 90 në format të tabelave, me përjashtim të rastit kur një format tjetër është më i përshtatshëm.

- 92 Qiradhënësi do të japë informacione shpjeguese shtesë, cilësore dhe sasore, mbi aktivitetet e tij të qiradhënies të nevojshme për të plotësuar objektin e dhënies së informacioneve shpjeguese në paragrafin 89. Ky informacion shtesë mund të përfshijë, por nuk kufizohet me, informacion që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare për të vlerësuar:

- (a) natyrën e aktivitetit të qiradhënies të qiradhënësit; dhe
- (b) sesi qiradhënësi menaxhon rrezikun e lidhur me ndonjë të drejtë që ai mban ndaj aktiveve bazë. Veçanërisht, qiradhënësi duhet të japë informacione shpjeguese mbi strategjinë e tij të menaxhimit të rrezikut për të drejtat që ai mban në aktivet bazë, përfshirë mjetet me të cilat qiradhënësi pakëson këtë rrezik. Mjete të tilla mund të përfshijnë, për shembull, marrëveshjet e riblerjes, garancitë për vlerën e mbetur ose pagesat variabël të qirasë për përdorim përtej kufijve të përcaktuar.

Qiratë financiare

- 93 Qiradhënësi do të japë një shpjegim cilësor dhe sasior të ndryshimeve të rëndësishme në vlerën kontabël (neto) të investimit neto në qiratë financiare.

- 94 Qiradhënësi do të paraqesë një analizë të maturimit të pagesave të arkëtueshme të qirasë, duke treguar pagesat e qirasë të paskontuara për t'u marrë mbi baza vjetore për të paktën çdo njërin nga pesë vitet e para dhe një total për shumat për vitet e mbetura. Qiradhënësi do të rakordojë pagesat e paskontuara të qirasë me investimin neto në qira. Rakordimi do të identifikojë të ardhurën e përcaktuar financiare lidhur me pagesat e arkëtueshme të qirasë dhe ndonjë vlerë të mbetur të pa garantuar të paskontuar.

Qiratë e zakonshme

- 95 Për zërat e aktiveve afatgjata materiale subjekt i një qiraje të zakonshme, qiradhënësi duhet të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNK 16. Kur zbaton kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNK 16, qiradhënësi do të ndajë çdo klasë të aktiveve afatgjata materiale në aktive subjekt i qirave të zakonshme dhe aktive që nuk janë subjekt i qirave të zakonshme. Prandaj, qiradhënësi do të japë

informacionet shpjeguese të kërkuara nga SNK 16 për aktivet subjekt i një qiraje të zakonshme (sipas klasës së aktivit bazë) veçmas nga aktivet në zotërim, të mbajtura dhe të përdorur prej tij.

- 96 Qiradhënësi do të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNK 36, SNK 38, SNK 40 dhe SNK 41 për aktivet subjekt i qirave të zakonshme.
- 97 Një qiradhënës do të paraqesë një analizë të maturimit të pagesave të qirasë, duke treguar pagesat e qirasë të paskontuara për t'u marrë mbi baza vjetore për të paktën çdo njërin nga pesë vitet e para dhe një total për shumat për vitet e mbetura.

Transaksionet e shitjes dhe të marrjes me qira

- 98 Nëse një njësi ekonomike (shitësi-qiramarrës) transferon një aktiv tek një njësi tjetër ekonomike (blerësi-qiradhënës) dhe e jep atë aktiv me qira tek blerësi-qiradhënës, që të dy, si shitësi-qiramarrës ashtu edhe blerësi-qiradhënës, duhet ta trajtojnë kontratën e transferimit dhe të qirasë sipas paragrafëve 99–103.

Vlerësimi se kur transferimi i aktivit është një shitje

- 99 Për të përcaktuar nëse transferimi i një aktivit trajtohet si shitje e atij aktivit, njësi ekonomike duhet të zbatojë kërkesat në SNRF 15 lidhur me plotësimin e një kushti performance.

Transferimi i aktivit është një shitje

- 100 Nëse transferimi i një aktivit nga shitësi-qiramarrës plotëson kërkesat e SNRF 15 për t'u trajtuar si një shitje aktiv:
- (a) shitësi-qiramarrës do të masë aktivin me të drejtë për përdorim që vjen nga shitja dhe marrja me qira, me pjesën e vlerës kontabël (neto) të mëparshme të aktivit që lidhet me të drejtën e përdorimit të mbajtur nga shitësi-qiramarrës. Pra, shitësi-qiramarrës do të njohë vetëm shumën e ndonjë fitimi ose humbje që lidhet me të drejtat e transferuara tek blerësi-qiradhënës.
 - (b) blerësi-qiradhënës do të trajtojë blerjen e aktivit sipas Standardeve të zbatueshme dhe do të trajtojë qiranë duke zbatuar kërkesat e këtij Standardi për trajtimin kontabël nga qiradhënësi.
- 101 Nëse vlera e drejtë e shumës për shitjen e aktivit nuk barazon vlerën e drejtë të aktivit, ose nëse pagesat për qiranë nuk janë sa vlerat e tregut, për të matur të ardhurat nga shitja me vlerën e drejtë një njësi ekonomike do të bëjë rregullimet në vijim
- (a) çdo element poshtë vlerës së tregut do të trajtohet si një papagim i pagesave të qirasë; dhe
 - (b) çdo element mbi vlerën e tregut do të trajtohet si financim shtesë dhënë nga blerësi-qiradhënës për shitësin-qiramarrës.
- 102 Njësi ekonomike do të masë çdo rregullim të mundshëm të kërkuar nga paragrafi 101 bazuar në një ose më shumë përcaktues të gatshëm të:
- (a) diferencës mes vlerës së drejtë të shumës për shitjen dhe vlerës së drejtë të aktivit; dhe
 - (b) diferencës mes vlerës aktuale të pagesave të kontraktuara për qiranë dhe vlerës aktuale të pagesave për qiranë sipas normave të tregut.

Transferimi i aktivit nuk është një shitje

- 103 Nëse transferimi i një aktivit nga shitësi-qiramarrës nuk plotëson kërkesat e SNRF 15 për t'u trajtuar si një shitje aktiv:
- (a) shitësi-qiramarrës do të vazhdojë të njohë aktivin e transferuar dhe të njohë një detyrim financiar të barabartë me shumat nga transferimi. Ai duhet ta trajtojë detyrimin financiar duke zbatuar SNRF 9.
 - (b) blerësi-qiradhënës nuk do të njohë aktivin e transferuar dhe të njohë një aktiv financiar të barabartë me shumat nga transferimi. Ai duhet të trajtojë aktivin financiar duke zbatuar SNRF 9.

Shtojca A

Termet e përkufizuara

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

data e fillimit të qirasë (data e fillimit)	Data në të cilën një qiradhënësi e bën aktiv bazë të gatshëm për tu përdorur nga një qiramarrës .
jeta ekonomike	Ose periudha gjatë së cilës një aktiv pritet të jetë ekonomikisht i përdorshëm nga një ose më shumë përdorues ose numri i njërive të prodhuara ose njërive të ngjashme që pritet të merren nga aktivi nga një ose më shumë përdorues.
data e hyrjes në fuqi të ndryshimit	Data kur të dyja palët bien dakord me një ndryshim të qirasë .
vlera e drejtë	Me qëllim zbatimin e kërkesave të këtij Standardi për trajtimin kontabël nga ana e qiradhënësit , vlera e drejte është shuma për të cilën mund të shkëmbehet një aktiv, ose të shlyhet një detyrim, ndërmjet palëve të mirë informuara, të vullnetshme në një transaksion të lirë midis tyre.
qira financiare	Një qira , e cila transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e një aktivi bazë .
pagesat fikse	Pagesat e bëra nga një qiramarrës tek një qiradhënësi për të drejtën e përdorimit të një aktivi bazë gjatë afatit të qirasë , duke përjashtuar pagesat variabël të qirasë .
investimi bruto në qira	Totali i: (a) pagesave të qirasë që një qiradhënësi do të arkëtojë sipas një marrëveshjeje të qirasë financiare ; dhe (b) i ndonjë vlere të mbetur të pa garantuar , e përllogaritur për qiradhënësin.
data e fillimit të qirasë (data e fillimit)	Më e hershja mes datës së marrëveshjes së qirasë dhe datës së angazhimit nga të dy palët ndaj kushteve kryesore të marrëveshjes së qirasë.
kosto fillestare e drejtpërdrejtë	Kostot shtesë (ritëse) të marrjes së një qiraje që nuk do të ishin kryer nëse qiraja nuk të ishte marrë, me përjashtim të kostove të kryera nga një qiradhënësi prodhues ose tregtar i autorizuar lidhur me një qira financiare .
normë interesi e përcaktuar e qirasë	Norma e interesit e cila bën që vlera aktuale e (a) pagesave të qirasë dhe (b) vlërës së mbetur të pa garantuar , të barazojë shumën e (i) vlërës së drejtë të aktivit bazë dhe (ii) të çdo kostoje fillestare të drejtpërdrejtë të qiradhënësit.
qira	Një kontratë ose pjesë e një kontrate, e cila i jep të drejtën e përdorimit të një aktivi (të aktivi bazë) për një periudhë kohore në këmbim të një shume.
stimujt e qirasë	Pagesat e qirasë të bëra nga një qiradhënësi për një qiramarrës të lidhura me një qira ose rimbursimi apo marrja përsipër nga një qiradhënësi e kostove të qirasë.
ndryshimi i qirasë	Një ndryshim në objektin e një qiraje , ose në shumën e e një qiraje, i cili nuk ishte pjesë e kushteve dhe termave fillestare të qirasë (për shembull, shtimi ose përfundimi i të drejtës për përdorim të një ose më shumë aktiveve bazë , apo zgjatja apo shkurtimi i afatit kontraktual të qirasë).

pagesat e qirasë	Pagesat e bëra nga një qiramarrës për një qiradhënës për të drejtën e përdorimit të një aktivi bazë gjatë afatit të qirasë, duke përfshirë pagesat variabël të qirasë. (a) pagesat fikse (duke përfshirë pagesat fikse në thelb), minus çdo stimul të qirasë; (b) pagesat variabël të qirasë të cilat varen në një indeks ose normë; (c) çmimi i ushtrimit të një opsiioni blerjeje nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për të ushtruar këtë opsiion; dhe (d) pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë nënkupton që qiramarrësi ushtron një opsiion për përfundimin e qirasë. Për qiramarrësin, pagesat e qirasë përfshijnë edhe shumat e pritshme për t'u paguar nga qiramarrësi sipas garancive për vlerën e mbetur. Pagesat e qirasë nuk përfshijnë pagesat e shpërndara tek përbërësit jo-qira të një kontrate, me përjashtim të rastit kur qiramarrësi zgjedh të kombinojë përbërësit jo-qira me një përbërës qira dhe ta trajtojë ata si një përbërës të vetëm qiraje. Për qiradhënësin, pagesat e qirasë përfshijnë edhe çdo garanci për vlerën e mbetur dhënë qiradhënësit nga qiramarrësi, një palë e lidhur me qiramarrësin ose një palë të tretë të palidhur me qiradhënësin, e cila është e aftë financiarisht për të shlyer detyrimet sipas garancisë. Pagesat e qirasë nuk përfshijnë pagesat e shpërndara tek përbërësit jo-qira.
afati i qirasë	Periodha e paanullueshme për të cilën një qiramarrës ka të drejtë të përdorë një aktiv bazë, së bashku me: (a) periudhat e mbuluara nga një opsiion për të zgjatur qiranë, nëse qiramarrësi ka siguri të mjaftueshme për të ushtruar këtë opsiion; dhe (b) periudhat e mbuluara nga një opsiion për të përfunduar qiranë nëse qiramarrësi është i sigurt mjaftueshëm për të mos e ushtruar atë opsiion.
qiramarrësi	Njësia ekonomike, e cila merr të drejtën e përdorimit të një aktivi bazë për një periudhë kohore në këmbim të një shume.
normë e shtesë (rritëse) e huamarrjes të qiramarrësit	Norma e interesit që një qiramarrës do të duhet të paguante për të marrë hua me kushte të njëjta dhe siguri të ngjashme, fondet e nevojshme për të siguruar një aktiv të së njëjtës vlerë me aktivin me të drejtë përdorimi në një mjedis ekonomik të ngjashëm.
qiradhënësi	Njësia ekonomike, e cila jep të drejtën e përdorimit të një aktivi bazë për një periudhë kohore në këmbim të një shume.
investimi neto në qira	Investimi bruto në qira i skontuar me përqindjen e normës së interesit të përcaktuar të qirasë .
qira e zakonshme	Një qira e cila nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë mbi një aktiv bazë .
pagesat opsionale të qirasë	Pagesat për t'u bërë nga një qiramarrës tek një qiradhënës për të drejtën e përdorimit të një aktivi bazë gjatë periudhave të mbuluara nga një opsiion për të zgjatur ose përfunduar një qira , që nuk përfshihet në afatin e qirasë .
periudha e përdorimit	Periodha kohore gjithsej që një aktiv përdoret për të plotësuar një kontratë me një klient (duke përfshirë çdo periudhë kohore jo-të njëpasnjëshme).
garanci për vlerën e mbetur	Një garanci e dhënë ndaj një qiradhënësi , nga një palë e palidhur me qiradhënësin, se vlera (ose pjesë e vlerës) e një aktivi bazë në fund të një qiraje do të jetë të paktën një shumë e caktuar.
aktiv me të drejtë përdorimi	Një aktiv që përfaqëson një të drejtë të qiramarrësin për të përdorur një aktiv bazë gjatë afatit të qirasë .
qira afatshkurtër	Një qira , e cila në datën e fillimit , ka një afat qiraje 12 muaj ose më pak. Një qira e cila përmban një opsiion blerjeje nuk është qira afatshkurtër.
nënqira	Një transaksion, për të cilin aktivin bazë rrijet me qira nga një qiramarrës ("qiradhënës i ndërmjetëm") tek një palë e tretë dhe qiraja ("qiraja kryesore") mes qiradhënësit kryesor dhe qiramarrësit mbetet në fuqi.

aktiv bazë	Një aktiv që është subjekt i një qiraje , për të cilën e drejta e përdorimit të tij është dhënë nga një qiradhënë s tek një qiramarrës .
e ardhur financiare e parrealizuar	Diferenca midis: (a) investimit bruto në qira ; dhe (b) investimit neto në qira .
vlerë e mbetur e pa garantuar	Pjesa e vlerës së mbetur të aktivit bazë , realizimi i së cilës nga një qiradhënë s nuk është i sigurtë ose është i garantuar vetëm nga një palë tjetër e lidhur me qiradhënësin.
pagesat e ndryshueshme të qirasë	Pjesa e pagesave të bëra nga një qiramarrës tek një qiradhënë s për të drejtën e përdorimit të një aktivi bazë përgjatë afatit të qirasë , e cila ndryshon për shkak të ndryshimeve në faktet apo rrethanat e ndodhura pas datës së fillimit , të ndryshme nga kalimi i kohës.

Termet e përkufizuara në Standardet e tjera dhe të përdorur në këtë Standard me të njëjtin kuptim

kontrata	Një marrëveshje mes dy ose më shumë palëve, që krijon të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme me forcë.
jeta e dobishme	Periodha gjatë së cilës një aktiv pritet të jetë i disponueshëm për përdorim nga njësi ekonomike, ose sasia e prodhimit apo njësi të ngjashme që priten të merren nga aktivi prej njësisë ekonomike.

Shtojca B

Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit. Ajo përshkruan aplikimin e paragrafëve 1-103 dhe ka të njëjtin autoritet si dhe pjesët e tjera të Standardit.

Zbatimi për portofolin

- B1 Ky Standard specifikon trajtimin kontabël të një qiraje individuale. Por, për lehtësi praktike, njësia ekonomike mund ta zbatojë këtë Standard për një portofol qirash me karakteristika të ngjashme, nëse njësia ekonomike pret, në mënyrë të arsyeshme, që efektet e zbatimit të këtij Standardi ndaj portofolit në pasqyrat financiare nuk do të ndryshojnë shumë nga zbatimi i këtij Standardi për qiratë individuale brenda këtij portofoli. Gjatë trajtimit kontabël të një portofoli, njësia ekonomike do të përdorë vlerësime dhe supozime të cilat reflektojnë madhësinë dhe përbërjen e portofolit.

Kombinimi i kontratave

- B2 Gjatë zbatimit të këtij Standardi, njësia ekonomike do të kombinojë dy ose më shumë kontrata të lidhura njëkohësisht ose afërsisht në të njëjtën kohë, me të njëjtën palë (ose me palë të lidhura me të) dhe kontabilizojë kontratat si një kontratë e vetme nëse plotësohen një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme:
- (a) kontratat negociohen si një paketë me një objektiv tregtar të përbashkët, që nuk mund të kuptohet nëse kontratat nuk merren në konsideratë së bashku;
 - (b) shumat për t'u paguar në një kontratë varet nga çmimi ose performanca e kontratës tjetër; ose
 - (c) të drejtat e përdorimit të aktiveve bazë, të përfshira në kontrata (ose disa të drejta për përdorimin e aktiveve bazë të përfshira në secilën kontratë) formojnë një përbërës të vetëm qiraje sipas përshkrimit në paragrafin B32.

Përrjashtim në njohje: qiratë për të cilat aktivi bazë ka vlerë të ulët (paragrafët 5–8)

- B3 Me përrjashtim sa specifikohet në paragrafin B7, ky Standard lejon që një qiramarrës të zbatojë paragrafin 6 për të trajtuar qiratë për të cilat aktivi bazë ka vlerë të ulët. Qiramarrësi do të vlerësojë vlerën e një aktivi bazë bazuar në vlerën e aktivit kur ai është i ri, pavarësisht vjetërsisë së aktivit që jepet me qira.
- B4 Vlerësimi nëse aktivi bazë ka vlerë të ulët bëhet mbi një bazë absolute. Qiratë e aktiveve me vlerë të ulët kualifikohen për trajtimin kontabël të paragrafit 6, pavarësisht nëse këto qira janë materiale për qiramarrësin. Vlerësimi nuk ndikohet nga madhësia, natyra apo rrethanat e qiramarrësit. Për pasojë, qiramarrës të ndryshëm parashikohet të dalin në përfundime të njëjta nëse një aktiv bazë i caktuar është me vlerë të ulët.
- B5 Një aktiv bazë mund të jetë me vlerë të ulët vetëm nëse:
- (a) qiramarrësi mund të përfitojë nga përdorimi i aktivit bazë të vetëm ose bashkë me burime të tjera, që t janë në dispozicion të qiramarrësit; dhe
 - (b) aktivi bazë nuk varet shumë nga, ose nuk është shumë i lidhur me aktivet e tjera.
- B6 Qiraja e një aktivi bazë nuk kualifikohet si qira e një aktivi me vlerë të ulët nëse natyra e aktivit është e tillë që kur është i ri, zakonisht aktivi nuk është me vlerë të ulët. Për shembull, qiratë e makinave nuk do të kualifikohen si qira të aktiveve me vlerë të ulët, sepse një makinë e re zakonisht nuk është me vlerë të ulët.
- B7 Nëse një qiramarrës jep me nën-qira një aktiv, ose pret të japë me nën-qira një aktiv, qiraja kryesore nuk kualifikohet si qira aktivi me vlerë të ulët.
- B8 Shembuj të aktiveve bazë me vlerë të ulët mund të përfshijnë tabletat dhe kompjuterët personalë, zëra të vegjël të pajisjeve të zyrës dhe telefonat.

Identifikimi i një qiraje (paragrafët 9–11)

- B9 Për të vlerësuar nëse një kontratë jep të drejtën e kontrollit të përdorimit të një aktivi të identifikuar (shih paragrafët B13–B20) për një periudhë kohore, njësi ekonomike do të vlerësojë nëse, përgjatë *periudhës së përdorimit*, klienti ka të dyja sa vijon:
- (a) të drejtën për të marrë pothuajse të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit të identifikuar (siç përsëritet në paragrafët B21–B23); dhe
 - (b) të drejtën për të drejtuar përdorimin e aktivit të identifikuar (siç përsëritet në paragrafët B24–B30).
- B10 Nëse klienti ka të drejtën të kontrollojë përdorimin e një aktivi të identifikuar vetëm për një pjesë të afatit të kontratës, kontrata pëmban një qira për atë pjesë të afatit.
- B11 Një kontratë për të marrë mallra apo shërbime mund të lidhet nëpërmjet një marrëveshjeje të përbashkët, ose për llogari të një marrëveshjeje të përbashkët, siç përsëritet në SNRF 11 *Marrëveshjet e Përbashkëta*. Në këtë rast, marrëveshja e përbashkët konsiderohet të jetë klienti në kontratë. Për pasojë, kur vlerësohet nëse një kontratë e tillë pëmban një qira, njësi ekonomike do të vlerësojë nëse marrëveshja e përbashkët ka të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar përgjatë periudhës së përdorimit.
- B12 Njësi ekonomike do të vlerësojë nëse një kontratë pëmban një qira për secilin përbërës potencial të veçantë të qirasë. Paragrafi B32 shërben si udhëzues mbi përbërësit e veçantë të qirasë.

Aktivi i identifikuar

- B13 Një aktiv zakonisht identifikohet duke u cilësuar qartë në kontratë. Megjithatë aktivi mund të identifikohet edhe duke u specifikuar në mënyrë të qartë në kohën kur aktivi bëhet i gatshëm për përdorim nga klienti.

Të drejtat thelbësore të zëvendësimit

- B14 Edhe nëse një aktiv specifikohet, klienti nuk ka të drejtën e përdorimit të një aktivi të identifikuar nëse furnitori ka të drejtën thelbësore të zëvendësimit të aktivit përgjatë periudhës së përdorimit. E drejta e furnitorit për zëvendësimin e një aktivi është thelbësore vetëm nëse ekzistojnë njëkohësisht të dy kushtet e mëposhtme:
- (a) furnitori ka aftësitë praktike për të zëvendësuar aktivet alternative përgjatë periudhës së përdorimit (për shembull, klienti nuk mund të ndalojë furnitorin nga zëvendësimi i aktivit dhe aktivet alternative janë të gatshme për furnitorin ose mund të bëhet disponibel nga furnitori brenda një periudhe kohore të arsyeshme); dhe
 - (b) furnitori do të përfitojë ekonomikisht nga ushtrimi i të drejtës së tij për të zëvendësuar aktivin (d.m.th. përfitimet ekonomike të lidhura me zëvendësimin e aktivit pritet të tejkalojnë kostot e lidhura me zëvendësimin e aktivit).
- B15 Nëse furnitori ka të drejtën ose detyrimin për të zëvendësuar aktivin vetëm në një datë të caktuar ose pas kësaj date, apo me ndodhjen e një ngjarje të caktuar, e drejta e furnitorit për zëvendësim nuk është thelbësore, sepse furnitori nuk ka aftësi praktike për të zëvendësuar me aktivet alternative përgjatë gjithë periudhës së përdorimit.
- B16 Vlerësimi i njësisë ekonomike se e drejta e furnitorit për zëvendësim është thelbësore bazohet në faktet dhe rrethanat në fazën fillestare të kontratës dhe do të përjashtojë shumën e ngjarjeve të ardhshme, të cilat në fazën fillestare të kontratës nuk janë konsideruar të mundshme për të ndodhur. Shembuj të ngjarjeve të ardhshme, të cilat në fazën fillestare të kontratës janë konsideruar të pamundura për të ndodhur dhe në këtë mënyrë duhet të përjashtohen nga vlerësimi, përfshijnë:
- (a) një marrëveshje me një klient të ardhshëm për të paguar mbi normën e tregut për përdorimin e aktivit;
 - (b) futja e teknologjisë së re, e cila nuk ka qenë shumë e zhvilluar në fazën fillestare të kontratës;
 - (c) një diferencë e rëndësishme mes përdorimit të aktivit nga klienti, ose performancës së aktivit dhe përdorimit apo performancës të konsideruar të mundshme në fazën fillestare të kontratës të kontratës; dhe
 - (d) një diferencë e rëndësishme mes çmimit të tregut të aktivit gjatë periudhës së përdorimit dhe çmimit të tregut të konsideruar të mundshëm në fazën fillestare të kontratës.

- B17 Nëse aktivi vendoset në mjediset e klientit ose diku tjetër, kostot që lidhen me zëvendësimin zakonisht janë më të larta sesa kur aktivi vendoset në mjediset e furnitorit dhe prandaj ka shumë mundësi të tejkalojnë përfitimet e lidhura me zëvendësimin e aktivit.
- B18 E drejta ose detyrimi i furnitorit për të zëvendësuar aktivin për riparime dhe mirëmbajtje nëse, aktivi nuk funksionon si duhet ose nëse duhet të bëhet një përmirësim teknik, nuk e përjashton klientin nga e drejta e përdorimit të një aktivi të identifikuar.
- B19 Në qoftë se klienti nuk mund të përcaktojë menjëherë nëse furnitori ka një të drejtë thelbësore për zëvendësim, klienti duhet të supozojë se çdo e drejtë për zëvendësim nuk është thelbësore.

Pjesët e aktiveve

- B20 Pjesë e një aktivi është një aktiv i identifikuar në qoftë se ai është i dallueshëm fizikisht (për shembull dyshemeja e një ndërtese). Pjesë të tjera të aktivit, të cilat nuk janë të dallueshme fizikisht (për shembull pjesa e një kablli fibër optike) nuk janë aktive të identifikuara, me përjashtim të rastit kur ato përfaqësojnë pothuajse të gjithë kapacitetin e aktivit dhe prandaj i japin klientit të drejtën të marrë pothuajse të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit.

E drejta për të marrë përfitimet ekonomike nga përdorimi

- B21 Për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, një klient duhet të ketë të drejtën të marrë pothuajse të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i aktivit gjatë periudhës së përdorimit, (për shembull nëpërmjet të drejtës ekskluzive të përdorimit të aktivit përgjatë asaj periudhe). Klienti mund të marrë përfitime ekonomike nga përdorimi i një aktivi drejtpërdrejt ose indirekt në shumë mënyra, të tilla si nëpërmjet përdorimit, mbajtjes ose dhënies më tej me qira të aktivit. Përfitimet ekonomike, nga përdorimi i një aktivi përfshijnë outputin kryesor të tij dhe çdo nën-produkt (duke përfshirë fluksat e mundshme të mjeteve monetare që vijnë nga këto zëra) dhe të tjera përfitime ekonomike nga përdorimi i aktivit, që mund të realizohen nga një transaksion tregtar me një palë të tretë.
- B22 Kur vlerësohet e drejta për të marrë pothuajse të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i një aktivi, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë të gjitha përfitimet ekonomike, që vijnë nga përdorimi i aktivit brenda objektit të përcaktuar të së drejtës së klientit për përdorimin e aktivit (shih paragrafin B30). Për shembull:
- (a) nëse një kontratë kufizon përdorimin e një mjeti motorik vetëm në një territor të caktuar gjatë periudhës së përdorimit, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë vetëm përfitimet ekonomike nga përdorimi i mjetit motorik brenda atij territori dhe jo përtej.
 - (b) nëse një kontratë specifikon se një klient mund të drejtojë një mjet motorik vetëm deri në një numër të caktuar miljesh (ose kilometrash) gjatë periudhës së përdorimit, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë vetëm përfitimet ekonomike nga përdorimi i mjetit motorik brenda, kilometrazhit të lejuar dhe jo përtej.
- B23 Nëse kontrata kërkon që një klient të paguajë furnitorin ose një palë tjetër me një pjesë të fluksit të mjeteve monetare që vijnë nga përdorimi i një aktivi si shumë, këto fluksat të mjeteve monetare të paguara si shumë do të konsiderohen si pjesë e përfitimeve ekonomike, që klienti merr nga përdorimi i aktivit. Për shembull, nëse klientit i kërkohet që t'i paguajë furnitorit një përqindje të shitjeve nga përdorimi i hapësirës për shitjet me pakicë, si shumë për këtë përdorim, kërkesa nuk përjashton klientin të ketë të drejtën për të marrë pothuajse të gjitha përfitimet ekonomike nga përdorimi i hapësirës për shitjet me pakicë. Kjo sepse fluksat e mjeteve monetare, që vijnë nga këto shitje konsiderohen si përfitime ekonomike që klienti merr nga përdorimi i hapësirës për shitjet me pakicë, një pjesë e së cilës i paguhet furnitorit si shumë për të drejtën e përdorimit të asaj hapësire.

E drejta për të drejtuar përdorimin

- B24 Klienti ka të drejtën të drejtojë (urdhërojë) përdorimin e një aktivi të identifikuar përgjatë periudhës së përdorimit vetëm nëse:
- (a) klienti ka të drejtë të drejtojë (urdhërojë) si dhe për çfarë qëllimi është përdorur aktivi përgjatë periudhës së përdorimit (siç përshkruhet në paragrafët B25–B30); ose
 - (b) vendimet kryesore lidhur me mënyrën si dhe për çfarë është përdorur aktivi janë të paracaktuara dhe:

- (i) klienti ka të drejtë të përdorë aktivin (ose të drejtë [urdhërojë] të tjerët në përdorimin e aktivit sipas mënyrës së tij) përgjatë periudhës së përdorimit dhe furnitori nuk ka të drejtë t'i ndryshojë këto udhëzime përdorimi; ose
- (ii) klienti ka modeluar aktivin (ose disa aspekte specifike të aktivit) në një mënyrë që paracakton si dhe për çfarë qëllimi do të përdoret aktivi gjatë periudhës së përdorimit.

Si dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi

- B25 Klienti ka të drejtë të drejtë (urdhërojë) si dhe për çfarë qëllimi të përdoret aktivi, në qoftë se brenda objektit të së drejtës së tij për përdorim të përcaktuar në kontratë, ai mund të ndryshojë si dhe për çfarë qëllimi të përdoret aktivi përgjatë gjithë periudhës së përdorimit. Gjatë bërjes së këtij vlerësimi, njësia ekonomike merr në konsideratë të drejtat e vendimmarrjes, që janë më të përshtatshme për ndryshimin, si dhe për çfarë qëllimi të përdoret aktivi përgjatë gjithë periudhës së përdorimit. Të drejtat e vendimmarrjes janë të përshtatshme kur ato ndikojnë përfitimet ekonomike, që do të vijnë nga përdorimi. Të drejtat e vendimmarrjes, që janë më të përshtatshme, ka shumë mundësi të jenë të ndryshme për kontrata të ndryshme, në varësi të natyrës së aktivit dhe termave e kushteve të kontratës.
- B26 Shembuj të të drejtave të vendimmarrjes që, në varësi të rrethanave, japin të drejtën e ndryshimit si dhe për çfarë qëllimi të përdoret aktivi, brenda objektit të përcaktuar në të drejtën e përdorimit të klientit, përfshijnë:
- (a) të drejtat e ndryshimit të llojit të outputit të prodhuar nga aktivi (për shembull, për të vendosur nëse të përdorë një kontenier për transportin e mallrave apo një magazinë, ose për të vendosur lidhur me përzjerjen e produkteve të shitura nga hapësirat për shitjet me pakicë);
 - (b) të drejtat e ndryshimit kur është prodhuar outputi (për shembull, për të vendosur nëse do të përdoret një zë i makinerive ose një central elektrik);
 - (c) të drejtat për të ndryshuar vendin ku të prodhohet outputi (për shembull, për të vendosur destinacionin e një kamioni apo anijeje, ose për të vendosur se ku të përdoret një pajisje); dhe
 - (d) të drejtat për të ndryshuar nëse do të prodhohet outputi dhe sasinë e atij outputi (për shembull, për të vendosur nëse energjia do të prodhohet nga një central elektrik dhe sasia e energjisë që do të prodhohet nga ai central).
- B27 Shembuj të të drejtave të vendimmarrjes, që nuk japin të drejtën për të ndryshuar si dhe për çfarë qëllimi të përdoret aktivi, përfshijnë të drejtat që kufizohen në funksionimin ose mirëmbajtjen e aktivit. Të drejta të tilla mund të mbahen nga klienti ose furnitori. Megjithatë të drejta të tilla si ato për të vënë në shfrytëzim ose mirëmbajtur një aktiv shpesh janë esenciale për përdorimin efektiv të aktivit, ato nuk janë të drejta për të drejtuar si dhe për çfarë qëllimi të përdoret aktivi dhe shpesh varen nga vendimeve si dhe për çfarë qëllimi përdoret aktivi. Megjithatë, të drejtat për të shfrytëzuar aktivin mund t'i japin një klienti të drejtën të drejtë përdorimin e një aktivi, nëse vendimet përkatëse dhe se për çfarë qëllimi të përdoret aktivi janë të paracaktuara (shih paragrafin B24(b)(i)).


Vendimet e përcaktuara gjatë dhe para periudhës së përdorimit

- B28 Vendimet përkatëse lidhur me mënyrën si dhe për çfarë qëllimi të përdoret aktivi mund të paracaktohen në mënyra të ndryshme. Për shembull, vendimet përkatëse mund të paracaktohen nëpërmjet modelimit të aktivit ose nëpërmjet kufizimeve kontraktuale në përdorimin e aktivit.
- B29 Kur vlerësohet nëse një klient ka të drejtën të drejtë [urdhërojë] përdorimin e një aktivi, njësia ekonomike duhet të marrë parasysh vetëm të drejtat për të marrë vendime lidhur me përdorimin e një aktivi gjatë periudhës së përdorimit, me përjashtim të rastit kur klienti e modelon aktivin (ose aspekte të caktuara të aktivit) siç përkrahët në paragrafin B24(b)(ii). Për pasojë, me përjashtim të rastit kur ekzistojnë kushtet në paragrafin B24(b)(ii), njësia ekonomike nuk do t'i marrë në konsideratë vendimet e paracaktuara para periudhës së përdorimit. Për shembull, nëse klienti është në gjendje vetëm të specifikojë outputin e një aktivi para periudhës së përdorimit, ai nuk ka të drejtë të drejtë [urdhërojë] përdorimin e atij aktivi. Afërsia për të specifikuar outputin në një kontratë para periudhës së përdorimit, pa të drejtë tjetër vendimmarrjeje lidhur me përdorimin e aktivit, i jep klientit të njëjtat të drejta si çdo klient që blen mallra ose shërbime.

Të drejtat mbrojtëse

- B30 Një kontratë mund të përfshijë terma dhe kushte që synojnë të mbrojnë interesin e furnitorit në aktivin ose në aktivet e tjera, për të mbrojtur personelin e tij, ose për të siguruar pajtueshmërinë e furnitorit me ligjet apo rregulloret. Këto janë shembuj të të drejtave mbrojtëse. Për shembull një kontratë mund t'i specifikojë shumën maksimale të përdorimit të një aktivi ose të kufizojë se ku ose kur klienti mund të

përdorë aktivin, (ii) të kërkojë që klienti të ndjekë praktika të caktuara shfrytëzimi, ose (iii) të kërkojë që klienti të informojë furnitorin për ndryshimet sesi do të përdoret një aktiv. Zakonisht të drejtat mbrojtëse përkufizojnë objektin e të drejtës për përdorim të klientit por nuk ndalojnë të izoluar klientin që të ketë të drejtën për drejtimin [urdhërimin] e përdorimit të një aktivi.



Ndarja e përbërësve të një kontrate (paragrafët 12–17)

- B32 E drejta e përdorimit të një aktivi bazë është një përbërës qiraje i veçantë nëse njëkohësisht:
- (a) qiramarrësi mund të përfitojë nga përdorimi i aktivit bazë, i vetëm ose nga përdorimi i tij bashkë me burime të tjera të cilat janë dispozicion të qiramarrësit. Burime të gatshme në dispozicion janë mallrat apo shërbimet të cilat janë shtur ose dhënë me qira veçmas (nga qiradhënësi ose furnitorë të tjerë) ose burime të cilat qiramarrësi tashmë i ka siguruar (nga qiradhënësi ose nga transaksione apo ngjarje të tjera), dhe
 - (b) aktivi bazë nuk varet shumë ose nuk është shumë i lidhur me aktivet e tjera bazë në kontratë. Për shembull fakti që një qiramarrës mund të vendosë të mos japë me qira aktivin bazë pa ndikuar ndjeshëm të drejtat e tij për përdorimin e aktiveve të tjera bazë në kontratë, mund të tregojë që aktivi bazë nuk është shumë i varur ose shumë i lidhur me këto aktive të tjera bazë.
- B33 Kontrata mund të përfshijë një shumë të pagueshme nga qiramarrësi për aktivitetet dhe kostot, të cilat nuk transferojnë një mall apo shërbim tek qiramarrësi. Për shembull, qiradhënësi mund të përfshijë në shumën totale të pagueshme një komision për detyra administrative ose kosto të tjera që ai kryen lidhur me qiranë, të cilat nuk transferojnë një mall apo një shërbim tek qiramarrësi. Shuma të tilla të pagueshme nuk sjellin një përbërës të veçantë të kontratës por konsiderohen si pjesë e shumës totale, e cila shpërndahet tek përbërësit e identifikuar veçmas në kontratë.

Afati i qirasë (paragrafët 18–21)

- B34 Kur përcaktohet afati i qirasë dhe vlerësohet gjatësia e periudhës së paanullueshme të një qiraje, njësia ekonomike duhet të zbatohet përkufizimin e një kontrate dhe duhet të përcaktojë periudhën për të cilën kontrata është detyruese. Një qira nuk është më detyruese nëse si qiramarrësi ashtu edhe qiradhënësi kanë të drejtë të përfundojnë qiranë pa marrë leje nga pala tjetër, përveçse me një gjobë të parëndësishme.
- B35 Nëse vetëm qiramarrësi ka të drejtë të përfundojë një kontratë qiraje, kjo e drejtë konsiderohet si një opsion për përfundim të qirasë i vlefshëm për qiramarrësin të cilin njësia ekonomike e merr në konsideratë kur përcakton afatin e qirasë. Nëse vetëm qiradhënësi ka të drejtë të përfundojë një kontratë qiraje, periudha e paanullueshme e qirasë përfshin periudhën e mbuluar nga opsioni për të përfunduar qiranë.
- B36 Afati i qirasë nis në datën e fillimit dhe përfshin çdo periudhë qiraje falas që qiradhënësi i ka dhënë qiramarrësit.
- B37 Në datën e fillimit, njësia ekonomike vlerëson nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme sigurt për të ushtruar opsionin për zgjatje të qirasë ose për të blerë aktivin bazë, ose për të mos ushtruar opsionin për të përfunduar qiranë. Njësia ekonomike merr në konsideratë të gjithë faktet dhe rrethanat përkatëse të cilat krijojnë stimul ekonomik për qiramarrësin për të ushtruar, apo për të mos ushtruar opsionin, duke përfshirë çdo ndryshim të pritshëm në faktet dhe rrethanat që nga data e fillimit deri në datën e ushtrimit të opsionit. Shembuj të faktorëve që duhen konsideruar përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
- (a) termat dhe kushtet kontraktuale për periudhat opsionale, krahasuar me normat e tregut të tilla si:
 - (i) shumën e pagesave për qiranë në çdo periudhë opsionale,
 - (ii) shumën e çdo pagese variabël për qiranë ose pagese tjetër të lidhur me të, të tillë si pagesat që vijnë nga gjobat për përfundim dhe garancitë për vlerën e mbetur, dhe
 - (iii) termat dhe kushtet e çdo opsioni që janë të ushtrueshme pas periudhave fillestare të opsionit (për shembull, një opsion për blerje, i cili është i ushtrueshëm në fund të një periudhe të zgjatur, me një normë që është aktualisht poshtë normave të tregut).
 - (b) përmirësimet e rëndësishme të ndëmarra në kontratën e qirasë (ose që pritet të ndëmerren) gjatë afatit të kontratës, të cilat pritet të kenë përfitime ekonomike të rëndësishme për qiramarrësin, ku opsioni për zgjatje ose për përfundim të kontratës së qirasë, ose për të blerë aktivin bazë bëhet i ushtrueshëm.
 - (c) kostot lidhur me përfundimin e qirasë, të tilla si kostot e negociimit, kostot e alokimit, kostot e identifikimit të një aktivi tjetër bazë të përshtatshëm për nevojat e qiramarrësit, kostot e integritetit të një aktivi të ri në aktivitetin e qiramarrësit, ose gjobat e përfundimit dhe kosto të ngjashme, duke përfshirë kostot që lidhen me kthimin e aktivit bazë në gjendjen e specifikuar në kontratë apo në një vend të specifikuar me kontratë;
 - (d) rëndësia e aktivit bazë për aktivitetet e qiramarrësit, duke marrë në konsideratë për shembull nëse aktivi bazë është një aktiv i specializuar, vendodhjen e aktivit bazë dhe mundësinë e alternativave të përshtatshme, dhe

- (e) kushtëzimin lidhur me ushtrimin e opsionit (d.m.th nëse opsioni mund të ushtrohet vetëm kur plotësohen një apo më shumë kushte) dhe mundësinë që këto kushte do të ekzistojnë.
- B38 Opsioni për të zgjidhur ose përfunduar një kontratë qiraje mund të kombinohet me një ose më shumë tipare të tjera kontraktuale (për shembull, një garanci për vlerën e mbetur) të tilla si qiramarrësi i garanton qiradhënësit një kthim minimal apo fiks në mjete monetare, që është në thelb i njëjtë pavarësisht nëse opsioni është ushtruar. Në raste të tilla, dhe pavarësisht udhëzimit në paragrafin B42 për pagesat fikse në thelb, njësia ekonomike duhet të supozojë se qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për të ushtruar opsionin për zgjatje të kontratës së qirasë ose për të mos ushtruar opsionin për përfundimin e kontratës së qirasë.
- B39 Sa më e shkurtër të jetë periudha e paanullueshme e qirasë, aq më shumë ka mundësi që qiramarrësi të ushtrtojë opsionin për zgjatje të qirasë ose të mos ushtrtojë opsionin për përfundim të qirasë. Kjo sepse kostot që lidhen me marrjen e një aktivi zëvendësues ka shumë mundësi të jenë proporcionalisht të larta sa më e shkurtër është periudha e paanullueshme e qirasë.
- B40 Eksperiencia praktike e mëparshme e një qiramarrësi lidhur me periudhën gjatë së cilës zakonisht ai ka përdorur lloje të caktuara aktivesh (të marra me qira apo në pronësi) dhe arsyet ekonomike të kësaj zgjedhjeje, mund të japin informacion që është i dobishëm për të vlerësuar nëse qiramarrësi është i sigurt në mënyrë të arsyeshme për të ushtruar ose jo një opsion. Për shembull, nëse një qiramarrës zakonisht ka përdorur lloje të caktuara aktivesh për një periudhë të caktuar kohe ose nëse qiramarrësi e ka zakon të ushtrtojë në mënyrë të shpeshtë opsionet mbi qiratë e disa llojeve të caktuara të aktiveve bazë, qiramarrësi duhet të marrë në konsideratë arsyet ekonomike për këtë eksperiencë praktike kur vlerëson nëse është i sigurt në mënyrë të arsyeshme për të ushtruar një opsion qiraje për këto aktive.
- B41 Paragrafi 20 specifikon se pas datës së fillimit, qiramarrësi rivekseron afatin e qirasë sipas ndodhjes së një ngjarjeje apo ndryshimi të rëndësishëm në rrethanat që janë nën kontrollin e qiramarrësit dhe ndikojnë nëse qiramarrësi është i sigurt në mënyrë të arsyeshme për të ushtruar një opsion jo të përfshirë më parë në përcaktimin e tij në afatin e qirasë ose për të mos ushtruar një opsion të përfshirë më parë në përcaktimin e tij të afatit të qirasë. Shembuj të ngjarjeve ose ndryshimeve të rëndësishme në rrethanat përfshijnë:
- (a) përmirësimet të rëndësishme në kontratën e qirasë të paparashikuara në datën e fillimit, të cilat pritet të kenë përfitime ekonomike të rëndësishme për qiramarrësin kur bëhet i ushtrueshëm opsioni për zgjatje ose për përfundim të kontratës së qirasë, ose për të blerë aktivin bazë;
 - (b) një ndryshim i rëndësishëm në aktivin bazë, ose në përshatjen e tij, që nuk ishte paralajmëruar në datën e fillimit;
 - (c) fillimi i një nën-qiraje të aktivit bazë për një periudhë përtej përfundimit të afatit të përcaktuar më parë të qirasë; dhe
 - (d) një vendim biznesi i qiramarrësit që është drejtpërdrejt i lidhur me ushtrimin ose jo të një opsioni (për shembull, vendimi për të zgjidhur qiranë e një aktivi plotësues, për të nxjerrë jashtë përdorimit një aktiv tjetër alternativ ose për të nxjerrë jashtë përdorimit një njësi biznesi në të cilën përdoret aktivi me të drejtë përdorimi).

Pagesat e qirasë fikse në thelb (paragrafët 27(a), 36(c) dhe 70(a))

- B42 Pagesat e qirasë përfshijnë çdo pagesë qiraje fikse në thelb. Pagesat e qirasë fikse në thelb janë pagesa të cilat në formë mund të përmbajnë ndryshueshmëri, por në thelb janë të pashtangshme. Pagesat e qirasë fikse në thelb ekzistojnë nëse, për shembull:
- (a) pagesat janë strukturuar si pagesa qiraje variabël, por nuk ka një ndryshim të vërtetë në këto pagesa. Këto pagesa përmbajnë klauzola variabël, të cilat nuk kanë thelb ekonomik. Shembuj të këtyre llojeve të pagesave përfshijnë:
 - (i) pagesat që duhet të bëhen vetëm nëse një aktiv provohet se është në gjendje të funksionojë gjatë qirasë ose vetëm nëse ndodh një ngjarje e cila nuk ka mundësi reale për të mos ndodhur; ose
 - (ii) pagesat që fillimisht janë strukturuar si pagesa qiraje variabël të lidhura me përdorimin e aktivit bazë, por për të cilat ndryshueshmëria do të zgjidhet në një moment pas datës së fillimit, kështu që pagesa bëhet fikse për pjesën e mbetur të afatit të qirasë. Këto pagesa bëhen pagesa fikse në thelb kur zgjidhet ndryshueshmëria.
 - (b) ka më shumë se një grup pagesash që mund të bëjë qiramarrësi por vetëm një nga këto grupe pagesash është real (i vërtetë). Në këtë rast, njësia ekonomike do të marrë në konsideratë grupin e vërtetë të pagesave si pagesa të qirasë.

- (c) ka më shumë se një grup real pagesash që qiramarrësi mund të bëjë por ai duhet të bëjë të paktën një nga këto grupe pagesash. Në këtë rast, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë grupin e pagesave që bashkon shumën më të ulët (mbi një bazë të skontuar) si pagesa të qirasë.

Përfshirja e qiramarrësit me aktivin bazë para datës së fillimit

Kostot e qiramarrësit lidhur me ndërtimin ose modelimin e një aktivi bazë

- B43 Njësia ekonomike mund ta negociojë një qira para se aktivi bazë të jetë gati për përdorim nga qiramarrësi. Për disa qira, aktivi bazë mund të ketë nevojë të ndërtohet ose ri modelohet për përdorim nga qiramarrësi. Në varësi të termave dhe kushteve të kontratës, qiramarrësi mund të kërkojë të bëjë pagesa lidhur me ndërtimin apo modelimin e aktivit.
- B44 Nëse një qiramarrës kryen shpenzime kosto lidhur me ndërtimin apo modelimin e një aktivi bazë, ai duhet t'i trajtojë këto kosto duke zbatuar Standardet përkatëse si SNK 16. Kostot e lidhura me ndërtimin apo modelimin e një aktivi bazë nuk përfshijnë pagesat e bëra nga qiramarrësi për të drejtën e përdorimit të aktivit bazë. Pagesat për të drejtën e përdorimit të një aktivi bazë janë pagesa për një qira, pavarësisht kohës së kryerjes së këtyre pagesave.

Titulli ligjor mbi aktivin bazë

- B45 Qiramarrësi mund të marrë titullin ligjor të një aktivi bazë para se titulli ligjor të transferohet tek qiradhënësi dhe aktivi t'i jepet me qira qiramarrësit. Marrja e titullit ligjor nuk përcakton në vetvete sesi duhet trajtuar transaksioni.
- B46 Nëse qiramarrësi kontrollon (ose merr kontrollin e) aktivit bazë para se aktivi të transferohet tek qiradhënësi, transaksioni është një shitje dhe marrje me qira dhe trajtohet sipas kërkesave të paragrafëve 98–103.
- B47 Por nëse qiramarrësi nuk merr kontrollin e aktivit bazë para se aktivi të transferohet tek qiradhënësi, transaksioni nuk është një transaksion shitje dhe marrje me qira. Për shembull ky mund të jetë rasti kur një prodhues, një qiradhënësi dhe një qiramarrës negociojnë një transaksion për blerjen e një aktivi nga prodhuesi nga qiradhënësi, i cili nga ana e tij e jep aktivin me qira tek qiramarrësi. Qiramarrësi mund të marrë titullin ligjor të aktivit bazë para transferimit të titullit ligjor tek qiradhënësi. Në këtë rast, nëse qiramarrësi merr titullin ligjor të aktivit bazë por nuk merr kontrollin e aktivit para se ai të transferohet tek qiradhënësi, transaksioni nuk trajtohet si transaksion i shitjes dhe marrjes me qira por si qira.

Dhënie informacionesh shpjeguese nga qiramarrësi (paragrafi 59)

- B48 Kur vlerëson nëse nevojitet informacion shtesë mbi aktivitetin e qiramarrjes për të plotësuar kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 51, një qiramarrës duhet të marrë në konsideratë:
- (a) nëse ky informacion është i rëndësishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare. Qiramarrësi duhet të japë informacionin shtesë të specifikuar në paragrafin 59 vetëm nëse ky informacion pritet të jetë i rëndësishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare. Në këtë kontekst, kjo ka shumë gjasa të ndodhë nëse ky informacion i ndihmon përdoruesit të kuptojnë:
- (i) fleksibilitetin e ofruar nga qiratë. Qiratë mund të ofrojnë fleksibilitet nëse, për shembull, qiramarrësi mund të pakësojë ekspozimin e tij duke ushtruar opsione përfundimi ose rinovimi të qirave me terma dhe kushte të favorshme.
 - (ii) kufizimet e imponuara nga qiratë. Qiratë mund të imponojnë kufizime, për shembull duke kërkuar që qiramarrësi të mbajë tregues financiarë të caktuar.
 - (iii) ndjeshmëria e informacionit të raportuar për variablat kyç. Informacioni i raportuar mund të jetë i ndjeshëm, për shembull, ndaj pagesave të ardhshme variabël të qirasë.
 - (iv) ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera që vijnë nga qiratë.
 - (v) devijimet nga praktika industriale. Devijime të tilla mund të përfshijnë për shembull terma dhe kushte qiraje jo të zakonshme ose unike, të cilat ndikojnë portofolin e qirave të një qiramarrësi.
- (b) nëse ky informacion është i dallueshëm qartë nga informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare kryesore ose informacioni i dhënë në shënimet shpjeguese. Qiramarrësi nuk ka nevojë të dublojë informacionin që është tashmë paraqitur në pjesët e tjera të pasqyrave financiare.

- B49 Informacioni shtesë lidhur me pagesat variabël të qirasë, i cili në varësi të rrethanave mund të nevojitet për të plotësuar objektivin për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafit 51, mund të përfshijë informacionin që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë, për shembull:
- (a) arsyet e qiramarrësit për të përdorur pagesat variabël të qirasë dhe përparësinë e këtyre pagesave;
 - (b) madhësinë relative të pagesave variabël të qirasë ndaj pagesave fikse;
 - (c) variablat kyç nga të cilët varen pagesat variabël të qirasë dhe sesi këto pagesa priten të ndryshojnë në përgjigje të ndryshimeve në këto variabla kyç; dhe
 - (d) efektet e tjera operative dhe financiare të pagesave variabël të qirasë.
- B50 Informacioni shtesë lidhur me opsionet për zgjatje apo përfundim, i cili në varësi të rrethanave mund të nevojitet për të plotësuar objektivin për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafit 51, mund të përfshijë informacionin që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë, për shembull:
- (a) arsyet e qiramarrësit për të përdorur opsionet për zgjatje apo përfundim dhe prevalencën e këtyre opsioneve;
 - (b) madhësinë relative të *pagesave opsionale të qirasë* ndaj pagesave të qirasë;
 - (c) prevalencën e ushtrimit të opsioneve të papërfshira në matjen e detyrimeve të qirasë; dhe
 - (d) efektet e tjera operative dhe financiare të këtyre opsioneve.
- B51 Informacioni shtesë lidhur me garancitë për vlerën e mbetur, i cili në varësi të rrethanave mund të nevojitet për të plotësuar objektivin për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafit 51, mund të përfshijë informacionin që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë, për shembull:
- (a) arsyet e qiramarrësit për të dhënë garanci për vlerën e mbetur dhe prevalencën e këtyre garancive;
 - (b) madhësinë e ekspozimit të qiramarrësit ndaj rrezikut të vlerës së mbetur;
 - (c) natyrën e aktiveve bazë për të cilën janë dhënë këto garanci; dhe
 - (d) efektet e tjera operative dhe financiare të këtyre garancive.
- B52 Informacioni shtesë lidhur me transaksionet e shitjes dhe marrjes me qira, i cili në varësi të rrethanave mund të nevojitet për të plotësuar objektivin për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafit 51, mund të përfshijë informacionin që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë, për shembull:
- (a) arsyet e qiramarrësit për transaksionet e shitjes dhe marrjes me qira dhe prevalencën e këtyre transaksioneve;
 - (b) temat dhe kushtet kyç të transaksioneve individuale të shitjes dhe marrjes me qira;
 - (c) pagesat e pa përfshira në matjen e detyrimeve të qirasë; dhe
 - (d) efektin në fluksin e mjeteve monetare të transaksioneve të shitjes dhe marrjes me qira në periudhën e raportimit.

Klasifikimi i qirasë për qiradhënësin (paragrafët 61–66)

- B53 Klasifikimi i qirave për qiradhënësin në këtë Standard bazohet në madhësinë në të cilën qiraja transferon rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë mbi aktivin bazë. Rreziqet përfshijnë mundësinë e humbjeve nga mospërdorimi ose nga vjetërsimi teknologjik i aktivitetit dhe i ndryshimit në kthim për shkak të ndryshimit të kushteve ekonomike. Përfitimet mund të paraqiten nëpërmjet pritshmërive të aktivitetit fitimprurës përgjatë jetës ekonomike të aktivitetit bazë dhe fitimi nga rivlerësimi në rritje i vlerës së aktivitetit ose nga realizimi i një vlere të mbetur.
- B54 Një kontratë qiraje mund të përfshijë tema dhe kushte për të rregulluar pagesat e qirasë për ndryshime të caktuara, të cilat ndodhën midis datës së fillimit dhe datës së nisjes (të tilla si një ndryshim në koston e qiradhënësit të aktivitetit bazë ose një ndryshim në koston e qiradhënësit për financimin e qirasë). Në këtë rast, me qëllim klasifikimin e qirasë, efekti i çdo ndryshimi të tillë do të njihet se ka ndodhur në datën e fillimit.
- B55 Kur qiraja përfshin elementët tokë dhe ndërtesa, qiradhënësi do të vlerësojë klasifikimin e secilit element si qira financiare ose të zakonshme veç e veç, në përputhje me paragrafët 62–66 dhe B53–B54. Në përcaktimin nëse elementi i tokës është qira e zakonshme apo financiare, është e rëndësishme të mbahet parasysh se toka normalisht ka një jetë ekonomike të papërcaktuar.
- B56 Sa herë që është e nevojshme të klasifikojë dhe të llogarisë qiranë e tokës dhe të ndërtesave, qiradhënësi duhet t'i shpërndajë pagesat e qirasë (duke përfshirë dhe pagesat paraprake në fillim të qirasë) midis elementëve tokë dhe ndërtesa, në përputhje me vlerat e drejta përkatëse të interesit të qiramarrësit mbi elementët tokë dhe ndërtesa në momentin e fillimit të qirasë. Nëse pagesat e qirasë nuk mund të

shpërndahen midis këtyre dy elementëve, marrëveshja e qirasë klasifikohet si qira financiare, përveç rastit kur është e qartë se të dy elementët janë qira e zakonshme, çka do të thotë se e gjithë marrëveshja e qirasë klasifikohet si qira e zakonshme.

- B57 Për qiranë e tokës dhe ndërtesave në të cilën shumën për elementin tokë nuk është materiale për qiranë, qiradhënësi mund t'i trajtojë tokën dhe ndërtesat si një njësi e vetme për qëllime klasifikimi të qirasë dhe ta klasifikojë atë si qira financiare ose si qira të zakonshme duke zbatuar paragrafët 62–66 dhe B53–B54. Në rastet e tilla, qiradhënësi duhet të konsiderojë jetën ekonomike të ndërtesave si jeta ekonomike e gjithë aktivitetit bazë.

Klasifikimi i nënqirasë

- B58 Në klasifikimin e një nënqiraje, një qiradhënësi i ndërmjetëm do të klasifikojë nën qiranë si qira financiare ose të zakonshme, si vijon:
- (a) nëse qiraja kryesore është qira afatshkurtër, të cilën njësia ekonomike si qiramarrës e ka trajtuar në përputhje me paragrafin 6, nën qiraja do të klasifikohet si qira e zakonshme.
 - (b) përndryshe, nënqiraja do të klasifikohet duke ju referuar aktivitetit me të drejtë përdorimi që vjen nga qiraja kryesore, dhe jo duke ju referuar aktivitetit bazë (për shembull zëri toka, ndërtesa, makineri e pajisje që është objekt i qirasë).

Shtojca C

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është një pjesë integrale e Standardit dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të Standardit.

Data e hyrjes në fuqi

- C1 Njësia ekonomike duhet ta zbatojë këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2019 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm për njësitë ekonomike që zbatojnë SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët* në datën e zbatimit për herë të parë të këtij Standardi ose më parë. Nëse njësia ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Periudha kalimtare

- C2 Për qëllime të kërkesave në paragrafët C1–C19, data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës vjetore raportuese për të cilën njësia ekonomike zbaton për herë të parë këtë Standard.

Përkufizimi i qirasë

- C3 Për lehtësi praktike, njësia ekonomike nuk i kërkohet të rivlerësojë nëse kontrata është, apo përmban, një qira në datën e zbatimit për herë të parë. Por në vend të kësaj njësia ekonomike lejohet:
- (a) të zbatojë këtë Standard për kontrata të cilat ishin identifikuar fillimisht si qira duke zbatuar SNK 17 *Qiratë* dhe KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një Marrëveshje është marrëveshje Qiraje*. Njësia ekonomike duhet të zbatojë kërkesat për periudhën kalimtare të paragrafëve C5–C18 për këto qira.
 - (b) të mos zbatojë këtë Standard për kontrata të cilat nuk ishin identifikuar më parë se përmbanin një qira në zbatim të SNK 17 dhe KIRFN 4.
- C4 Nëse njësia ekonomike zgjedh lehtësinë praktike të paragrafit C3, ajo do të japë informacion shpjegues mbi këtë fakt dhe do të zbatojë lehtësinë praktike për të gjitha kontratat e saj. Për pasojë, njësia ekonomike duhet të zbatojë kërkesat në paragrafët 9–11 vetëm për kontratat e lidhura (ose të ndryshuara) në datën e zbatimit fillestar ose më pas.

Qiramarrësit

- C5 Qiramarrësi duket të zbatojë këtë Standard për qiratë e tij ose:
- (a) në mënyrë retrospektive për çdo periudhë raportimi të paraqitur duke zbatuar SNK 8 *Politikat Kontabël*, *Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël* dhe *Gabimet*; ose
 - (b) në mënyrë retrospektive, duke njollur efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Standardi në datën e zbatimit për herë të parë në përputhje me paragrafët C7–C8.
- C6 Qiramarrësi duhet të zbatojë zgjedhjen e përslikruar në paragrafin C5 në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha qiratë e tij në të cilat ai është qiramarrës.
- C7 Nëse një qiramarrës zgjedh të zbatojë këtë Standard në përputhje me paragrafin C5(b), qiramarrësi nuk duhet të riparaqesë informacion krahasues. Por qiramarrësi duhet të njohë efektin e akumuluar të zbatimit fillestar të këtij Standardi si një rregullim në tepriçën e fitimeve të pashpërndara (ose një përbërës tjetër të kapitali neto, cili është më i përshtatshëm) në datën e zbatimit për herë të parë.

Qiratë e klasifikuara më parë si qira e zakonshme

- C8 Nëse një qiramarrës zgjedh të zbatojë këtë Standard në përputhje me paragrafin C5(b), qiramarrësi duhet:
- (a) të njohë një detyrim të qirasë në datën e zbatimit fillestar për qiratë e klasifikuara më parë si qira e zakonshme duke zbatuar SNK 17. Qiramarrësi duhet të masë këtë detyrim të qirasë me vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, të skontuara duke përdorur normën rritëse të huamarrjes së qiramarrësit në datën e zbatimit për herë të parë.

- (b) të njohë një aktiv e drejtë për përdorim në datën e zbatimit fillestar për qiratë e klasifikuara më parë si qira e zakonshme duke zbatuar SNK 17. Qiramarrësi duhet të zgjedhë, mbi baza individuale, të masë aktivin me të drejtë përdorimi ose:
- (i) me vlerën kontabël (neto) të tij sikur Standardi të ishte zbatuar që nga data e fillimit, por të skontuar duke përdorur normën rritëse të huamartjes të qiramarrësit në datën e zbatimit për herë të parë, ose
 - (ii) me një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë, të rregulluar për shumën e ndonjë pagese qiraje të parapaguar ose të maturuar lidhur me atë qira të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar para datës së zbatimit për herë të parë.
- (c) të zbatojë SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve* për aktivin me të drejtë përdorimi në datën e zbatimit fillestar, me përjashtim të rastit kur qiramarrësi zbaton lehtësinë praktike të paragrafit C10(b).
- C9 Pavarësisht kërkesave në paragrafin C8, për qiratë e klasifikuara më parë si qira të zakonshme duke zbatuar SNK 17, një qiramarrësi:
- (a) nuk i kërkohej të bëjë ndonjë rregullim në periudhën kalimtare për qiratë për të cilat aktiv i bazë ka vlerë të ulët (siç përshkruhet në paragrafet B3-B8) dhe do të trajtohet në përputhje me paragrafin 6. Qiramarrësi duhet të trajtojë këto qira duke zbatuar këtë Standard nga data e zbatimit fillestar.
 - (b) nuk i kërkohej të bëjë ndonjë rregullim në periudhën kalimtare për qiratë e trajtuara më parë si një aktiv afatgjatë material i investuar sipas modelit të vlerës së drejtë të SNK 40 *Aktiv Afatgjatë Material i Investuar*. Qiramarrësi duhet të trajtojë aktivin me të drejtë përdorimi dhe detyrimin e qirasë që vjen nga këto qira duke zbatuar SNK 40 dhe këtë Standard që nga data e zbatimit fillestar.
 - (c) do të masë aktivin me të drejtë përdorimi me vlerën e drejtë në datën e zbatimit për herë të parë për qiratë e trajtuara më parë si qira e zakonshme duke zbatuar SNK 17 dhe i duhet të trajtojë atë si një aktiv afatgjatë material të investuar duke përdorur modelin e vlerës së drejtë në SNK 40 nga data e zbatimit fillestar. Qiramarrësi duhet të trajtojë aktivin e drejtë për përdorim dhe detyrimin e qirasë që vjen nga këto qira duke zbatuar SNK 40 dhe këtë Standard që nga data e zbatimit fillestar.
- C10 Qiramarrësi mund të përdorë një ose më shumë prej lehtësive praktike në vijim kur zbaton këtë Standard në mënyrë retrospektive në përputhje me paragrafin C5(b) për qiratë e klasifikuara më para si qira të zakonshme duke zbatuar SNK 17. Qiramarrësi lejohet të zbatojë këto lehtësi praktike mbi baza individuale (rast pas rasti):
- (a) qiramarrësi mund të zbatojë një normë skontimi të vetme për një portofol qirash me karakteristika të ngjashme në mënyrë të arsyeshme (të tilla si qiratë me afate qiraje të mbetura të ngjashme për një klasë të ngjashme të aktivit bazë në një mjedis ekonomik të ngjashëm).
 - (b) qiramarrësi mund të mbështetet në vlerësimin e tij nëse qiratë janë detyruese duke zbatuar SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushëzuara dhe Aktivet e Kushëzuara* menjëherë para datës së zbatimit fillestar si një alternativë për kryerjen e një rishikimi për çvlerësim. Nëse një qiramarrës zgjedh këtë lehtësi praktike, ai duhet të rregullojë aktivin me të drejtë përdorimi në datën e zbatimit fillestar me shumën e çdo provizioni për qiratë detyruese, të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar menjëherë para datës së zbatimit për herë të parë.
 - (c) qiramarrësi mund të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat në paragrafin C8 për qiratë për të cilat afati i qirasë përfundon brenda 12 muajve nga data e zbatimit fillestar. Në këtë rast, qiramarrësi do të:
 - (i) trajtojë këto qira në të njëjtën mënyrë si qiratë afatshkurtra të përshkruara në paragrafin 6; dhe
 - (ii) përfshijë kostot e lidhura me këto qira në dhënien e informacioneve shpjeguese për shpenzimin e qirave afatshkurtra në periudhën vjetore të raportimit që përfshin datën e zbatimit për herë të parë.
 - (d) qiramarrësi mund të përjashtojë kostot fillestare të drejtpërdrejta nga matja e aktivit me të drejtë përdorimi në datën e zbatimit për herë të parë.
 - (e) qiramarrësi mund të përdorë supozime, si për shembull për të përcaktuar afatin e qirasë, nëse kontrata përmban opsione për të zgjatur ose për të përfunduar qiranë.

Qiratë e klasifikuara më parë si qira financiare

- C11 Nëse një qiramarrës zgjedh të zbatojë këtë Standard në përputhje me paragrafin C5(b), për qiratë e klasifikuara si qira financiare në zbatim të SNK 17, vlera kontabel (neto) e aktivit me të drejtë përdorimi dhe e detyrimit të qirasë në datën e zbatimit fillestar do të jetë vlera kontabel (neto) e aktivit të qirasë dhe e detyrimit të qirasë menjëherë para datës së matjes duke zbatuar SNK 17. Për këto qira, qiramarrësi duhet të trajtojë aktivin me të drejtë përdorimi dhe detyrimin e qirasë duke zbatuar Standardin që nga data e zbatimit fillestar.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- C12 Nëse qiramarrësi zgjedh të zbatojë këtë Standard në përputhje me paragrafin C5(b), qiramarrësi duhet të japë informacionet shpjeguese rreth zbatimit fillestar të kërkuara nga paragrafi 28 i SNK 8 me përjashtim të informacionit të specifikuar në paragrafin 28(f) të SNK 8. Në vend të informacionit të specifikuar në paragrafin 28(f) të SNK 8, qiramarrësi duhet të japë informacion shpjegues:
- (a) për mesataren e ponderuar të normës rritëse të huamarrjes të qiramarrësit të zbatuar ndaj detyrimeve të qirasë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e zbatimit fillestar; dhe
 - (b) për diferencën mes:
 - (i) angazhimeve të qirasë së zakonshme të paraqitur në zbatim të SNK 17, në fund të periudhës vjetore të raportimit që paraprin menjëherë datën e zbatimit për herë të parë, të skontuara duke përdorur normën rritëse të huamarrjes në datën e zbatimit fillestar siç përsëritet në paragrafin C8(a); dhe
 - (ii) detyrimeve të qirasë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar në datën e zbatimit për herë të parë.
- C13 Nëse qiramarrësi përdor një ose më shumë prej lehtësive praktike të paragrafit C10, ai do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Qiradhënësit

- C14 Përveç sa përsëritet në paragrafin C15, qiradhënësit nuk i kërkohej të bëjë ndonjë rregullim në periudhën kalimtare për qiratë për të cilat ai është qiradhënës dhe duhet t'i trajtojë këto qira duke zbatuar këtë Standard nga data e zbatimit për herë të parë.
- C15 Një qiradhënës i ndërmjetëm do të:
- (a) rrvlerësojë nënqiratë e klasifikuara si qira të zakonshme në zbatim të SNK 17 dhe janë në vijim në datën e zbatimit për herë të parë, për të përcaktuar nëse çdo nënqira duhet të klasifikohet si një qira e zakonshme apo financiare duke zbatuar këtë Standard. Qiradhënësi i ndërmjetëm duhet të kryejë këtë vlerësim në datën e zbatimit fillestar bazuar në termat dhe kushtet kontraktuale të mbetura të qirasë kryesore dhe nënqirasë në atë datë.
 - (b) që për nënqiratë e klasifikuara si qira të zakonshme në zbatim të SNK 17 por si qira financiare duke zbatuar këtë Standard, të trajtojë nënqiratë si qira të re financiare të lidhur në datën e zbatimit për herë të parë.

Transaksione të shitjes dhe marrjes me qira para datës së zbatimit për herë të parë

- C16 Një njësi ekonomike nuk do të rrvlerësojë transaksionet e shitjes dhe marrjes me qira të lidhura para datës së zbatimit për herë të parë për të përcaktuar nëse transferimi i aktivit bazë plotëson kërkesat në SNRF 15 për t'u trajtuar si një shitje.
- C17 Nëse një transaksion i shitjes dhe marrjes me qira ishte trajtuar si një shitje dhe qira financiare në zbatim të SNK 17, shitësi-qiramarrës do të:
- (a) trajtojë shitjen dhe marrjen me qira në të njëjtën mënyrë, siç trajton çdo qira tjetër financiare që ekziston në datën e zbatimit për herë të parë; dhe
 - (b) të vijojë të amortizojë çdo fitim nga shitja përgjatë afatit të qirasë.
- C18 Nëse një transaksion i shitjes dhe marrjes me qira ishte trajtuar si një shitje dhe qira e zakonshme në zbatim të SNK 17, shitësi-qiramarrës do të:

- (a) trajtojë shitjen dhe marrjen me qira në të njëjtën mënyrë siç trajton çdo qira tjetër të zakonshme që ekziston në datën e zbatimit për herë të parë; dhe
- (b) rregullojë aktivin me të drejtë përdorimi të shitjes dhe marrjes me qira për çdo fitim ose humbje të shtyrë që lidhet me termat jo-treg të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar menjëherë para datës së zbatimit për herë të parë.

Shumat e njohura më parë të lidhura me kombinime biznesi

- C19 Nëse një qiramarrës ka njohur më parë një aktiv ose një detyrim në zbatim të SNRF 3 *Kombinime biznesi* lidhur me kushtet e favorshme ose jo të një qiraje të zakonshme të siguruar si pjesë e një kombinimi biznesi, qiramarrësi do të regjistrojë atë aktiv ose detyrim dhe të rregullojë vlerën kontabël neto të aktivit me të drejtë përdorimi me një shumë që i korrespondon datës së zbatimit për herë të parë.

Referencat në SNRF 9

- C20 Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard, por ende nuk zbaton SNRF 9 *Instrumente Financiare*, çdo referencë në këtë Standard ndaj SNRF 9 do të lexohet si një referencë në SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*.

Hegja e standardeve të tjera

- C21 Ky Standard zëvendëson Standardet dhe Interpretimet e mëposhtme:
- (a) SNK 17 *Qiratë*;
 - (b) KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një marrëveshje Qiraje*;
 - (c) KIS *Qiratë e Zakonshme - Stimujt*, dhe
 - (d) KIS-27 *Vlerësimi i Përmbytjes së Transaksioneve që Përfshijnë Formën Ligjore të një Qiraje*.

Shtojca D

Ndryshime në Standardet e tjera

Kjo shtojcë paraqet ndryshimet në Standardet e tjera, pasojë e publikimit të këtij Standardi nga BSNE. Një njësi ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 Janar 2019 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Një njësi ekonomike nuk lejohet të zbatojë SNRF 16 para zbatimit të SNRF 15. Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët (shih paragrafin C1).

Për pasojë, për Standardet e hyra në fuqi më 1 Janar 2016, ndryshimet në këtë shtojcë paraqiten bazuar në tekstin e këtyre Standardeve në fuqi më 1 Janar 2016, i ndryshuar nga SNRF 15. Teksti i këtyre Standardeve në këtë shtojcë nuk përfshin ndryshimet të cilat nuk ishin në fuqi më 1 Janar 2016.

Për Standardet që nuk kishin hyrë në fuqi më 1 Janar 2016, ndryshimet në këtë shtojcë paraqiten bazuar në tekstin e publikimit fillestar të këtyre Standardeve, i ndryshuar nga SNRF 15. Teksti i këtyre Standardeve në këtë shtojcë nuk përfshin ndryshimet të cilat nuk ishin në fuqi më 1 Janar 2016.

Në paragrafët e ndryshuar, teksti i fshirë është vijëzuar në mes dhe teksti i ri është nënvizuar.

SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Paragrafi 30 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 39AB.

Përdorimi i vlerës së drejtë si kosto e supozuar

30 Nëse një njësi ekonomike përdor, në pasqyrën e pozicionit financiar të çeljes sipas SNRF-ve, vlerën e drejtë si kosto të supozuar për një zë të aktiveve afatgjata materiale - toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, të aktiveve afatgjata materiale të investuara ~~ose~~ të aktiveve jo materiale ose të një aktivi me të drejtë përdorimi (shih paragrafët D5 dhe D7) pasqyrat financiare të njësisë ekonomike, të parat sipas SNRF-ve, do të japin informacione shpjeguese për çdo zë në pasqyrën e pozicionit financiar të çeljes sipas SNRF-ve:

(a) ...

Data e hyrjes në fuqi

...

39AB SNRF 16 *Qiratë*, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafët 30, C4, D1, D7, D8B dhe D9, fshiu paragrafin D9A dhe shtoi paragrafët D9B–D9E. Njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

Është ndryshuar paragrafi C4.

Përfshirje për kombinimet e biznesit

...

C4 Nëse një adoptues për herë të parë nuk zbaton SNRF 3 në mënyrë retrospektive në një kombinim biznesi të mëposhtëm, kjo ka pasojat e mëposhtme për këtë kombinim biznesi:

(a) ...

- (f) Nëse një aktiv i blerë, ose detyrim i supozuar, në një kombinim biznesi të mëparshëm nuk ishte njohur në përputhje me PPPK- të e mëparshme, ai nuk ka një kosto të supozuar zero në çeljen e pasqyrës së pozicionit financiar sipas SNRF-ve. Në vend të kësaj, blerësi do të njohë dhe masë atë në pasqyrën e tij të konsoliduar të pozicionit financiar në bazë të asaj që SNRF-të do të kërkonin në pasqyrën e pozicionit financiar të të blerit. Për ta ilustruar: nëse blerësi nuk kishte kapitalizuar, në përputhje me PPPK- të e mëparshme të tij, qira ~~financiare~~ të blera në një kombinim biznesi në të shkuarën në të cilin blerësi ishte një qiramarrës, ai do t'i kapitalizojë këto qira në pasqyrat e tij financiare të konsoliduara, sipas kërkesave të ~~SNK 17~~ SNRF 16 *Qiratë* për t'u plotësuar nga i bleri në pasqyrën e tij të pozicionit financiar sipas SNRF-ve. Në mënyrë të ngjashme, nëse blerësi nuk kishte njohur, në përputhje me PPPK-të e mëparshme të tij, një detyrim të kushtëzuar që ende ekziston në datën e kalimit në SNRF, blerësi do të njohë atë detyrim të kushtëzuar në atë datë me përjashtim të rastit kur SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara* ndalon njohjen e tij në pasqyrat financiare të të blerit. Në anën tjetër, nëse një aktiv ose detyrim është përfshirë në emrin e mirë, në përputhje me PPPK-të e mëparshme, por do të kishte qenë e njohur veçmas sipas SNRF 3, aktivi ose detyrimi mbetet në emrin e mirë me përjashtim të rastit kur SNRF-të do të kërkojnë njohjen e tij në pasqyrat financiare të të blerit.
- (g) ...

Në shtojcën D, janë ndryshuar paragrafët D1, D7, D8B dhe D9. Është fshirë paragrafi D9A. Janë shtuar paragrafët D9B-D9E.

Përjashtime nga SNRF- të e tjera

- ...
- D1 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose më shumë prej përjashtimeve të mëposhtme:
- (a) ...
- (d) qiratë (paragrafët D9 dhe ~~D9A-D9B-D9E~~).
- ...

Kosto e supozuar

- ...
- D7 Zgjedhjet në paragrafët D5 dhe D6 janë gjithashtu të vlefshme për:
- (a) aktivin afatgjatë material të investuar, nëse një njësi ekonomike zgjedh të përdorë modelin e koston në SNK 40 *Aktivët Afatgjatë Materiale të Investuara*; ~~dhe~~
- (aa) aktivet me të drejtë përdorimi (SNRF 16 *Qiratë*); dhe
- (b) ...
- ...
- D8B Disa njësi ekonomike zotërojnë zëra të tokës, ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve, aktive me të drejtë përdorimi ose aktive jo materiale të cilat janë përdorur, ose përdoren më parë, në operacione të lidhura me rregullimin e tarifës. Vlera kontabël (neto) e këtyre zërave mund të përfshijë shumën e cilat u përcaktuan sipas PPPK-ve të mëparshme, por nuk kualifikohen për kapitalizim në përputhje me SNRF-të. Nëse kemi të bëjmë me një rast të tillë, një zbatues për herë të parë mund të zgjedhë të përdorë vlerën kontabël të PPPK-ve të mëparshme të këtij zëri në datën e kalimit në SNRF-të si kosto të supozuar. Nëse njësi ekonomike e zbaton këtë përjashtim për një zë, ajo nuk ka pse ta zbatojë këtë për të gjitha zërat. Në datën e kalimit në SNRF-të, njësi ekonomike teston për zhvlerësim në përputhje me SNK 36 çdo zë për të cilin përdoret ky përjashtim. Për qëllime të këtij paragrafi, aktivitetet janë subjekt i rregullimit të normës (tarifës) nëse rregullohen nga një kuadër për përcaktimin e çmimeve që mund t'u kërkojnë klientëve për të mallrat apo shërbimet dhe nëse ky kuadër është subjekt i mbikëqyrjes dhe/ose miratimit nga një rregullator i normës (tarifës) (siç përcaktohet në SNRF 14 *Gjendje llogarie për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore*).

Qiratë

- D9 Një zbatues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat kalimtare të dhëna në KIRFN 4 Përcaktimi nëse një marrëveshje është marrëveshje Qiraje. Prandaj një zbatues për herë të parë mund të përcaktojë nëse një marrëveshje ekzistuese në datën e kalimit në SNRF përmban një qira në bazë të faktëve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë. Një zbatues për herë të parë mund të vlerësojë nëse një kontratë ekzistuese në datën e kalimit në SNRF përmban një qira duke zbatuar paragrafet 9-11 të SNRF 16 për ato kontrata në bazë të faktëve dhe rrethanave ekzistuese në atë datë.
- D9A [Fihire] Nëse një zbatues për herë të parë bën të njëjtat përcaktime nëse një marrëveshje përmban një qira në përputhje me PPPK, të e mëposhtme ai uje e kërkuar nga KIRFN 4, por në një datë të ndryshme nga ajo e kërkuar nga KIRFN 4, zbatuesi për herë të parë nuk ka nevojë rivekurë këtë përcaktim kur ai zbaton SNRF të. Që një pjesë ekonomike të ketë llogarë të njëjtin përcaktim nëse marrëveshja përmban një qira në përputhje me PPPK, të e mëposhtme, ky përcaktim duhet të ketë dhënë të njëjtin rezultat si ai i cili rezultoi nga zbatimi i SNK 17 Qiratë dhe KIRFN 4.
- D9B Nëse qiramarrësi, zbatues për herë të parë, njeh detyrimet e qirasë dhe aktivin me të drejtë përdorimi ai mund të zbatojë qasjen në vijim për të gjitha qiratë e tij (subjekt i lehtësiye praktike të përshkruara në paragrafin D9D):
- (a) të masë një detyrim të qirasë në datën e kalimit në SNRF-të. Qiramarrësi që ndjek këtë qasje, do të masë këtë detyrim të qirasë me vlerën e drejtë të pagesave të mbetura të qirasë (shih paragrafin D9E), të skontuara duke përdorur normën ritëse të huamarrjes së qiramarrësit (shih paragrafin D9E) në datën e kalimit në SNRF-të.
 - (b) të masë një aktiv me të drejtë përdorimi në datën e kalimit në SNRF-të. Qiramarrësi duhet të zgjedhë mbi baza individuale, të masë aktivin e drejtë për përdorim ose:
 - (i) me vlerën kontabel (neto) të tij sikur SNRF 16 të ishte zbatuar që nga data e fillimit të qirasë (shih paragrafin D9E), por të skontuar duke përdorur normën ritëse të huamarrjes të qiramarrësit në datën e kalimit në SNRF-të; ose
 - (ii) me një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë, të rregulluar për shumën e ndonjë pagese qiraje të parapaguar ose të maturuar lidhur me atë qira të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar para datës së kalimit në SNRF-të.
 - (c) të zbatojë SNK 36 për aktivet me të drejtë përdorimi në datën e kalimit në SNRF-të.
- D9C Pavarësisht kërkesave në paragrafin D9B, një zbatues për herë të parë që është qiramarrës do ta masë aktivin me të drejtë përdorimi me vlerën e drejtë në datën e kalimit në SNRF-të për qiratë që plotësojnë përkufizimin e aktivit afatgjatë material të investuar sipas SNK 40 dhe maten duke përdorur modelin e vlerës së drejtë të SNK 40 nga data e kalimit në SNRF-të.
- D9D Një zbatues për herë të parë që është qiramarrës mund të kryejë një apo disa nga veprimet në vijim, në datën e kalimit në SNRF-të, të zbatuar mbi baza individuale (qira për qira):
- (a) të zbatojë një normë skontimi të vetme për një portofol qirash me karakteristika të ngjashme në mënyrë të arsyeshme (të tilla si qiratë me afate të mbetura qiraje të ngjashme për një klasë të ngjashme të aktivit bazë në një mjedis ekonomik të ngjashëm).
 - (b) të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat në paragrafin D9B për qiratë për të cilat afati i qirasë (shih paragrafin D9E) përfundon brenda 12 muajve nga data e kalimit në SNRF-të. Por njësi ekonomike do t'i trajtojë (duke përfshirë dhënie informacionesh shpjeguese për të) këto qira sikur ato të ishin qira afatshkurtra të trajtuara në përputhje me paragrafin 6 të SNRF 16.
 - (c) të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat në paragrafët D9B për qiratë, aktivin bazë i të cilave ka vlerë të ulët (siç përshkruhet në paragrafët B3-B8 të SNRF 16). Por njësi ekonomike duhet të trajtojë këto qira (duke përfshirë dhënie informacionesh shpjeguese për të) në përputhje me paragrafin 6 të SNRF 16.
 - (d) të përjashtojë kostot fillestare të drejtëpërdrejta (shih paragrafin D9E) nga matja e aktivit me të drejtë përdorimi në datën e kalimit në SNRF-të.
 - (e) të përdorë supozime, si psh për të përcaktuar e afatit të qirasë, nëse kontrata përmban opsione për të zgjedhur ose për të përfunduar qirarë.
- D9E Pagesat e qirasë, qiramarrësi, norma ritëse e huamarrjes e qiramarrësit, data e fillimit e qirasë, kostot fillestare të drejtëpërdrejta dhe afati i qirasë janë terma të përkufizuar në SNRF 16 dhe përdoren në këtë Standard me të njëjtat kuptime.

SNRF 3 Kombinime Biznesi

Paragrafët 14 dhe 17 janë ndryshuar dhe janë shtuar paragrafët 28A dhe 28B, titujt përkatës të tyre dhe paragrafi 64M.

Kushtet e njohjes

- ...
- 14 Paragrafët ~~B28–B40~~B31–B40 japin udhëzime për njohjen e ~~qirave operative dhe~~ aktiveve jo-materiale. Paragrafët 22–28~~B~~ specifikojnë llojet e aktiveve të identifikueshme dhe detyrimeve që përfshijnë zëra për të cilat ky SNRF ofron përjashtime të kufizuara për parimin dhe kushtet e njohjes.

Klasifikimi ose përcaktimi i aktiveve të identifikueshme të blera dhe detyrimeve të marra përsipër në një kombinim biznesi

- ...
- 17 Ky SNRF ofron dy përjashtime për parimin në paragrafin 15:
- (a) klasifikimi i një kontrate qiraje në të cilën blerësi është qiradhënësi i një qiraje të zakonshme ose financiare në përputhje me ~~SNRF 17~~ SNRF 16 Qiratë, dhe
 - (b) ...

Qiratë në të cilat i bleri është qiramarrësi

- 28A Blerësi duhet të njohë aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë për qiratë e identifikuar në përputhje me SNRF 16 në të cilat i bleri është qiramarrësi. Nuk kërkohet që blerësi të njohë aktivet me të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë për:
- (a) qiratë për të cilat afati i qirasë (siç përkufizohet në SNRF 16) përfundon brenda 12 muajve nga data e blerjes, ose
 - (b) qiratë për të cilat aktivi bazë ka vlerë të ulët (siç përkufizohet në paragrafët B3–B8 të SNRF 16).
- 28B Blerësi do të masë detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë (siç përkufizohet në SNRF 16) sikur qiraja e blerë të ishte një qira e re në datën e blerjes. Blerësi do të masë aktivin me të drejtë përdorimi me të njëjtën shumë si detyrimin e qirasë, të rregulluar për të reflektuar kushtet e favorshme ose jo të favorshme të qirasë kur krahasohet me kushtet e tregut.

Data e hyrjes në fuqi

- ...
- 64M SNRF 16 i publikuar në Janar 2016 ndryshoi paragrafët 14, 17, B32 dhe B42, fshiu paragrafët B28–B30 dhe titujt përkatës dhe shtoi paragrafët 28A–28B dhe titujt e tyre. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

Në Shtojcën B, janë fshirë paragrafët B28–B30 dhe titujt përkatës dhe janë ndryshuar paragrafët B32 dhe B42.

Qira e zakonshme

- B28 [Fshirë] Blerësi nuk duhet të njohë ndonjë aktiv ose detyrim që lidhet me një qira të zakonshme në të cilën shoqëria e blerë është qiramarrësi, përveç siç kërkohet nga paragrafët B29 dhe B30.

- B29 [Fshirë] Blerësi do të përcaktojë nëse termat e qelë-qiraje të zakonshme në të cilën shoqëria e blerë është qiramarrësi janë të favorshme apo të pafavorshme. Blerësi do të njohë një aktiv afatgjatë jo-material nëse kushtet e një qiraje të zakonshme janë të favorshme në lidhje me kushtet e tregut dhe një detyrim, nëse kushtet janë relativisht të pafavorshme në lidhje me kushtet e tregut. Paragrafi B42 jep udhëzime për matjen e vlerës së drejtë në datën e blerjes së aktivit që i nënshtrohet qirave të zakonshme në të cilat shoqëria e blerë është qiradhenësi.
- B30 [Fshirë] Një aktiv afatgjatë jo-material i identifikueshëm mund të shoqërohet me një qira të zakonshme, e cila mund të evidentohet nga gatishmëria e pjesëmarrësve në treg për të paguar një qim për qirarë edhe nëse ajo është në kushte të tregut. Për shembull, një qira e hyrjeve në një aeroport ose një qira për një dyqan me pakice në një zonë tregtare, e cila mund të sjellë hyrje në treg apo përfitime të tjera ekonomike në të ardhmen që kualifikohen si aktive afatgjatë jo-materiale të identifikueshme, për shembull, si një marrëdhënie me konsumatorët. Në këtë situatë, blerësi do të njohë një aktiv afatgjatë jo-material të identifikueshëm lidhur me paragrafin B31.

Aktivet Jo-materiale

- ...
- B32 Një aktiv afatgjatë jo-material që plotëson kriterin kontraktual-ligjor është i identifikueshëm, edhe nëse aktivi nuk është i transferueshëm apo i ndashëm nga shoqëria e blerë ose nga të drejta apo detyrime të tjera. Për shembull:
- (a) [Fshirë] një një-shoqëri e blerë jep me qira një strukturë prodhuese nën një qira të zakonshme që ka kushte që janë relativisht të favorshme kundrejt kushteve të tregut. Termat e qirarë në mënyrë të qartë ndalojnë transferimin e qirarë (nëpërmjet shitjes ose nën-qira). Shuma me të cilën kushtet e qirarë janë të favorshme në krahasim me kushtet e transaksioneve aktuale të tregut për artilerijë të njëjtë apo të ngjashëm, është një aktiv afatgjatë jo-material që plotëson kriterin kontraktual-ligjor për njohjen veçmas nga entri i mirë, edhe pse blerësi nuk mund të shesë ose transferojë kontraktin e qirarë.
- (b) ...

Aktivet që janë subjekt i qirave të zakonshme në të cilat shoqëria e blerë është qiradhenësi

- B42 Në matjen e vlerës së drejtë në datën e blerjes së një aktivi të tillë si ndërtesë ose patentë, që është subjekt i një qiraje të zakonshme, në të cilën shoqëria e blerë është qiradhenësi, blerësi do të marrë parasysh kushtet e qirarë. ~~Me fjalë të tjera,~~ Blerësi nuk e njihë këtë aktiv apo detyrim veçmas nëse kushtet e një qiraje të zakonshme janë të favorshme ose të pafavorshme, kur krahasohen me kushtet e tregut ~~sipër kushtet paragrafi B29 i për-qirarë në të cilën shoqëria e blerë është qiramarrësi.~~

SNRF 4 Kontratat e Sigurimit

Me ndryshimin e SNRF 15, është ndryshuar paragrafi 4 dhe është shtuar paragrafi 41).

Objekti

- ...
- 4 Njësia ekonomike nuk do të zbatojë këtë SNRF për:
- (a) ...
- (c) të drejtat kontraktuale ose detyrimet kontraktuale të cilat janë të kushtëzuara me përdorimin e ardhshëm ose të drejtën e përdorimit të një zëri jo-financiar (për shembull disa komisione licencash, të drejtash shfrytëzimi, pagesa ~~të kushtëzuara~~ arabesë të qirarë dhe zëra të ngjashëm) si dhe garancitë për vlerën e mbetur të një qiramarrësi të përfshirë në një qira ~~financiare~~ (shih ~~SNRF 47~~ SNRF 16 Qirarë, SNRF 15 *Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët* dhe SNK 38 *Aktivet jo-materiale*).
- (d) ...

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- ...
- 411 SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 4. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Paragrafi 29 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 44CC.

Vlera e drejtë

- ...
- 29 Nuk kërkohet dhënia e informacioneve shpjeguese për vlerën e drejtë:
- (a) ...
 - (b) për një investim në instrumenta të kapitalit neto për të cilin nuk ka një çmimi të kuotuar në një treg aktiv për instrumenta identikë (d.m.th input i Nivelit 1) ose derivative të lidhur me këta instrumenta të kapitalit neto, të matur me kosto në përputhje me SNK 39, sepse vlera e drejtë e tyre nuk mund të matet ndryshe në mënyrë të besueshme; ~~ese~~
 - (c) për një kontratë që përmban një tipar të pjesëmarrjes së lirë për të vepruar (siç përshkruhet në SNRF 4) nëse vlera e drejtë e këtij tipari nuk mund të matet në mënyrë të besueshme; ose
 - (d) për detyrime të qirasë.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- ...
- 44CC SNRF 16 Qiratë, i publikuar në Janar të vitit 2016, ka ndryshuar paragrafët 29 dhe B11D. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

Në shtojcën B, është shtuar paragrafi B11D.

Dhënie informacionesh sasiore mbi rrezikun e likuiditetit (paragrafi 34(a) dhe 39 (b))

- ...
- B11D Shumat e kontraktuara të paraqitura në analizat e maturimit sipas kërkesave të paragrafit 39(a) dhe (b) janë flukse monetare kontraktuale jo të skontuara, për shembull:
- (a) ~~detyrimet financiare~~ detyrimet bruto të qirasë (para zbritjes së komisioneve financiare);
 - (b) ...

Paragrafët 42.1 dhe 5.5.15 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 7.1.5.

Kapitulli 2 Objekti

2.1 Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentët financiarë, përveç:

- (a) ...
- (b) të drejtave dhe detyrimeve për qiratë për të cilat zbatohet ~~SNK-47~~**SNRF 16 Qiratë**. Megjithatë:
 - (i) të arkëtueshme nga qiraja financiare (duhë investimet neto në qira financiare) dhe të arkëtueshme nga qiraja e zakonshme të njohura nga një qiradhënësi janë subjekt i kërkesave për mosnjohje (çregjistrim) dhe rënie në vlerë të këtij Standardi;
 - (ii) të pagueshme detyrime të qirasë financiare të njohura nga një qiramarrës janë subjekt i kërkesave për mosnjohje (çregjistrim) në paragrafin 3.3.1 të këtij Standardi; dhe
 - (iii) derivativët që janë të përfshirë në qiratë janë subjekt i kërkesave të këtij Standardi për derivativët e përfshirë.
- (c) ...

Përqasja e thjeshtuar për llogaritë e arkëtueshme tregtare, aktivet e kontratës dhe llogaritë e arkëtueshme nga qiratë

5.5.15 Pavarësisht nga paragrafët 5.5.3 dhe 5.5.5, një njësi ekonomike gjithmonë duhet të masë provizionin për humbjen si një shumë të barabartë me humbjen e parashikuar të kredisë përgjatë jetës për:

- (a) ...
- (b) qira të arkëtueshme që rezultojnë nga transaksione që janë brenda objektivit të ~~SNK 47~~**SNRF 16**, nëse njësi ekonomike zgjedh si politikë kontabël matjen e humbjeve në një shumë të barabartë me humbjet e parashikuara të kredisë përgjatë jetës. Kjo politikë kontabël do të zbatohet për të gjithë qiratë e arkëtueshme, por mund të zbatohet veç për qiratë financiare dhe veç për qiratë e zakonshme.

...

7.1 Data e hyrjes në fuqi

...

7.1.5 SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafët 2.1, 5.5.15, B3.8, B5.5.34 dhe B5.5.46. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

Në shtojcën B, janë ndryshuar paragrafët B4.3.8, B5.5.34 dhe B5.5.46.

Derivativët e përfshirë (Seksioni 4.3)

...

B4.3.8 Në shembujt e mëposhtëm, karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e një derivativi të përfshirë janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e kontratës bazë. Në këta shembuj, njësia ekonomike nuk i trajton derivativët e përfshirë veçmas nga kontrata bazë.

(a) ...

(f) Derivativi i përfshirë në një kontratë bazë qiraje është i lidhur ngushtë me kontratën bazë nëse derivativi i përfshirë është (i) një indeks i lidhur me inflacionin i tillë si një indeks i pagesave të qirasë për një indeks të çmimeve të konsumit (me kusht që qiraja nuk është e ndikuar dhe indeksi lidhet me inflacionin në mjedisin e vet ekonomik të njësisë ekonomike), (ii) ~~qiraja e kushtëzuar me pagesa variabël e qirasë~~ në bazë të shijëve përkatëse ose (iii) ~~qiraja e kushtëzuar me pagesa variabël e qirasë~~ në bazë të normave variabël të interesit.

(g) ...

Humbjet e pritshme të kredisë

...

B5.5.34 Kur bëhet matja e një zbritjeje për humbje për një qira të arkëtueshme, flukset e mjeteve monetare të përdorura për përcaktimin e humbjeve të pritshme të kredisë duhet të jenë në përputhje me flukset e mjeteve monetare të përdorura në matjen e qirasë së arkëtueshme sipas ~~SNK-17~~SNRF 16 *Qiratë*.

...

Vlera në kohë e parasë

...

B5.5.46 Humbjet e pritshme të kredisë mbi qiratë e arkëtueshme do të skontojnë duke përdorur të njëjtën normë skontimi të përdorur në matjen e qirasë të arkëtueshme në përputhje me ~~SNK-17~~SNRF 16.

...

IFRS 13 *Matja me Vlerën e Drejtë*

Është ndryshuar paragrafi 6.

Objekti

...

6 Kërkesat për matjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të këtij SNRF-je nuk zbatohen për rastet në vijim:

(a) ...

(b) transaksionet e qirasë ~~brezës objektit të SNK-17~~ të trajtuara në përputhje me SNRF 16 *Qiratë*; dhe

(c) ...

Në shtojcën C është shtuar paragrafi C6.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

...

C6 SNRF 16 *Qiratë*, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 6. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët

Janë ndryshuar paragrafët 5 dhe 97.

Objekti

- 5 Njësia ekonomike do të zbatojë këtë Standard për të gjitha kontratat me klientët, me përjashtim të sa vijon:
- (a) kontratat e qirasë që janë brenda objektit të ~~SNRF 17~~ SNRF Qiratë,
 - (b) ...

Kostot për të realizuar një kontratë

- 97 Kostot që lidhen drejtpërdrejt me një kontratë (ose me një kontratë specifike të parashikuar) përfshijnë çdo njëri nga sa vijon:
- (a) ...
 - (c) shpërndarja e kostove që lidhen drejtpërdrejt me kontratën ose aktivitetet e kontratës (për shembull, kostot e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së kontratës, sigurimit dhe amortizimi i mjeteve, ~~dhe~~ pajisjeve dhe të drejtave të përdorimit të aktiveve të përdorura në plotësimin e kontratës);
 - (d) ...

Në shtojcën B, janë ndryshuar paragrafët B66 dhe B70.

Një kontratë e ardhshme (forward) ose një opsin për blerje

- B66 Nëse njësia ekonomike ka një detyrim ose një të drejtë për të riblerë aktivin (një kontratë e ardhshme (forward) ose një opsin për blerje), klienti nuk merr kontrollin e aktivit, sepse klienti është i kufizuar në aftësinë e tij për të menaxhuar drejtpërdrejt dhe për të marrë pothuajse të gjitha përfitimet e mbetura nga aktivi edhe pse klienti mund të ketë zotërimin fizik të aktivit. Për pasojë, njësia ekonomike do të trajtojë kontratën si njëri nga format në vijim:
- (a) qira në përputhje me ~~SNRF 17~~ SNRF 16 Qiratë nëse njësia ekonomike mund ose duhet të riblerë aktivin për një shumë që është më e vogël se çmimi fillestar i shitjes së aktivit, me përjashtim të rastit kur kontrata është pjesë e një transaksioni shitje dhe marrje me qira. Nëse kontrata është pjesë e një transaksioni shitje dhe marrje me qira, njësia ekonomike do të vazhdojë të njohë aktivin dhe do të njohë një detyrim financiar për çdo shumë të marrë nga klienti. Njësia ekonomike do të trajtojë detyrimin financiar në përputhje me SNRF 9; ose
 - (b) ...

Një opsin për shitje

- B70 Nëse njësia ekonomike ka një detyrim për të riblerë një aktiv me kërkesën e klientit (një opsin për shitje nga klienti) me një çmim, i cili është më i ulët se çmimi fillestar i shitjes së aktivit, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë në momentin e lidhjes së kontratës nëse klienti ka një stimul të rëndësishëm ekonomik për ta ushtruar atë të drejtë. Ushtrimi i të drejtave nga klienti sjell që klienti në fakt t'i paguajë shumën njësise ekonomike për të drejtën e përdorimit të një aktivi të caktuar për një periudhë kohore. Prandaj, nëse klienti ka një stimul ekonomik të rëndësishëm për ta ushtruar atë të drejtë, njësia ekonomike duhet ta

trajtojë marrëveshjen si kontratë qiraje në përputhje me SNK 47SNRF 16, me përjashtim të rastit kur kontrata është pjesë e një transaksioni shitje dhe marrje me qira. Nëse kontrata është pjesë e një transaksioni shitje dhe marrje me qira, njësi ekonomike do të vazhdojë të njohë aktivin dhe do të njohë një detyrim financiar për çdo shumë të marrë nga klienti. Njësia ekonomike do të trajtojë detyrimin financiar në përputhje me SNRF 9;

...

Në shtojcën C është shtuar paragrafi C1A.

Data e hyrjes në fuqi

...

C1A SNRF 16 *Qiratë*, i publikuar në Janar të vitit 2016, ka ndryshuar paragrafet 5, 97, B66 dhe B70. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare

Paragrafi 123 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 139Q.

Dhënie informacionesh shpjeguese për politikat kontabël

...

123 Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të njësive ekonomike, drejtimi bën gjyqime të ndryshme, përveç atyre që përfshijnë çmuarje, të cilat, mund të ndikojnë në mënyrë të rëndësishme shumat e njohura në pasqyrat financiare. Për shembull, drejtimi bën gjyqime në përcaktimin:

(a) ...

(b) nëse në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme nga pronësia e aktiveve financiare dhe për qiramarrësit, të aktiveve ~~me qirë~~ subjekt i qirasë janë transferuar tek njësitë ekonomike të tjera; dhe

(c) ...

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

...

139Q SNRF 16 *Qiratë*, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 123. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNK 2 Inventarët

Paragrafi 12 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 40G.

Kostot e transformimit

12 Kostot e shndërrimit të inventarëve përfshijnë kostot e lidhura drejtpërdrejt me njësitë e prodhimit, siç është puna e drejtpërdrejtë. Gjithashtu, ato përfshijnë një shpërndarje sistematike të shpenzimeve të përgjithshme

fikse dhe variabël të prodhimit, që kryhen gjatë transformimit të materialeve në produkte të gatshme. Shpenzimet e përgjithshme fikse të prodhimit janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat mbeten relativisht të pandryshueshme pavarësisht vëllimit të prodhimit, si për shembull, amortizimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave të fabrikës, ~~dhe pajisjeve dhe aktiveve me të drejtë përdorimi të përdorura në procesin e prodhimit~~ dhe kostot e drejtimit e të administrimit të fabrikës. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabël janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat ndryshojnë në mënyrë direkte, ose thuhet direkte, me ndryshimin e vëllimit të prodhimit, si për shembull, materialet indirekte dhe puna indirekte.

Data e hyrjes në fuqi

40G SNRF 16 Qiratë, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 12. Një njësi ekonomike do të zbatoj këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

Paragrafët 17 dhe 44 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 59.

Aktivitetet financiare

- 17 Dhënia e informacioneve të veçanta shpjeguese për fluksin monetar që krijohet nga aktivitetet financiare është e rëndësishme pasi ato shërbejnë për parashikimin e kërkesave për fluksin monetar të ardhshëm nga ofruesit e kapitalit për njësinë ekonomike. Shembuj të fluksëve të mjeteve monetare të lindura nga aktivitetet financiare janë:

- (a) ...
- (c) pagesa në mjete monetare nga një qinamarës për uljen e detyrimit të mbetur të lidhur me një qira ~~financiare~~.

Transaksione jo në vlera monetare

- 44 Mjaft aktivitete investuese dhe financiare nuk kanë ndikim të drejtpërdrejt në fluksin aktual monetar megjithëse ato kanë ndikim mbi kapitalin dhe strukturën e aktiveve të një njësie ekonomike. Përjashtimi i transaksioneve jo në vlera monetare nga pasqyra e fluksit monetar është në përputhje me objektivin e pasqyrës së fluksit monetar pasi këto elementë nuk përfshijnë fluksin e mjeteve monetare në periudhën aktuale. Shembuj të transaksioneve jo-monetare janë:

- (a) blerja e aktiveve ose duke marrë përsipër detyrimet përkatëse në mënyrë të drejtpërdrejt ose nëpërmjet një qiraje ~~financiare~~;
- (b) ...

Data e hyrjes në fuqi

59 SNRF 16 Qiratë, i publikuar në Janar të vitit 2016, ka ndryshuar paragrafët 17 dhe 44. Njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat

Paragrafi 20 është ndryshuar për një njësi që nuk e ka zbatuar SNRF 9 *Instrumente financiare*.

Aktivitet e mbajtura me vlerën e drejtë

- 20 SNRF-të lejojnë ose kërkojnë që disa aktive të mbahen me vlerën e drejtë ose të rivlerësohen (shih, për shembull, SNK 16 *Aktivitet Afatgjata Materiale*, SNK 38 *Aktivitet Jo-materiale*, SNK 39 *Instrumentet Financiare - Njohja dhe Matja*, dhe SNK 40 *Aktivitet Afatgjata Materiale të Investuara dhe SNRF 16 Qiratë*). Në disa juridiksione, rivlerësimi ose riparagjitje të tjera të një aktivi me vlerën e drejtë ndikojnë në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme) të periudhës aktuale. Si rezultat, baza tatimore e aktivitet rregullohet dhe nuk krijohen diferenca të përkohshme. Në juridiksione të tjera, rivlerësimi ose riparagjitja e një aktivi nuk ndikon në fitimin e tatueshëm të periudhës së rivlerësimit ose riparagjitjes dhe, si rrjedhim, baza tatimore e aktivitet nuk rregullohet. Megjithatë, rikuperimi në të ardhmen i vlerës kontabël neto do të rezultojë në një fluks të tatueshëm të përfitimeve ekonomike për njësinë ekonomike, i cili do të jetë i zbritshëm për qëllime tatimore nga shuma e këtyre përfitimeve ekonomike. Diferenca midis vlerës kontabël neto të një aktivi të rivlerësuar dhe bazës së tij tatimore është një diferencë e përkohshme dhe krijon një detyrim ose aktiv tatimor të shtyrë. Kjo është e vërtetë edhe në qoftë se:

(a) ...

Paragrafi 20 është ndryshuar për një njësi që nuk e ka zbatuar SNRF 9 *Instrumente financiare*.

Aktivitet e mbajtura me vlerën e drejtë

- 20 SNRF-të lejojnë ose kërkojnë që disa aktive të mbahen me vlerën e drejtë ose të rivlerësohen (shih, për shembull, SNK 16 *Aktivitet afatgjata materiale*, IAS 38 *Aktivitet jo-materiale*, IAS 40 *Aktivitet Afatgjata Materiale të Investuara*, dhe SNRF 9 *Instrumente financiare dhe SNRF 16 Qiratë*). Në disa juridiksione, rivlerësimi ose riparagjitje të tjera të një aktivi me vlerën e drejtë ndikojnë në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme) të periudhës aktuale. Si rezultat, baza tatimore e aktivitet rregullohet dhe nuk krijohen diferenca të përkohshme. Në juridiksione të tjera, rivlerësimi ose riparagjitja e një aktivi nuk ndikon në fitimin e tatueshëm të periudhës së rivlerësimit ose riparagjitjes dhe, si rrjedhim, baza tatimore e aktivitet nuk rregullohet. Megjithatë, rikuperimi në të ardhmen i vlerës kontabël neto do të rezultojë në një fluks të tatueshëm të përfitimeve ekonomike për njësinë ekonomike, i cili do të jetë i zbritshëm për qëllime tatimore nga shuma e këtyre përfitimeve ekonomike. Diferenca midis vlerës kontabël neto të një aktivi të rivlerësuar dhe bazës së tij tatimore është një diferencë e përkohshme dhe krijon një detyrim ose aktiv tatimor të shtyrë. Kjo është e vërtetë edhe në qoftë se:

(a) ...

Është shtuar paragrafi 98G.

Data e hyrjes në fuqi

...

- 98G SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 20. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNK 16 Aktivitet Afatgjata Materiale (Toka, ndërtesa, makineri e pajisje)

Objekti

- ...
- 4 ~~[Fshirë] Standardi të tjera mund të kërkojnë njohjen e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të bazuara në një qasje të ndryshme nga ajo e këtij Standardi. Për shembull SNK 17 Qiratë kërkon që një njësi ekonomike të vlerësojë njohjen e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të dhënë me qira në bazë të transferimit të risqeve dhe përfitimeve. Megjithatë në rastet të tilla aspekte të tjera të trajtimit kontabël të këtyre aktiveve, përfshirë amortizimin, pënkrahien nga ky Standard.~~
- 5 Njësia ekonomike që përdor modelin e kostos për aktivin afatgjatë material të investuar në përputhje me SNK 40 Aktivët Afatgjata Materiale të Investuara duhet të përdorë modelin e kostos në këtë Standard për aktivin afatgjatë material të investuar të zotëruar.

Njohja

- ...
- 10 Njësia ekonomike vlerëson sipas parimit të përgjithshëm të njohjes të gjitha kostot e aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) në momentin që ato ndeshen (krijohen). Këto kosto përfshijnë kostot e pësuara (kryera) fillimisht për të blerë ose ndërtuar një zë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) dhe kostot e krijuara më pas për të shtuar, zëvendësuar ose shërbyer një zë. Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) mund të përfshijë kostot e pësuara gjatë dhënies me qira të aktiveve që janë përdorur për të ndërtuar, për të shtuar, për të zëvendësuar pjesë të ose për t'i shërbyer një zëri të aktiveve afatgjata materiale, si për shembull amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi.

Matja e kostos

- ...
- 27 ~~[Fshirë] Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) të blerë nga një qiratarë sipas një qiraje financiare përcaktohet në përputhje me SNK 17.~~
- ...

Amortizimi

- ...
- 44 Njësia ekonomike shpërndan shumat e njohura më parë në lidhje me një zë të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) në pjesët e rëndësishme të tij dhe amortizon veçmas çdo pjesë të tillë. Për shembull mund të jetë e përshtatshme të amortizohen veçmas struktura e avionit dhe motorët e tij; ~~pavarësisht nëse zotërohet apo është siguruar nëpërmjet qiraje financiare.~~ Në mënyrë të ngjashme, nëse një njësi ekonomike blen aktive afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), që janë subjekt i një qiraje të zakonshme në të cilën njësia ekonomike është qiradhenësi, mund të jetë e përshtatshme të amortizojë në mënyrë të veçantë shumat e reflektuara në kostot e atij aktivi që i atribuohen kushteve të favorshme apo të disfavorshme të qirave në raport me kushtet e tregut.
- ...

Çregjistrimi

- ...
- 68 Fitimi ose humbja, që vjen nga mosnjohja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), do të përfshihet në fitim ose humbje nëse zëri nuk njihet (përveç se kur SNK

4-SNRF 16 Qiratë kërkon të veprojë ndryshe lidhur me shitjen dhe shitje - marrje me qira. Fitimet nuk duhet të klasifikohen si të ardhura.

...

- 69 Nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material mund të ndodhë në disa mënyra (psh duke e shitur, duke marrë një qira financiare, ose duke e dhuruar). Data e nxjerrjes jashtë përdorimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale është data kur marrësi merr kontrollin e atij zëri në përputhje me kërkesat në SNRF 15 për përcaktimin se kur përbushet një detyrim i performancës. ~~SNK-17~~SNRF 16 zbatohet për nxjerrjet jashtë përdorimit nga një shitje dhe shitje - marrje me qira.

...

Data e hyrjes në fuqi

...

811. SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, fshiu paragrafët 4 dhe 27 dhe ndryshoi paragrafët 5, 10, 44 dhe 68-69. Njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit në Monedhat e Huaja

Paragrafi 16 është ndryshuar dhe paragrafi 60K është shtuar.

Zërat monetarë

- 16 Karakteristika themelore e zërit monetar është e drejta për të arkëtuar (ose detyrimi për të paguar) një numër fiks ose të përcaktuar njësisht të monedhës. Shembuj të zërave monetarë janë: pensionet dhe përfitimet e tjera të punonjësve të pagueshme në mjete monetare; provizionet që duhet të shlyhen në mjete monetare; detyrimet të qirasë, dhe dividendët në mjete monetare që njihen si një detyrim. Po kështu, do të konsiderohet si zë monetar një kontratë për të marrë (ose lëvruar) një numër të ndryshueshëm instrumentesh kapitali neto të njësisë ekonomike ose një shumë të ndryshueshme aktivesh, për të cilët vlera e drejtë që duhet marrë (ose lëvruar) është e barabartë me një numër të pandryshueshëm ose të përcaktuar njësisht të monedhës. Në të kundërt, karakteristika themelore e një zëri jomonetar është mungesa e të drejtës për të marrë (ose detyrimi për të lëvruar) një numër fiks ose të përcaktuar njësisht të monedhës. Si shembuj të zërave jomonetarë janë: shumat e parapaguar për mallrat dhe shërbimet (~~p.sh. qiraja e parapaguar~~), enuri i mirë, aktivet afatgjata jo materiale; inventarët; toka, ndërtesa, makineri e pajisje, aktivet me të drejtë përdorimi; dhe provizionet që duhet të shlyhen nëpërmjet lëvrimit të një aktivi jomonetar.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

...

- 60K. SNRF 16 Qiratë, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 16. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNK 23 Kostot e Huamarrjes

Paragrafi 6 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 29C.

Përkufizimet

- ...
- 6 Kostot e huamarrjes mund të përfshijnë:
- (a) ...
 - (d) ~~konsionet-financiare~~ ~~interesi~~ lidhur me ~~detyrimet~~ e qirase ~~qirafinanciare~~ të njohura në përputhje me ~~SNK 17~~ SNRF 16 Qiratë, dhe
 - (e) ...

Data e hyrjes në fuqi

- ...
- 29C SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 6. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNRF 32 Instrumentet financiare: Paraqitja

Paragrafi 97S është shtuar.

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

- ...
- 27S SNRF 16 Qiratë, i publikuar në Janar të vitit 2016, ka ndryshuar paragrafet AG9 dhe AG10. Njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara

Paragrafi 5 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 102.

Objekti

- ...
- 5 Kur një Standard tjetër trajton një lloj provizioni specifik, detyrim të kushtëzuar ose aktiv të kushtëzuar, njësi ekonomike do të zbatojë atë Standard në vend të këtij Standardi. Për shembull, disa lloje provizionesh janë trajtuar në Standardet:
- (a) ...
 - (c) qiratë (shih ~~SNK 17~~ SNRF 16 Qiratë). Megjithatë, ~~meqë SNK 17 nuk përmend llojeve specifike për të trajtuar qiratë financiare që janë bërë detyruese, për këto motive zbatohet ky Standard ky Standard zbatohet për çdo qira që bëhet detyruese para datës së fillimit të qirës sic përkufizohet në SNRF 16. Ky Standard zbatohet edhe për qiratë afatshkurtra dhe qiratë për të cilat aktivi bazë ka vlerë të ulët dhe trajtohen në përputhje me paragrafin 6 të SNRF 26 dhe janë bërë detyruese;~~
 - (d) ...

Data e hyrjes në fuqi

- 102 SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 5. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNK 38 Aktivët Jo-Materiale

Janë ndryshuar paragrafët 3, 6 dhe 113. Si pasojë e SNRF 15 është ndryshuar paragrafi 114 dhe është shtuar paragrafi 130L.

Objekti

- 3 Nëse një Standard tjetër pëshkruan kontabilizimin për një lloj të veçantë të aktivitetit afatgjatë jo-material, një njësi ekonomike zbaton atë Standard në vend të këtij Standardi. Për shembull, ky standard nuk zbatohet për:
- (a) ...
 - (c) qiratë ~~brenda objektit të SNK 17~~ aktiveve jo-materiale të trajtuara në përputhje me SNRF 16 Qiratë.
 - (d) ...
- 6 ~~Në rastin e qirave financiare, aktivi i dhënë mund të jetë ose material ose jo-material. Pasi njohet fillësohet, qiramarësi e kontabilizon si një aktiv jo-material të mbajtur në bazë të qirave financiare në përputhje me këtë Standard. Të drejtat e mbajtura nga një qiramarësi sipas marrëveshjeve të licencimit për artikuj të tillë si filma, regjistrime figure, shfaqje, dorëshkrime, patenta dhe të drejta autori janë përjashtuar nga objekti i SNK 17 dhe janë brenda objektit të këtij Standardi dhe janë të përfshijtura nga objekti i SNRF 16.~~

Përfundimi i jetës së dobishme dhe nxjerrja jashtë përdorimit

- 113 Fitimi ose humbja që vjen nga çregjistrimi i një aktivi jo-material përcaktohet si diferencë mes shumës neto nga shitja, nëse ka të tillë, dhe vlerës kontabël (neto) të aktivitetit. Ai do të njihet në fitim ose humbje kur aktivi çregjistrohet (përveç rasteve kur në SNK 47 SNRF 16 kërkohet ndryshe për një shitje dhe shitje dhe marrje me qira). Fitimet nuk duhet të klasifikohen si të ardhura.
- 114 Nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi jo-material mund të ndodhë në disa mënyra (psh duke i shitur, duke lidhur një qira financiare, ose duke i dhuruar). Data e nxjerrjes jashtë përdorimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale është data kur marrësi merr kontrollin e atij zëri në përputhje me kërkesat përcaktuese se kur përmbushet një detyrim i performancës sipas SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët. SNK 47 SNRF 16 zbatohet për nxjerrjet jashtë përdorimit nga një shitje dhe shitje - marrje me qira.

Dispozita kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

- 130L SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafët 3, 6, 113 dhe 114. Njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

SNK 39 Instrumentet Financiare - Njohja dhe Matja

Paragrafi 2 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 103V për një njësi që nuk e ka zbatuar SNRF 9 *Instrumente financiare*. SNK 39 nuk është ndryshuar për një njësi që ka zbatuar SNRF 9.

Objekti

- 2 Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjithë instrumentet financiare, përveç:
- (a) ...
 - (b) të drejtat dhe detyrimet për qiratë për të cilat zbatohet ~~SNK 17~~SNRF 16 *Qiratë*. Megjithatë:
 - (i) të arkëtueshmet qira financiare(dmth investimet neto në qira financiare) dhe të arkëtueshmet qira të zakonshme të njohura nga një qiradhënësi janë subjekt i kërkesave për mosnjohje (çregjistrim) dhe rënie në vlerë të këtij Standardi (shih paragrafët 15–37, 58, 59, 63–65 dhe paragrafët AG36–AG52 dhe AG84–AG93 të Shtojcës A);
 - (ii) detyrimettë-pagueshmet e qirasë financiare të njohura nga një qiramarrës janë subjekt i kërkesave për mosnjohje (çregjistrim) të paragrafit 39 të këtij Standardi (shih paragrafët 39–42 dhe paragrafët AG57–AG63 të Shtojcës A); dhe
 - (iii) ...

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

...

103V SNRF 16, i publikuar në Janar të vitit 2016, ka ndryshuar paragrafët 2 dhe AG33. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

SNK 40 Aktivët Afatgjatë Materiale të Investuara

Për shkak të ndryshimeve të mëdha në SNK 40 *Aktivët Afatgjatë Materiale të Investuara*, teksti i plotë i këtij Standardi së bashku me ndryshimet e propozuara është riparaqitur në fund të Shtojcës D.

SNK 41 Bujqësia

Paragrafi 2 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 64.

Objekti

...

- 2 Standardi nuk zbatohet për:
- (a) ...
 - (e) aktivet me të drejtë përdorimi të cilat vijnë nga një qira e tokës që lidhet me aktivitetin bujqësor (shih SNRF 16 *Qiratë*).
- ...

Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

64 ...
SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 2. Një njësi ekonomike do të zbatoj këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

KIRFN 1 Ndryshimet në Detyrimet Ekzistuese që rrjedhin nga Dalja jashtë përdorimit, Restaurimi dhe Detyrime të Ngjashme

Paragrafi i referencave është ndryshuar.

Referencat

- SNRF 16 Qiratë
- SNK1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (ndryshuar në 2007)
- ...

Paragrafi 2 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 9B.

Objekti

- 2 Ky interpretim zbatohet për ndryshimet në matjen e çdo nxjerrjeje nga përdorimi, restaurimi ose detyrim të ngjashëm ekzistues i cili njëkohësisht:
- (a) të njohura si pjesë e kostos së një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) në përputhje me SNK 16 ose si pjesë e kostos së aktivit me të drejtë përdorimi në përputhje me SNRF 16; dhe
 - (b) ...

Data e hyrjes në fuqi

...
9B SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 2. Një njësi ekonomike do të zbatoj këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

KIRFN 12 Marrëveshjet Koncesionare të Shërbimit

Paragrafi i referencave është ndryshuar.

Referencat

- ...
- SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*

- SNRF 16 Qiratë
- ...
- SNK 17 Qiratë
- ...
- KIRFN 4Përveçitimi nëse një Marrëveshje përmban një marrëveshje Qiraje
- ...

Është shtuar paragrafi 14A.

Data e hyrjes në fuqi

28E SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ka ndryshuar paragrafin AG8 dhe Shtojcën B. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

Në shtojcën A është ndryshuar paragrafi AG8.

Shtojca A

Objekti (paragrafi 5)

AG8 Operatori mund të ketë të drejtë të përdorë infrastrukturën e ndashme të përshkruar në paragrafin AG7(a), ose lehtësirat e përdorura për shërbimet ndihmëse të parregulluara të përshkruara në AG7(b). Në të dy rastet, mund të thuhet se në përmbajtje është një qira për operatorin nga koncesion dhënësi; nëse është kështu, do të trajtohet në përputhje me ~~SNK 17~~SNRF 16.

KIS-29 Marrëveshjet e Koncesionit për Shërbimet: Dhënia e informacioneve shpjeguese

Paragrafi i referencave është ndryshuar.

Referencat

- SNRF 16 Qiratë
- ...
- SNK 17 Qiratë (ndryshuar në 2003)
- ...

Paragrafi 5 është ndryshuar.

Çështja

- ...
- 5 Disa aspekte dhe dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me disa nga marrëveshjet e koncesionit për shërbimet, tashmë, janë trajtuar nga Standardet ekzistuese Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (p.sh. SNK 16 zbatohet për blerjen e zënave toka, ndërtesa, makineri e pajisje, ~~SNK 17~~ SNRF 16 zbatohet për qiratë e aktiveve dhe SNK 38 zbatohet për blerjet e aktiveve jomateriale). Megjithatë, një marrëveshje koncesioni për shërbime mund të përfshijë kontrata përmbaruese që nuk janë trajtuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, me përjashtim kur ato janë detyruese, rast në të cilin zbatohet SNK 37. Prandaj, ky Interpretim trajton dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë për marrëveshjet e koncesionit për shërbimet.

Paragrafi i datës së hyrjes në fuqi është ndryshuar.

Data e hyrjes në fuqi

...

Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 6 (e) dhe 6A për periudhat vjetore që fillojnë më datë 1 janar 2008 ose më pas. Nëse një njësi ekonomike zbaton KIRFN 12 për një periudhë më të hershme, ndryshimi do të zbatohet për këtë periudhë më të hershme.

SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 5. Një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

KIS-32 Aktivet jo-materiale - Kostot e Faqes së Internetit

Paragrafi i referencave është ndryshuar.

Referencat

- ...
- SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*
- SNRF 16 *Qiratë*
- ...
- ~~SNK 17 *Qiratë* (ndryshuar në 2003)~~
- ...

Si pasojë e ndryshimit në SNRF 15 është ndryshuar paragrafi 6.

Çështja

- ...
- 6 SNK 38 nuk zbatohet për aktivet jo-materiale të mbajtura për shitje nga njësi ekonomike në mjedhën normale të biznesit (shih SNK 2 ose SNK 15) ose për dhënie me qira ~~që është objekti i SNK 17 të aktiveve jomateriale të trajtuara në përputhje me SNRF 16~~. Për pasojë, ky Interpretim nuk zbatohet për shpenzimet e zhvillimit ose funksionimit të faqes së internetit (ose programit të faqes së internetit) që mbahet për shitje të

një njësi tjetër ekonomike ose që trajtohet në përputhje me SNRF 16. Kur një faqe interneti është dhënë nën kuadrin e qirave të zakonshme, qiradhënësi duhet të aplikojë këtë interpretim. Kur një faqe interneti është dhënë nën kuadrin e qirave financiare, qiramarësi zbaton këtë interpretim pas njohjes fillestare të aktivit të marrë me qira.

Paragrafi i datës së hyrjes në fuqi është ndryshuar.

Data e hyrjes në fuqi

...

SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*, i publikuar në Maj 2014, ndryshoi seksionin 'Referencat' dhe paragrafin 6. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 15.

SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi paragrafin 6. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 16.

SNK 40 Aktivët Afatgjatë Materiale të Investuara

Për shkak të ndryshimeve të mëdha në SNK 40 *Aktivët Afatgjatë Materiale të Investuara*, është riparaqitur teksti i plotë i këtij Standardi me ndryshimet e propozuara, pas ndryshimeve në SNRF 15. Teksti i ri është i nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 40 Aktivët Afatgjatë Materiale të Investuara

Objektivi

- Objektivi i këtij Standardi është të përkrahjë trajtimin kontabël për aktivin afatgjatë material të investuar dhe kërkesat përkatëse për dhënie informacionesh shpjeguese.

Objekti

- Ky Standard do të zbatohet në njohjen, matjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese për aktivin afatgjatë material të investuar.
- [Fshirë] Ndërmjet të tjerash, ky Standard zbatohet në pasqyrat financiare të qiramarësit në matjen e interesave të aktivit afatgjatë material të investuar të mbajtur sipas një qiraje të trajtuar si qira financiare dhe në matjen, në pasqyrat financiare të qiradhënësit, të aktivit afatgjatë material të investuar të dhënë një qiramarësi sipas një qiraje të zakonshme. Ky Standard nuk trajton qirajet të cilat trajtohen në SNK 17 *Qiraja*, përfishirë:
 - klasifikimin e qirave si qira financiare apo qira e zakonshme;
 - njohjen e të ardhurave nga qiraja nga aktivit afatgjatë material i investuar (shih gjithashtu SNK 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*);
 - matjen, në pasqyrat financiare të qiramarësit, të interesave të pasurisë së mbajtur sipas një qiraje të trajtuar si qira e zakonshme;
 - matjen, në pasqyrat financiare të qiradhënësit, të investimit të tij neto në një qira financiare;
 - kontabilitetin për shitjen dhe transferimet e shites dhe marrjes me qira; dhe
 - dhënien e informacioneve shpjeguese rreth qirave financiare dhe qirave të zakonshme.

- 4 Standardi nuk zbatohet për:
- (a) aktivet biologjike të lidhura me aktivitetet bujqësore (shih SNK 41 *Bujqësia* dhe SNK 16 *Aktivet Afatgjatë Materiale*); dhe
 - (b) të drejtat minerare dhe rezervat minerale, të tilla si nafta, gasi natyror dhe burime jo rigjeneruese të ngjashme.

Përkufizimet

- 5 Përkufizimet e termave të mëposhtme janë dhënë në këtë Standard sipas këtyre kuptimeve specifike:
- Vlera kontabël (neto)* është shuma në të cilën njihet aktivi në pasqyrën e pozicionit financiar.
- Kostoja* është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare e paguar ose vlera e drejtë e një shume tjetër të dhënë për të blerë një aktiv në kohën e blerjes apo të ndërtimit të tij, ose, kur është e mundshme, shuma e lidhur drejtpërdrejt me këtë aktiv kur është njohur fillimisht në përputhje me kërkesat specifike të SNRF-ve të tjera, p.sh. SNRF 2 *Pagesa të Bazuara në Aksione*.
- Vlera e drejtë* është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. (Shih SNRF 13 *Matja me Vlerën e Drejtë*).
- Aktivet Afatgjatë Materiale të Investuara* është pasuria (toka ose ndërtesa —ose pjesë e ndërtesës—ose të dyja) e mbajtur (nga pronari ose nga qiramarrësi si një aktiv me të drejtë përdorimisipas një qiraje financiare) për të siguruar të ardhura nga qiraja ose për rritjen e vlerës së kapitalit apo të dyja, me përjashtim kur:
- (a) përdoret për prodhimin ose furnizimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve ose për qëllime administrative; ose
 - (b) shitet në rrjedhën normale të biznesit.
- Pasuri e zotëruar nga pronari* është pasuria e mbajtur (nga pronari ose qiramarrësi si një aktiv me të drejtë përdorimisipas një qiraje financiare) që përdoret për prodhimin ose furnizimin e mallrave, kryerjen e shërbimeve, ose për qëllime administrative.

Klasifikimi i pasurisë si aktiv afatgjatë material i investuar ose pasuri e zotëruar nga pronari

- 6 [Fshihet] Një interes nga pasuria, që mbahet nga qiramarrësi sipas një qiraje të zakonshme, mund të klasifikohet dhe të trajtohet si aktiv afatgjatë material i investuar nëse, dhe vetëm nëse pasuria nga ana tjetër do të plotësonte përkufizimin e një aktivi të tillë dhe qiramarrësi përdor modelin e vlerës së drejtë të parashtruar në paragrafët 33–55 për aktivin e njohur. Ky klasifikim alternativ përdoret bazuar në pasuri për pasuri. Megjithatë, capo zgjidhet ky klasifikim alternativ për interesin nga pasuria e mbajtur sipas një qiraje të zakonshme, e gjithë pasuria e klasifikuar si aktiv afatgjatë material i investuar do të trajtohet duke përdorur modelin e vlerës së drejtë. Kur përzgjidhet ky klasifikim alternativ, jopet informacion shpjegues për çdo interes të klasifikuar në këtë mënyrë, siç kërket nga paragrafët 74–78.
- 7 Aktiv afatgjatë material i investuar mbahet për të siguruar të ardhura nga qiraja ose për rritje të vlerës së kapitalit ose të dyja së bashku. Prandaj, një aktiv afatgjatë material i investuar gjeneron flukse mjeteesh monetare në mënyrë tërësisht të pavarur nga aktivet e tjera të mbajtura nga njësi ekonomike. Një gjë e tillë e bën të dallueshëm aktivin afatgjatë material të investuar nga pasuria e zotëruar nga pronari. Prodhimi ose furnizimi i mallrave, ose kryerja e shërbimeve (ose përdorimi i pasurisë për qëllime administrative) gjeneron flukse mjeteesh monetare që nuk lidhen drejtpërdrejt vetëm me pasurinë, por edhe me aktive të tjera të përdorura në procesin e prodhimit apo të furnizimit. SNK 16 zbatohet për pasuri të zotëruar nga pronari në zotërim dhe SNRF 16 zbatohet për pasuri të zotëruar nga pronari që mbahet nga një qiramarrës si aktiv me të drejtë përdorimi.
- 8 Më poshtë janë dhënë raste të aktivit afatgjatë material të investuar:
- (a) toka e mbajtur për rritjen e vlerës së kapitalit për periudha afatgjatë dhe jo për qëllime shiteje afatshkurtesh në rrjedhën normale të biznesit.
 - (b) toka e mbajtur për përdorim në të ardhmen aktualisht të papërcaktuar. (Nëse një njësi ekonomike nuk e ka përcaktuar se do ta përdorë tokën si pasuri e zotëruar nga pronari ose për shitje

- afatshkurtyr në rrjedhën normale të biznesit, atëherë toka trajtohet si e mbajtur për ritjen e vlerës së kapitalit.)
- (c) një ndërtesë e zotëruar nga njësi ekonomike (ose një aktiv me të drejtë përdorimi që lidhet me një ndërtesë e mbajtur nga njësi ekonomike ~~sipas një qiraje financiare~~) dhe e dhënë për një ose më shumë qira të zakonshme.
 - (d) një ndërtesë që është e lirë, por mbahet për t'u dhënë për një ose më shumë qira të zakonshme.
 - (e) pronë që po ndërtohet apo zhvillohet për përdorim në të ardhmen si një aktiv afatgjatë material të investuar.
- 9 Shembujt e mëposhtëm janë shembuj zërorë që nuk përbëjnë aktive afatgjatë materiale të investuar dhe për pasojë nuk janë objekt i këtij Standardi:
- (a) aktiv afatgjatë material me qëllim shitje në rrjedhën normale të biznesit ose në procesin e ndërtimit apo zhvillimit për të tilla shitje (shih SNK 2 *Inventarët*), për shembull, pasuria e blerë posaçërisht për qëllime shitjeje të mëpasshme në të ardhmen e afërt ose për zhvillim dhe rishitje.
 - (b) [fshirë]
 - (c) pasuria e zotëruar nga pronari (shih SNK 16 dhe SNRF 16), përfshirë (ndërmjet të tjerash) aktivin afatgjatë material e mbajtur për ta përdorur në të ardhmen si pasuri e zotëruar nga pronari, aktivin afatgjatë material e mbajtur për zhvillim në të ardhmen dhe më pas për t'u përdorur si pasuri e zotëruar nga pronari, aktivin afatgjatë material e zotëruar nga punonjësit (pavarësisht nëse paguajnë ose jo qiranë sipas normave të tregut) dhe aktivin afatgjatë material të zotëruar nga pronari në pritje për t'u nxjerrë jashtë përdorimit.
 - (d) [fshirë]
 - (e) aktiv afatgjatë material i dhënë me qira një njësi ekonomike tjetër sipas qirasë financiare.
- 10 Disa aktive afatgjatë materiale përbëhen nga një pjesë që mbahet për të siguruar të ardhur nga qiraja ose për ritjen e vlerës së kapitalit dhe një pjesë tjetër që mbahet për ta përdorur në prodhimin ose furnizimin e mallrave apo kryerjen e shërbimeve, ose për qëllime administrative. Nëse këto pjesë mund të shiten në mënyrë të veçantë (ose të jepen me qira në mënyrë të veçantë sipas një qiraje financiare), njësi ekonomike i trajton ato në mënyrë të veçantë. Nëse pjesët nuk mund të shiten në mënyrë të veçantë, aktiv është aktiv afatgjatë material i investuar vetëm nëse një pjesë e parëndësishme mbahet për t'u përdorur për prodhimin ose furnizimin e mallrave, apo kryerjen e shërbimeve, ose për qëllime administrative.
- 11 Në disa raste, njësi ekonomike iu ofron shërbime ndihmëse banorëve të një pasurie që ajo zotëron. Njësi ekonomike e trajton një pasuri të tillë si aktiv afatgjatë material të investuar nëse shërbimet janë të parëndësishme për marrëveshjen në tërësi. Një shembull është në rastin kur pronari i një ndërtese zyrtare kryen shërbimet e sigurimit dhe të mirëmbajtjes për qinamarrësin, i cili ndodhet në këtë ndërtesë.
- 12 Në raste të tjera, shërbimet e kryera janë të rëndësishme. Për shembull, nëse një njësi ekonomike zotëron dhe drejton një hotel, shërbimet e kryera për klientët janë të rëndësishme për marrëveshjen në tërësi. Prandaj, një hotel i administruar nga pronari është pasuri e zotëruar nga pronari, sesa një aktiv afatgjatë material i investuar.
- 13 Mund të jetë e vështirë të përcaktohet nëse shërbimet ndihmëse janë aq të rëndësishme saqë një aktiv afatgjatë material të mos kualifikohet si aktiv afatgjatë material i investuar. Për shembull, pronari i një hoteli ndonjëherë ua kalon disa nga përgjegjësitë palëve të treta sipas një kontrate drejtimi. Termat e kontratave të tilla ndryshojnë gjerësisht. Nga njëra anë, pozicioni i pronarit, në thelb, mund të jetë ai i një investitori detyrim. Nga ana tjetër, pronari mund të ketë theksht funksione të përditshme si i jashtëm, ndërsa ruan kryesisht ekspozimin ndaj ndryshueshmërisë në fluksin e mjeteve monetare të gjeneruara nga aktivitetet e hotelit.
- 14 Për të përcaktuar që një aktiv afatgjatë material të kualifikohet si aktiv afatgjatë material i investuar, kërkohet një farë gjykimi. Kështu, njësi ekonomike zhvillon kriteret që ajo ta përdorë këtë gjykim në vijimësi në përputhje me përkufizimin e aktivitet afatgjatë material të investuar dhe në lidhje me udhëzimin përkatës në paragrafët 7–13. Paragrafi 75(c) kërkon që njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për këto kritere, kur klasifikimi është i vështirë.
- 14A Gjykimi kërkohet gjithashtu për të përcaktuar nëse blerja e aktivitet afatgjatë material të investuar është një aktiv ose një grup aktivesh, ose një kombinim biznesi brenda objektit të SNRF 3 *Kombinimet e biznesit*. Për të përcaktuar nëse ai është një kombinim biznesi duhet t'i referohemi SNRF 3. Shtjellimi në paragrafët 7–14 të këtij Standardi lidhet me faktin nëse pasuria është ose jo pasuri e zotëruar nga pronari apo aktiv afatgjatë material i investuar, por jo me përcaktimin nëse blerja e një pasurie është ose jo një kombinim biznesi siç përkufizohet në SNRF 3. Përcaktimi nëse një transaksion specifik plotëson përkufizimin e një kombinimi biznesi, siç është shpjeguar në SNRF 3 dhe përfshin një aktiv afatgjatë material i investuar siç përcaktohet në këtë Standard kërkon, zbatimin e veçantë të të dyja Standardeve.

- 15 Në disa raste, njësi ekonomike ka pronësinë mbi aktivin afatgjatë material të dhënë me qira dhe të zotëruar nga shoqëria e saj mëmë apo një filial tjetër. Aktivit nuk kualifikohet si aktiv afatgjatë material i investuar në pasqyrat financiare të konsoliduara, sepse ai është i zotëruar nga pronari nga këndvështrimi i grupit. Megjithatë, nga këndvështrimi i njësisë ekonomike që ka pronësinë mbi të, ky aktiv është aktiv afatgjatë material i investuar nëse plotëson përkufizimin në paragrafin 5. Prandaj, qiradhënësi e trajton aktivin si aktiv afatgjatë material të investuar në pasqyrat financiare individuale të tij.

Njohja

- 16 **Një Aktiv afatgjatë material i investuar i zotëruar do të njihet si aktiv kur, dhe vetëm kur:**
- (a) **ka probabilitet që përfitimet ekonomike të ardhshme, që lidhen me aktivin afatgjatë material të investuar, do të merren nga njësi ekonomike; dhe**
- (b) **kostoja e aktivit afatgjatë material të investuar mund të matet me besueshmëri.**
- 17 Njësi ekonomike vlerëson sipas këtij parimi të njohjes të gjitha kostot e aktiveve afatgjata materiale të investuara të saj në kohën që ato kryhen. Këto kosto përfshijnë kostot e kryera në fillim për të blerë aktivin afatgjatë material të investuar dhe kostot e kryera më pas për të shtuar, zëvendësuar ndonjë pjesë ose për të mirëmbajtur atë.
- 18 Sipas parimit të njohjes në paragrafin 16, njësi ekonomike nuk njeht në vlerën kontabël (neto) të aktivit afatgjatë material të investuar kostot e mirëmbajtjes së përditshme të një aktivi të tillë. Kështu, këto kosto njihen në fitim ose humbje kur ato kryhen. Kostot e mirëmbajtjes së përditshme janë kryesisht kostot e punës dhe e pjesëve të ndërrimit, dhe mund të përfshihen edhe kostoja e pjesëve të vogla. Shpesh, qëllimi i këtyre shpenzimeve përkrahëhet si për "riparime dhe mirëmbajtje" të aktivit.
- 19 Pjesët e aktiveve afatgjata materiale të investuara mund sigurohen nëpërmjet zëvendësimit. Për shembull, muret e brendshme mund të kenë zëvendësuar muret fillestare. Sipas parimit të njohjes, njësi ekonomike njeht në vlerën kontabël (neto) të aktivit afatgjatë material të investuar ekzistues koston e pjesës zëvendësuese në këtë aktiv në kohën që kryhet, nëse plotësohet kriteri i njohjes. Vlera kontabël (neto) e pjesëve që janë zëvendësuar çregjistrohet në përputhje me kushtet për çregjistrim të këtij standardi.
- 19A **Një aktiv afatgjatë material i investuar i mbajtur si një aktiv me të drejtë përdorimi do të njihet në përputhje me SNRF 16.**

Matja dhe Njohja

- 20 **Një aktiv afatgjatë material i investuar i zotëruar do të matet fillimisht me koston e tij. Në matjen fillestare do të përfshihen dhe kostot e transaksionit.**
- 21 Kostoja e një aktivi afatgjatë material të investuar të blerë përbëhet nga çmimi i blerjes dhe çfarëdo shpenzimi i ngarkueshëm drejtpërdrejt. Në shpenzimet e ngarkueshme drejtpërdrejt përfshihen, për shembull, tarifatat profesionale për shërbimet ligjore, taksat e transferimit të pasurisë dhe kosto transaksioni të tjera.
- 22 [Fshire]
- 23 Në koston e një aktivi afatgjatë material të investuar nuk mund përfshihen:
- (a) kostot e nisjes (vetëm nëse ato janë të nevojshme për sjelljen e aktivit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij sipas qëllimeve të drejtimit),
- (b) humbjet e shfrytëzimit të ndodhura para se aktivi afatgjatë material i investuar arrijë nivelin e planifikuar të zotërimit, ose
- (c) shpenzimet e tepërta për materiale, punë dhe burime të tjera të kryera gjatë ndërtimit apo zhvillimit të aktivit.
- 24 Nëse pagesa për një aktiv afatgjatë material të investuar është shtyrë, kostoja e tij është ekuivalenti i çmimit në mjete monetare. Diferenca midis kësaj shume dhe totalit të pagesave njihet si shpenzim interesi përgjatë periudhës së kredisë.
- 25 **[Fshire] Kostoja fillestare e interesit nga pasuria e mbajtur sipas një qiraje dhe i klasifikuar si aktiv afatgjatë material i investuar do të jetë siç është përshkruar për qiranë financiare nga paragrafi 20 i SNK 17, d.m.th. aktivi do të njihet me vlerën më të ulët mes vlerës së drejtë të pasurisë dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirës. Një shumë ekuivalente do të njihet si Detyrim në përputhje me të njëjtin paragraf.**

- 26 [Fshirë] Çdo prim i paguar për qirash trajtohet si pjesë e pagesave minimale të qirash për këtë qëllim dhe primat përfshihen në koston e aktivit, por përjashtohet nga detajimi. Nëse interesi nga aktivi afatgjatë material i mbajtur sipas një qiraje klasifikohet si aktiv afatgjatë material i investuar, zëri i trajtuar me vlerën e drejtë është ky interes dhe jo aktivi bazë. Udhëzimi për matjen e vlerës së drejtë të një interesi të një aktivi afatgjatë material për investim është dhënë për modelin e vlerës së drejtë në paragrafët 33-35, 40, 41, 48, 50 dhe 52 dhe në SNRF 13. Ky udhëzim është gjithashtu i rëndësishëm për matjen e vlerës së drejtë kur kjo vlerë përdoret si kosto për qëllimet e njohjes fillestare.
- 27 Një ose më shumë aktive afatgjata materiale të investuara mund të përftohen në këmbim të një ose disa aktiveve jomonetare, ose nga kombinimi i aktiveve monetare me ato jomonetare. Diskutimi në vijim i referohet këmbimit të një aktivi jomonetar me një tjetër, por ai është i vlefshëm gjithashtu për të gjitha këmbimet e sapo përshkruara. Kostoja e një aktivi të tillë afatgjatë material i investuar matet me vlerën e drejtë përveç rasteve kur (a) transaksionit të këmbimit i mungon përmbajtja tregtare ose (b) vlera e drejtë si e aktivit të marrë, ashtu dhe e aktivit të dhënë nuk matet me besueshmëri. Aktivi i blerë matet në këtë mënyrë edhe nëse njësia ekonomike nuk mundet që ta çregjistrojë menjëherë aktivin e dhënë. Në qoftë se aktivi i blerë nuk matet me vlerën e drejtë, kosto e tij matet me vlerën kontabël (neto) të aktivit të dhënë.
- 28 Njësia ekonomike përcakton nëse një transaksion këmbimi ka përmbajtje tregtare duke marrë parasysh se në çmasë pritët të ndryshojnë fluksat e ardhshme të mjeteve monetare si rezultat i tij. Një transaksion këmbimi ka thelb tregtar nëse:
- (a) konfigurimi (rreziku, kohëzgjatja dhe shumta) e fluksëve të mjeteve monetare të aktivit të marrë ndryshon nga konfigurimi i fluksëve monetare të aktivit të transferuar, ose
 - (b) vlera specifike e njësise ekonomike për pjesën e aktivitetëve të saj është prekur nga ndryshimet e transaksionit si rezultat i këmbimit, dhe
 - (c) diferenca në (a) ose (b) është e ndjeshme në lidhje me vlerën e drejtë të aktiveve të këmbyer.
- Për qëllimet e përcaktimit nëse një transaksion këmbimi ka thelb tregtar, vlera specifike e njësise ekonomike e pjesës së operacioneve të ndikuara të njësise ekonomike nga transaksioni pasqyron fluksat monetare pas tatimit. Rezultati i këtyre analizave mund të jetë i qartë pa pasur nevojë që njësia ekonomike të kryejë llogaritje të hollësishme.
- 29 Vlera e drejtë e një aktivi është e matshme me besueshmëri nëse (a) ndryshueshmëria në intervalin e matjeve të arsyeshme të vlerës së drejtë nuk është e rëndësishme për këtë aktiv ose (b) probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme brenda intervalit mund të vlerësohen në mënyrë të arsyeshme dhe të përdoren gjatë matjes së vlerës së drejtë. Nëse një njësia ekonomike është në gjendje të matë në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë ose të aktivit të marrë, ose të aktivit të dhënë, atëherë vlera e drejtë e aktivit të dhënë përdoret për të matur koston, përveç rastit kur vlera e drejtë e aktivit të marrë është më e evidentueshme.
- 29A Një aktiv afatgjatë material i investuar, i mbajtur si një aktiv me të drejtë përdorimi, do të njihet në përputhje me SNRF 16.

Matja pas njohjes

Politika kontabël

- 30 **Duke patur parasysh përjashtimet që përmendet në paragrafinë 32A dhe 34, njësia ekonomike do të zgjedhë si politikë të saj kontabël ose modelin e vlerës së drejtë në paragrafët 33-55, ose modelin e koston në paragrafin 56 dhe do ta zbatojë këtë politikë për të gjitha aktivet afatgjata materiale të investuara të saj.**
- 31 Në SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet* thuhet se një ndryshim i vullnetshëm në politikën kontabël duhet të bëhet vetëm nëse ky ndryshim do të çojë në një paraqitje më të përshtatshme të transaksioneve, ngjarjeve të tjera ose kushteve në pasqyrat financiare të njësise ekonomike. Ka shumë pak mundësi që një ndryshim nga modeli i vlerës së drejtë në modelin e koston të çojë në një paraqitje më të përshtatshme.
- 32 Ky Standard kërkon që të gjitha njësitë ekonomike të matin vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material për investim, si për qëllime të matjes (nëse njësia ekonomike përdor modelin e vlerës së drejtë) ose për dhënie të informacioneve shpjeguese (nëse ajo përdor modelin e koston). Një njësia ekonomike inkurajohet, por nuk kërkohej të matë vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material për investim në bazë të një vlerësimi nga ana e një vlerësuesi të pavarur, i cili ka një kualifikim të njohur dhe përkatës profesional dhe ka përvojë aktuale në vendndodhjen dhe kategorinë e aktivit afatgjatë material për investim që po vlerësohet.
- 32A **Njësia ekonomike mund:**

- (a) të zgjedhë ose modelin e vlerës së drejtë, ose modelin e kostos për të gjitha aktivet afatgjata materiale të investuara duke rënduar detyrimet që japin një kthim të lidhur drejtpërdrejt me vlerën e drejtë të, ose kthimet nga, aktivet e specifikuar përfshirë dhe aktivin afatgjatë material të investuar; dhe
- (b) të zgjedhë ose modelin e vlerës së drejtë, ose modelin e kostos për të gjitha aktivet afatgjata materiale të investuara të tjera, pavarësisht nga zgjedhja e bërë në (a).
- 32B Disa shoqëri siguruese dhe njësi të tjera ekonomike veprojnë si një fond i pasurisë së brendshme që emeton njësi imagjinare, me disa njësi të mbajtura nga investorët sipas kontratave të lidhura dhe të tjera të mbajtura nga njësi ekonomike. Paragrafi 32A nuk lejon një njësi ekonomike të matë pasurinë e mbajtur nga fondi pjesërisht me kosto dhe pjesërisht me vlerën e drejtë.
- 32C Nëse njësi ekonomike zgjedh modele të ndryshme për dy kategoritë e përshkruara në paragrafin 32A, shitja e aktivit afatgjatë material i investuar ndërmjet bashkësive të aktiveve të matura duke përdorur modele të ndryshme do të njihet me vlerën e drejtë dhe ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë do të njihet në fitim ose humbje. Kështu, nëse një aktiv afatgjatë material i investuar shitet nga një bashkësi në të cilën është përdorur modeli i vlerës së drejtë në një bashkësi ku përdoret modeli i kostos, vlera e drejtë e pasurisë në datën e shitjes bëhet kostoja e supozuar e saj.

Modeli i vlerës së drejtë

- 33 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike që ka zgjedhur modelin e vlerës së drejtë do të matë të gjitha aktivet afatgjata materiale të investuara me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve të përshkruara në paragrafin 53.
- 34 ~~[Fshirë] Kur interesi nga pasuria e mbajtur nga qiramarrësi sipas qirasë së zakonshme klasifikohet si një aktiv afatgjatë material i investuar, sipas paragrafit 6, atëherë paragrafi 30 është i detyrueshëm; duhet të zbatohet modeli i vlerës së drejtë.~~
- 35 Fitimi ose humbja neto që rrjedh nga ndryshimi në vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material të investuar do të njihet në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ndodh.
- 36–
39 [Fshirë]
- 40 Kur matet vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material për investim në përputhje me SNRF 13, një njësi ekonomike do të sigurojë që vlera e drejtë pasqyron, midis të tjerash, të ardhura nga qiratë aktuale dhe supozimet e tjera që përfaqësojnë atë çfarë pjesëmarrësit e tregut do të përdornin kur të caktonin çmimin e aktivit afatgjatë material për investim në kushtet aktuale të tregut.
- 40A Nëse një qiramarrës përdor modelin e vlerës së drejtë për të matur një aktiv afatgjatë material të investuar që mbahet si aktiv me të drejtë përdorimi, ai do të masë këtë aktiv dhe jo aktivin bazë afatgjatë material të investuar me vlerën e drejtë.
- 41 ~~Paragrafi 25 SNRF 16 specifikon bazën për njohjen fillestare të kostos së një interesi në pasurinë e dhënë me qira një aktiv afatgjatë material të investuar të mbajtur nga një qiramarrës si aktiv me të drejtë përdorimi. Paragrafi 33 kërkon që interesi në pasurinë e dhënë me qira aktiv afatgjatë material i investuar, që mbahet nga një qiramarrës si një aktiv me të drejtë përdorimi të matet nëse është e nevojshme me vlerën e drejtë, nëse njësi ekonomike zgjedh modelin e vlerës së drejtë. Kur negociohet një qira Nëse pagesat e qirasë janë sa normat e tregut, vlera e drejtë në blerje e interesit në pasurinë e dhënë me qira një aktiv afatgjatë material të investuar që mbahet nga një qiramarrës si aktiv me të drejtë përdorimi, e pakësuar për të gjitha pagesat e pritshme të qirasë (duke përfshirë ato që lidhen me njohjen e detyrimeve të qirasë), duhet jetë zero. Kjo vlerë e drejtë nuk ndryshon pavarësisht nëse, për qëllime kontabël, një aktiv i dhënë me qira dhe një detyrim njihen me vlerën e drejtë ose me vlerën aktuale të pagesave minimale të qirasë, në përputhje me paragrafin 20 të SNK 17. Pra, rrimatja e një aktiv të dhënë me qira aktiv me të drejtë përdorimi nga me kosto në përputhje me paragrafin 25 SNRF 16, me vlerën e drejtë në përputhje me paragrafin 33 (duke marrë në konsideratë kërkesat në paragrafin 50) nuk duhet të sjellë fitim ose humbje fillestare, përveç rastit kur vlera e drejtë matet në kohë të ndryshme. Kjo mund të ndodhë kur zgjedhja për zbatimin e modelit të vlerës së drejtë bëhet pas njohjes fillestare.~~
- 42–
47 [Fshirë]
- 48 Në raste të veçanta, ekziston evidencë e qartë kur një njësi ekonomike blen për herë të parë një aktiv afatgjatë material për investim (ose kur një aktiv afatgjatë material ekzistues për herë të parë bëhet aktiv afatgjatë material për investim, pas një ndryshimi në përdorim) se ndryshueshmëria në intervalin e matjeve të arsyeshme të vlerës së drejtë do të jetë aq e madhe, dhe probabilitetet e rezultateve të ndryshme kaq të vështira për t'u vlerësuar, saqë liqet dorë nga dobishmëria e një matjeje të vlerës së drejtë. Kjo mund të

tregojë se vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material për investim nuk do të jetë e matshme në mënyrë të besueshme mbi një bazë të vazhdueshme (shih paragrafin 53).

49 [Fshirë]

50 Në përcaktimin e vlerës së drejtë të aktivit afatgjatë material të investuar, njësia ekonomike nuk i llogarit në mënyrë të dyfishtë aktivet ose Detyrimet që janë të njohura si aktive ose Detyrime të veçanta. Për shembull:

- (a) pajisjet e ndërtimit ose të ajrit të kondicionuar shpesh janë pjesë përbërëse e një ndërtese dhe në përgjithësi përfshihen në vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material të investuar, sesa njihen veças si toka, ndërtesa, makineri e pajisje.
- (b) nëse një zyrë është dhënë me qira duke qenë e mobiluar, vlera e drejtë e zyrës në përgjithësi përfshin edhe vlerën e drejtë të orëdivë, sepse të ardhurat nga qiraja kanë të bëjnë me zyrën e mobiluar. Kur orëdivët janë të përfshirë në vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material të investuar, njësia ekonomike nuk i njeh ato si një aktiv i veçantë.
- (c) vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar përjashton të ardhurat e parapaguara ose të konstatuara nga qiraja e zakonshme, sepse njësia ekonomike i njeh ato si një detyrim ose aktiv i veçantë.
- (d) vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar të mbajtur nga një qiramarrës si aktiv me të drejtë përdorimi sipas një qiraje pasqyron flukset e pritshme të mjeteve monetare (duke përfshirë ~~qirarë eventuale që do të~~ pagesat variabël të qirajës që pritet të bëhen të pagueshme). Pra, nëse vlerësimi i një aktivi merret neto nga të gjitha pagesat e pritshme për t'u bërë, do të ishte e nevojshme të shtohet përsëri çdo detyrim i njohur qiraje, për të arritur në vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material të investuar për qëllime kontabël.

51 [Fshirë]

52 Në disa raste, njësia ekonomike pret që vlera aktuale e pagesave që kanë të bëjnë me aktivin afatgjatë material të investuar (përveç pagesave për Detyrimet e njohura) të tejkalojë vlerën aktuale të arkëtimeve përkatëse në mjete monetare. Njësia ekonomike zbaton SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara* për të përcaktuar nëse duhet të njohë një Detyrim dhe nëse po, si ta matë atë.

Pamundësia për matje të besueshme të vlerës së drejtë

53 Ka një hipotezë të kundërshtueshme sipas së cilës një njësi ekonomike mund të përcaktojë në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material të investuar mbi një bazë të vazhdueshme. Gjithsesi, në raste përjashtimore, ka prova të qarta se kur njësia ekonomike ble së pari një aktiv afatgjatë material të investuar (ose kur një aktiv ekzistues bëhet aktiv afatgjatë material i investuar si rezultat i ndryshimit në përdorim) që vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar nuk përcaktohet në mënyrë të besueshme mbi një bazë reale. Kjo ndodh kur, dhe vetëm kur, transaksionet e krahasueshme të tregut nuk bëhen rregullisht dhe nuk disponohen vlerësime alternative të vlerës së drejtë (p.sh. në bazë të parashikimeve të skontuara të flukseve të mjeteve monetare). Nëse njësia ekonomike përcakton se vlera e drejtë e një aktivi afatgjatë material të investuar që është në ndërtim nuk është i përcaktueshëm në mënyrë të besueshme, por pret që vlera e drejtë e aktivit të përcaktueshme në mënyrë të besueshme kur të përfundojë ndërtimi, ajo duhet të masë aktivin afatgjatë material të investuar që është në ndërtim me kosto ose kur vlera e drejtë të bëhet e besueshme ose kur të ketë përfunduar ndërtimi (cilado të ndodhë më parë). Nëse njësia ekonomike përcakton se vlera e drejtë e një aktivi afatgjatë material të investuar (të ndryshëm nga një aktiv afatgjatë material të investuar në ndërtim) nuk mund të matet me besueshmëri në mënyrë të vijueshme, njësia ekonomike duhet ta masë atë aktiv afatgjatë material të investuar duke përdorur modelin e koston të SNK 16 për aktivin afatgjatë material të investuar të zotëruar ose në përputhje me SNRF 16 për aktivin afatgjatë material të investuar të mbajtur nga një qiramarrës si aktiv me të drejtë përdorimi. Vlera e tepricës të aktivit afatgjatë material të investuar do të supozohet të jetë zero. Njësia ekonomike do të vazhdojë të zbatojë SNK-në 16 ose SNRF 16 deri në daljen jashtë përdorimi të aktivit afatgjatë material të investuar.

53A Në momentin kur një njësi ekonomike aftësohet në matjen e një vlerë të drejtë të besueshme të një aktivi afatgjatë material të investuar në ndërtim, që më parë është matur në kosto, ajo mat aktivin me vlerën e tij të drejtë. Kur të ketë përfunduar ndërtimi i kësaj prone, mendohet që vlera e drejtë të matet në mënyrë të besueshme. Nëse nuk është ky rast, sipas paragrafit 53, pasuria duhet të trajtohet sipas modelit të koston në përputhje me SNK 16 për aktivet e zotëruara ose SNRF 16 për aktivin afatgjatë material të investuar që mbahet nga një qiramarrës si aktiv me të drejtë përdorimi.

53B Supozimi se vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar që është në ndërtim mund të matet në mënyrë të besueshme mund të kundërshtohet vetëm në njohjen fillestare. Një njësi ekonomike që ka matur

një aktiv afatgjatë material të investuar që është në ndërtim mund të mos arrijë në përfundimin se vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar të përfunduar nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme.

- 54 Në rastet përjashtimore, kur një njësi ekonomike është e detyruar, për arsye të dhëna në paragrafin 53, të matë një aktiv afatgjatë material të investuar duke përdorur modelin e koston në përputhje me SNK 16 ose me SNRF 16, ajo i mat të gjitha aktivet afatgjata materiale të investuara të tjera të saj me vlerën e drejtë duke përfshirë edhe aktivin afatgjatë material të investuar në ndërtim. Në këto raste, ndonëse njësi ekonomike mund të përdorë modelin e koston për një nga aktivet afatgjatë materiale të investuara, ajo do të vazhdojë ta trajtojë secilën prej aktiveve të tjera të tilla duke përdorur modelin e vlerës së drejtë.
- 55 Nëse një njësi ekonomike ka matur më parë një aktiv afatgjatë material të investuar me vlerën e drejtë, ajo do të vazhdojë ta matë atë me vlerën e drejtë deri sa ta nxjerrë jashtë përdorimit (ose deri sa aktiv i të bëhet pasuri e zotëruar nga pronari, ose njësi ekonomike fillon ta zhvillojë aktivin për ta shitur më pas në rrjedhën normale të biznesit) edhe nëse transaksionet e krahasueshme të tregut bëhen më pak të shpeshta ose çmimet e tregut nuk janë lehtësisht të disponueshme.

Modeli i koston

- 56 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike që zgjedh modelin e koston do t'i matë të gjitha aktivet afatgjata materiale të investuara në përputhje me kërkesat e SNK 16 për këtë model, me përjashtim të atyre që plotësojnë kriterin për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose që janë përfshirë në grupin e nxjerrë jashtë përdorimit që klasifikohet si i mbajtur për shitje) që do të trajtohen në përputhje me SNRF 5 Aktivet Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet Jo të Vjeshme. Aktivet afatgjata materiale të investuara që plotësojnë kriterin për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose janë përfshirë në grupin e atyre të nxjerrë jashtë përdorimit, që klasifikohet si i mbajtur për shitje) do të maten në përputhje me SNRF 5.

Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike që zgjedh modelin e koston duhet të masë aktivin afatgjatë material të investuar:

- (a) në përputhje me SNRF 5 Aktivet Afatgjata që Mbahen për t'u Shitur dhe Operacionet Jo të Vjeshme kur ato janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose janë përfshirë në një grup për nxjerrje nga përdorimi që është klasifikuar si i mbajtur për shitje);
- (b) në përputhje me SNRF 16, nëse ai mbahet nga një qiramarrës si një aktiv me të drejtë përdorimi dhe nuk mbahet për shitje në përputhje me SNRF 5; dhe
- (c) ne përputhje me kërkesat në SNK 16 për modelin e koston në të gjitha rastet e tjera.

Transferimet

- 57 Transferimet për në ose nga aktiv afatgjatë material i investuar do të bëhen vetëm dhe vetëm kur ka një ndryshim në përdorim, i provuar nga:
- (a) fillimi i zotërimit nga pronari, për një transferim nga aktiv afatgjatë material i investuar në pasuri e zotëruar nga pronari;
 - (b) fillimi i zhvillimit me qëllim shitje, për transferimin e aktivit afatgjatë material të investuar në inventarët;
 - (c) përfundimi i përdorimit nga pronari, për një transferim nga një aktiv të kontrolluar nga pronari në një aktiv afatgjatë material të investuar; ose
 - (d) fillimi i një qiraje operative për një palë tjetër, për një transferim nga inventarët në aktivin afatgjatë material të investuar.
 - (e) [fahire]
- 58 Paragrafi 57(b) kërkon që njësi ekonomike të transferojë aktivin nga aktiv afatgjatë material të investuar në inventar kur, dhe vetëm kur, ka një ndryshim në përdorim, evidentuar qysh prej fillimit të zhvillimit me qëllim shitjeje. Kur një njësi ekonomike vendos të nxjerrë jashtë përdorimit një aktiv afatgjatë material të investuar pa e zhvilluar atë, ajo vazhdon ta trajtojë aktivin si të tillë deri sa ai regjistrohet (hëqet nga pasqyra e pozicionit financiar) dhe nuk trajtohet si inventar. Po kështu, nëse njësi ekonomike fillon të rihvillojë një aktiv afatgjatë material të investuar ekzistues për përdorim të vazhdueshëm në të ardhmen si aktiv të tillë, atëherë ai mbetet si aktiv afatgjatë material i investuar dhe nuk riklasifikohet si pasuri e zotëruar nga pronari gjatë rihvillimit.

- 59 Paragrafët 60–65 zbatohen për njohjen dhe matjen kur një njësi ekonomike përdor modelin e vlerës së drejtë për aktivin afatgjatë material të investuar. Kur njësi ekonomike përdor modelin e kostos, transferimet ndërmjet aktivit afatgjatë material të investuar, pasurisë së zotëruar nga pronari dhe inventarëve nuk ndryshojnë vlerën kontabël (neto) të aktivit të transferuar dhe koston e këtij aktivi për qëllime të matjes dhe për dhënie informacionesh shpjeguese.
- 60 **Për transferimin nga aktiv afatgjatë material të investuar, i mbajtur me vlerën e drejtë, në aktiv të zotëruar nga pronari ose inventarë, kostoja e supozuar e aktivit, për trajtimin kontabël të mëposhëm në përputhje me SNK 16, SNRF 16 ose SNK 2, do të jeta vlera e drejtë e tij në datën e ndryshimit në përdorim.**
- 61 Nëse një pasuri e zotëruar nga pronari bëhet një aktiv afatgjatë material i investuar që do të mbahet me vlerën e drejtë, njësi ekonomike do të zbatojë SNK 16 për pasurinë e zotëruar dhe SNRF 16 për pasurinë e mbajtur nga një qiramarrësi si aktiv me të drejtë përdorimi deri në datën e ndryshimit në përdorim. Njësi ekonomike do të trajtojë çdo diferencë në këtë datë, midis vlerës kontabël (neto) të aktivit në përputhje me SNK 16 ose SNRF 16 dhe vlerës së drejtë të tij, në të njëjtën mënyrë si në rastin e rivlerësimit në përputhje me SNK 16.
- 62 Deri në datën kur një pasuri e zotëruar nga pronari bëhet një aktiv afatgjatë material i investuar i mbartur me vlerën e drejtë, njësi ekonomike amortizon aktivin (ose aktivin me të drejtë përdorimi) dhe njeh çdo humbje nga çvlerësimi që ka ndodhur. Njësi ekonomike do të trajtojë çdo diferencë në këtë datë, midis vlerës kontabël (neto) të aktivit në përputhje me SNK 16 ose SNRF 16 dhe vlerës së drejtë të tij, në të njëjtën mënyrë si në rastin e rivlerësimit në përputhje me SNK 16. Me fjalë të tjera:
- (a) çdo ulje në vlerën kontabël (neto) të aktivit njihet në fitim ose humbje. Megjithatë, ulja i ngarkohet tepriçës nga rivlerësimi në masën e shumës që është përfshirë në të për këtë aktiv.
 - (b) çdo rritje në vlerën kontabël (neto) trajtohet si më poshtë:
 - (i) në masën që rritja anulon humbjen e mëparshme nga zhvlerësimi për këtë aktiv, atëherë kjo rritje njihet në fitim ose humbje. Shuma e njohur në fitim ose humbje nuk e tejkalon shumën e nevojshme për të ruajtur vlerën kontabël (neto) në nivelin që do të kishte patur (neto nga amortizimi) nëse nuk do të ishte njohur humbje nga zhvlerësimi.
 - (ii) pjesa tjetër e rritjes kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin neto nën zërin tepriçë nga rivlerësimi. Kur më pas, aktivi afatgjatë material i investuar del jashtë përdorimit, tepriça nga rivlerësimi e përfshirë në kapitalin neto transferohet në fitimet e pasqepëmdara. Transferimi nga mbivlera rivlerësimi tek fitime të pasqepëmdara nuk bëhet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave.
- 63 **Për një transferim nga inventarët në aktiv afatgjatë material i investuar që do të mbartet me vlerën e drejtë, çdo diferencë midis vlerës së drejtë të aktivit në këtë datë dhe vlerës kontabël (neto) të mëparshme do të njihet në fitim ose humbje.**
- 64 Trajtimi i transferimeve nga inventarët në aktiv afatgjatë material i investuar që do të mbartet me vlerën e drejtë është në përputhje me trajtimin e shitjeve të inventarëve.
- 65 **Kur një njësi ekonomike përfundon ndërtimin ose zhvillimin e një aktivi afatgjatë material të investuar të vetë prodhuar që do të mbartet me vlerën e drejtë, çdo diferencë midis vlerës së drejtë të aktivit në këtë datë dhe vlerës kontabël (neto) të mëparshme do të njihet në fitim ose humbje.**

Nxjerrjet jashtë përdorimit

- 66 **Një aktiv afatgjatë material i investuar do të cëgëllstrohet (hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar) kur del jashtë përdorimit ose kur ky aktiv tërhiqet përfundimisht nga përdorimi dhe nuk pritet të ketë përfitime ekonomike të ardhshme nga nxjerrja jashtë përdorimit të tij.**
- 67 Nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material të investuar mund të realizohet nëpërmjet shitjes ose duke lidhur një kontratë qiraje financiare. Data e nxjerrjes jashtë përdorimit të një zëri të aktiveve afatgjata materiale që është shitur është data kur marrësi merr kontrollin e atij zëri në përputhje me kërkesat përcaktuese se kur përmbushet një detyrim i performancës në SNRF 15. ~~SNK 17~~ SNRF 16 zbatohet kur nxjerrja jashtë përdorimit bëhet si rezultat i lidhjes së një kontrate qiraje financiare dhe kontratë shitje dhe marrje me qira.
- 68 Nëse, në përputhje me parimin e njohjes në paragrafin 16, një njësi ekonomike njeh në vlerën kontabël (neto) të një aktivi koston e zëvendësimit për një pjesë të aktivit afatgjatë material të investuar, ajo cëgëllaston vlerën kontabël (neto) të pjesës së zëvendësuar. Për aktivin afatgjatë material të investuar të trajtuar sipas modelit të kostos, pjesa e zëvendësuar mund të mos jetë pjesë që është amortizuar veças. Nëse praktikisht nuk është e mundur për njësinë ekonomike të përcaktojë vlerën kontabël (neto) të pjesës së

zëvendësuar, ajo mund të përdorë koston e zëvendësimit si një tregues të koston së kësaj pjese në kohën kur ajo është blerë ose ndërtuar. Sipas modelit të vlerës së drejtë, tashmë vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar mund të pasqyrojë faktin që pjesa për t'u zëvendësuar ka humbur vlerën e saj. Në rastet e tjera mund të jetë e vështirë të përcaktohet se me sa do të ulët vlera e drejtë për pjesën që është zëvendësuar. Një alternativë për uljen e vlerës së drejtë për pjesën e zëvendësuar, kur nuk është e mundur të bëhet kështu, është të përfshihet kostoja e zëvendësimit në vlerën kontabël (neto) të aktivit dhe pastaj të rivilësohet vlera e drejtë, siç kërkohet për shtesat që nuk përfshihen në zëvendësim.

- 69 **Fitimet ose humbjet neto që rrjedhin nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivit afatgjatë material të investuar do të përcaktohen si diferencë midis shumës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktivit dhe vlerës kontabël (neto) të tij dhe do të njihet në fitim ose humbje (përveç rastit kur SNK-17SNRF 16 kërkon trajtim të ndryshëm për shitjen dhe shitje- marrjen me qira) në periudhën e vjetërsimit ose nxjerrjes jashtë përdorimit.**
- 70 Shuma e konsiderueshme që përfshihet në fitimin ose humbjen, që vjen nga mosnjohja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale dhe pagisjeve, të përcaktohet në përputhje me kërkesat për përcaktimin e çmimit të transaksionit në paragrafet 47-72 të SNRF 15. Ndryshimet e mëpasshme në shumën e vlerësuar të konsideratës të përfshirë në fitim ose humbje do të trajtohen në përputhje me kërkesat për ndryshim në çmimin e transaksionit të SNRF 15.
- 71 Njësia ekonomike zbaton SNK 37 ose standardet e tjera, kur është e përshtatshme, për ndonjë Detyrim që mbetet mbas nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivit afatgjatë material të investuar.
- 72 **Shuma e shpërblimit, e humbur ose e dhënë nga palët e treta për aktivin afatgjatë material të investuar që është i zhvlerësuar, duhet të njihet në fitim ose humbje kur shpërblimi bëhet i arkëtueshëm.**
- 73 Zhvlerësimet ose humbjet e aktivit afatgjatë material të investuar, të drejtat përkatëse për ose pagesat e shpërblimit nga palët e treta dhe çdo blerje ose zhvillim i mëpasshëm i aktiveve zëvendësuese janë ngjarje ekonomike të veçanta dhe trajtohen veças si vijon:
- (a) zhvlerësimet e aktivit afatgjatë material të investuar njihen në përputhje me SNK 36;
 - (b) nxjerrja jashtë përdorimit e aktivit afatgjatë material të investuar njihet në përputhje me paragrafet 66-71 të këtij standardi;
 - (c) shuma e shpërblimit, e humbur ose e dhënë nga palët e treta, për aktivin afatgjatë material të investuar që është i zhvlerësuar, duhet të njihet në fitim ose humbje kur ai bëhet i arkëtueshëm; dhe
 - (d) kostoja e aktiveve të restauruara, të blera ose të prodhuara si pjesë këmbimi, përcaktohet në përputhje me paragrafet 20-29 të këtij standardi.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

Modeli i vlerës së drejtë dhe modeli i koston

- 74 Përveç dhënies së informacioneve shpjeguese të SNK-17SNRF 16 jepen dhe informacionet shpjeguese në vijim. Në përputhje me SNK-17SNRF 16, pronari i një aktivit afatgjatë material të investuar jep informacione shpjeguese si qiradhënës mbi kontratat e lidhura të qirave. ~~Një njësia ekonomike~~ Një qiramarrës që mban një aktiv afatgjatë material të investuar si një aktiv me të drejtë përdorimi pas një qiraje financiare ose të zakonshme jep informacionet shpjeguese të qiramarrësit të kërkuara nga SNRF 16 ~~për qirat financiare~~ dhe informacionet shpjeguese të qiradhënësit siç kërkohet nga SNRF 16 për çdo qira të zakonshme të lidhur prej tij.
- 75 **Njësia ekonomike jep informacione shpjeguese për:**
- (a) nëse ajo zbaton modelin e vlerës së drejtë apo modelin e koston.
 - (b) ~~[fishirë] kur zbaton modelin e vlerës së drejtë, nëse dhe në çfarë rrethanash, interesat mbi aktivin afatgjatë material të mbajtur sipas qirave të zakonshme klasifikohen dhe trajtohen si aktiv afatgjatë material i investuar.~~
 - (c) kur klasifikimi është i vështirë (shih paragrafin 14), kriteri i dhënë në të përdoret për të dalluar aktivin afatgjatë material të investuar nga pasuria e zotëruar nga pronari dhe aktivin afatgjatë material të mbajtur për shitje në rrjedhën normale të biznesit.
 - (d) [fishirë]

- (e) në ç'masë vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar (siç është matur ose dhënë informacion shpjegues në pasqyrat financiare) bazohet në një vlerësim të bërë nga një vlerësues i pavarur, që ka një kualifikim përkatës profesional të njohur dhe ka eksperiencën e kohës së fundit për vendin dhe për kategorinë e aktivit afatgjatë material të investuar që po vlerësohet. Nëse nuk bëhet një vlerësim i tillë, duhet të jepet informacion shpjegues për këtë fakt.
- (f) shumat e njohura në fitim ose humbje për:
 - (i) të ardhurat nga qiraja nga aktivi afatgjatë material i investuar;
 - (ii) shpenzime operative të drejtpërdrejta (përfshirë riparime dhe mirëmbajtje) që rrjedhin nga aktivi afatgjatë material i investuar, që gjeneron të ardhura nga qiraja gjatë periudhës;
 - (iii) shpenzime operative të drejtpërdrejta (përfshirë riparime dhe mirëmbajtje) që rrjedhin nga aktivi afatgjatë material i investuar, që nuk gjeneron të ardhura nga qiraja gjatë periudhës; dhe
 - (iv) ndryshimin kumulativ në vlerën e drejtë të njohur në fitim ose humbje nga shitja e aktivit afatgjatë material të investuar nga një bashkësi aktivesh, në të cilën përdoret modeli i kostos, në një bashkësi në të cilën përdoret modeli i vlerës së drejtë (shih paragrafi 32C).
- (g) ekzistencën dhe tërësinë e kufizimeve në realizueshmërinë e aktivit afatgjatë material të investuar ose marrja e të ardhurave dhe shumave nga nxjerrja jashtë përdorimit.
- (h) detyrimet kontraktuale për të blerë, ndërtuar ose zhvilluar një aktiv afatgjatë material të investuar ose për riparimet, mirëmbajtjen apo zgjerimet.

Modeli i vlerës së drejtë

- 76 Përveç dhënies së informacioneve shpjeguese siç kërkohet në paragrafin 75, një njësi ekonomike që zbaton modelin e vlerës së drejtë, sipas paragrafëve 33–55, jep informacion shpjegues për rakordin midis vlerave kontabël (neto) të aktivit afatgjatë material të investuar në fillim dhe në fund të periudhës, duke treguar sa më poshtë:
- (a) shtesat, jepet informacion shpjegues veças për ato shtesa që rezultojnë nga blerjet dhe ato që rezultojnë nga shpenzimet e mëposhme të njohura në vlerën kontabël (neto) të një aktivi;
 - (b) shtesat që rezultojnë nga blerjet nëpërmjet kombinimeve të biznesit;
 - (c) aktivet e klasifikuara si të mbajtura për shitje ose të përfshira në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit, i klasifikuar si i mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 dhe nxjerrjet e tjera jashtë përdorimit;
 - (d) fitimet ose humbjet neto nga rregullimet e vlerës së drejtë;
 - (e) diferencat neto të këmbimit që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare në një monedhë paraqitjeje të ndryshme dhe nga përkthimi i operacionit të kryer jashtë vendit në monedhën e paraqitjes të njësisë raportuese;
 - (f) transferimet në dhe nga inventarët dhe pasuria e zotëruar nga pronari; dhe
 - (g) ndryshime të tjera.
- 77 Kur vlerësimi i bërë për aktivin afatgjatë material të investuar rregullohet ndjeshëm për qëllime të pasqyrave financiare, për shembull, për të shmangur llogaritjen e dyfishtë të aktiveve ose detyrimeve që njihen si aktive dhe detyrime të veçanta, siç është përshkruar në paragrafin 50, njësi ekonomike jep informacion shpjegues për rakordin midis vlerësimit të bërë dhe vlerësimit të rregulluar të përfshirë në pasqyrat financiare, duke treguar veças shumën totale të ndonjë ~~detyrimi~~ detyrimi të njohur nga qiratë, që është shtuar përsëri dhe ndonjë rregullim tjetër të rëndësishëm.
- 78 Në raste të veçanta, të përmendura në paragrafin 53, kur një njësi ekonomike mat aktivin afatgjatë për investim duke përdorur modelin e kostos në SNK 16 ose në përputhje me SNRF 16, do të jepet informacion shpjegues për rakordin e kërkuar nga paragrafi 76 në lidhje me këtë aktiv, veçmas nga shumat që lidhen me aktivet e tjera afatgjata materiale për investim. Përveç kësaj, njësi ekonomike jep informacione shpjeguese:
- (a) përshkrimin e aktivit afatgjatë material të investuar;
 - (b) një shpjegim se pse vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme;

- (c) nëse është e mundur, gamën e vlerësimeve sipas së cilës vlera e drejtë ka gjasa të mos jetë e vërtetë; dhe
- (d) për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktivit afatgjatë material të investuar që nuk mbartet me vlerën e drejtë:
 - (i) faktin që njësi ekonomike ka nxjerrë jashtë përdorimit këtë aktiv;
 - (ii) vlerën kontabël (neto) të këtij aktivi në momentin e shitjes; dhe
 - (iii) shumën e fitimit ose humbjes neto të njohur.

Modeli i kostos

79 Përveç informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 75, një njësi ekonomike, që zbaton modelin e kostos në paragrafin 56, do të japë informacione shpjeguese për:

- (a) metodat e amortizimit të përdorura;
- (b) jetët e dobishme ose normat e amortizimit të përdorura;
- (c) vlerën kontabël bruto dhe çdo amortizim të akumuluar (të mbledhur me humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi) në fillim dhe në fund të periudhës;
- (d) rakordin e vlerës kontabël (neto) të aktivit afatgjatë material të investuar në fillim dhe në fund të periudhës, duke treguar si vijon:
 - (i) shtesat, jepet informacion shpjegues veças për ato shtesa që rezultojnë nga blerjet dhe ato që rezultojnë nga shpenzimet e mëpasshme të njohura si një aktiv;
 - (ii) shtesat që rezultojnë nga blerjet nëpërmjet kombinimeve të biznesit;
 - (iii) aktivet e klasifikuara si të mbajtura për shitje ose të përfshira në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit, i klasifikuar si i mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 dhe nxjerrjet e tjera jashtë përdorimit;
 - (iv) amortizimin;
 - (v) shumën e humbjeve të njohura nga zhvlerësimi dhe shumën e humbjeve nga zhvlerësimi të anuluar gjatë periudhës në përputhje me SNK 36;
 - (vi) diferencat neto të këmbimit që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare në një monedhë paraqitjeje të ndryshme dhe nga përkthimi i operacionit të kryer jashtë vendit në monedhën e paraqitjes të njësisë raportuese;
 - (vii) transferimet në dhe nga inventarët dhe pasuria e zotëruar nga pronari; dhe
 - (viii) ndryshime të tjera.
- (e) vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material për investim. Në rastet përjashtimore të përshkruara në paragrafin 53, kur një njësi ekonomike nuk mund të matë në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material për investim, ajo do të japë informacion shpjegues:
 - (i) përshkrimin e aktivit afatgjatë material të investuar;
 - (ii) një shpjegim se pse vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme; dhe
 - (iii) nëse është e mundur, intervali i vlerave brenda të cilit ka shumë mundësi që të ndodhet vlera e drejtë.

Dispozitat kalimtare

Modeli i vlerës së drejtë

80 Një njësi ekonomike që ka zbatuar më parë SNK 40 (2000) dhe zgjedh për herë të parë të klasifikojë dhe të kontabilizojë disa ose të gjitha interesat nga pasuria e zotëruar, sipas një qiraje shfrytëzimi, si aktive afatgjata për investim, do të njohë efektin e kësaj zgjedhjeje si një rregullim në tepicën e celjes të fitimeve të pashpërndara për periudhën në të cilën është bërë zgjedhja e parë. Veç kësaj:

- (a) nëse njësi ekonomike ka dhënë më parë publikisht informacione shpjeguese (në pasqyrat financiare ose ndryshe) për vlerën e drejtë të këtyre interesave nga pasuria në periudhat e

mëparshme (matur mbi një bazë që plotëson përkufizimin e vlerës së drejtë në SNRF 13), njësia ekonomike inkurajohet, por nuk kërkohet:

- (i) të rregullojë tepricën e çeljes të fitimeve të pashpërndara për periudhën më të hershme në të cilën është dhënë informacioni shpjegues publikisht mbi vlerën e drejtë; dhe
 - (ii) të deklarohet përsëri informacioni krahasues për këto periudha; dhe
- (b) nëse njësia ekonomike nuk ka dhënë më parë publikisht informacion shpjegues siç përshkruhet në (a), ajo nuk do ta riparaqitë informacionin krahasues dhe do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

- 81 Ky Standard kërkon një trajtim të ndryshëm nga ajo që kërkohet nga SNK 8. SNK 8 kërkon që të riparaqitet informacioni krahasues, me përjashtim të rastit kur riparaqitja është praktikisht e pamundur.
- 82 Kur njësia ekonomike e zbaton për herë të parë këtë Standard, rregullimi i tepricës së çeljes të fitimeve të pashpërndara përfshin riklasifikimin e ndonjë shume të mbajtur në tepricë nga nivlerësimi për aktivin afatgjatë material të investuar.

Modeli i kostos

- 83 SNK 8 zbatohet për ndonjë ndryshim në politikat kontabël që bëhet kur njësia ekonomike zbaton për herë të parë këtë standard dhe zgjedh të përdorë modelin e kostos. Efekti i ndryshimit në politikat kontabël përfshin riklasifikimin e ndonjë shume të mbajtur në tepricë nga rivlerësimi për aktivin afatgjatë material të investuar.
- 84 Kërkesat e paragrafëve 27–29 në lidhje me matjen fillestare të një aktivi afatgjatë material të investuar, i përfshirë në një transaksion këmbimi të aktiveve, do të zbatohen në perspektivë vetëm për transaksionet e ardhshme.

Kombinimet e biznesit

- 84A *Përmirësimet vjetore për periudhën 2011–2013* publikuar në dhjetor 2013 ndryshoi paragrafin 14A dhe shtoi një titull para paragrafit 6. Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospective për blerjet e aktivit afatgjatë material të investuar që nga fillimi i periudhës së parë vjetore për të cilën është adoptuar ky ndryshim. Rrjedhimisht, nuk do të bëhet rregullimi i kontabilitetit për blerjet e aktivit afatgjatë material të investuar në periudhat e mëparshme. Megjithatë, njësia ekonomike mund të zgjedhë të zbatojë ndryshimin për blerjet individuale të aktivit afatgjatë material të investuar, që janë bërë para fillimit të periudhës së parë vjetore që ka qenë në datën e hyrjes në fuqi ose në vijim, nëse dhe vetëm nëse, është i disponueshëm informacioni i kërkuar për të zbatuar ndryshimin për ato transaksione që janë më të hershme.

SNRF 16

- 84B Njësia ekonomike që zbaton për herë të parë SNRF 16 dhe ndryshimet e lidhura me këtë Standard do të zbatojë kërkesat tranzitore në Shtojcën C të SNRF 16 për aktivet e saj afatgjatë materiale të investuar të mbajtura si aktiv me të drejtë përdorimi.

Data e hyrjes në fuqi

- 85 Njësia ekonomike do të zbatojë këtë standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 85A SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (rishikuar në 2007) ka ndryshuar terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Në përputhje me këtë u ndryshua paragrafi 62. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 Janar 2009 e në vazhdim. Nëse njësia ekonomike zbaton SNK 1 (i rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.
- 85B Janë ndryshuar paragrafët 8, 9, 48, 53, 54 dhe 57 janë ndryshuar, paragrafi 22 është fshirë dhe janë shtuar paragrafët 53A dhe 53B me anë të *Përmirësimeve të SNRF-ve* të dala në maj të 2008-së. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospective për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2009 ose më pas. Një njësi ekonomike lejohet të zbatojë ndryshimet për aktivet afatgjatë materiale të investuara që

janë në ndërtim edhe nga data para 1 Janarit 2009, me kusht që vlerat e drejta të aktiveve afatgjata materiale të investuara në ndërtim të maten në atë datë. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe do të zbatohet në të njëjtën kohë ndryshimet e paragrafëve 5 dhe 81E të SNK 16 *Toka, Ndërtesat, Makineritë dhe Pajisjet*.

- 85C Sipas SNRF 13, nxjerrë në maj të vitit 2011, është ndryshuar përkufizimi i vlerës së drejtë në paragrafin 5, janë ndryshuar paragrafët 26, 29, 32, 40, 48, 53, 53b, në 78-80 dhe 85B dhe janë fshirë paragrafët 36-39, 42-47, 49, 51 dhe 75 (d). Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.
- 85D *Përmirësimet vjetore për periudhën 2011–2013*, publikuar në dhjetor 2013, shtuan titujt para paragrafit 6 dhe pas paragrafit 84 dhe shtuan paragrafët 14A dhe 84A. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 85E SNRF 15 *Të ardhurat nga Kontratat me Klientët*, i publikuar në Maj 2014, ndryshoi paragrafët 3(b), 9, 67 dhe 70. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 15.
- 85F SNRF 16, i publikuar në Janar 2016, ndryshoi objektin e SNK 40 duke përkufizuar aktivin afatgjatë material të investuar si aktiv afatgjatë material i investuar i zotëruar dhe si pasuri e mbajtur nga një qiramarrës si aktiv me të drejtë përdorimi. SNRF 16 ndryshoi paragrafët 5, 7, 8, 9, 16, 20, 30, 41, 50, 53, 53A, 54, 56, 60, 61, 62, 67, 69, 74, 75, 77 dhe 78, shtoi paragrafët 19A, 29A, 40A dhe 84B dhe titujt përkatës të tyre dhe fshiu paragrafët 3, 6, 25, 26 dhe 34. Njësia ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 16.

Tërheqja e SNK 40 (2000)

- 86 Ky Standard zëvendëson SNK 40 *Aktivët Afatgjata Materiale të Investuar* (i publikuar në 2000).

